



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 721 Akti

Nr. 800 Vendimi
Tiranë, më 19.9.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Suela Zhegu	Relatore
Roland Ilia	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 17.9.2024, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Sabri Kastrati**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Pika 5 e nenit 179/ b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç dhe nenet D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Sabri Kastrati, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.12.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.
2. Trupi gjykues i shortuar për të shqyrtuar çështjen përbëhet nga komisionerët Suela Zhegu (relatore), Roland Ilia dhe Genta Tafa (Bungo). Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 15.1.2021 u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues komisionere Genta Tafa (Bungo). Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatorja e çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Gerrit Sprenger. Subjekti i rivlerësimit u njoh me anëtarët e trupit gjykues dhe deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me komisionerët.
3. Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë” të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).
5. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:
 - *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
 - *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin financiar të pasurive;*
 - *ka mosdeklarim të pasurisë ndër vite;*
 - *ka kryer deklarim të rremë;*
 - *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
6. AKSIK-ja² ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar.

¹ Raporti i ILDKPKI-së dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 27.9.2018.

² Raporti nr. *** prot., datë 2.11.2017, i deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. *** , datë 4.7.2023, të KDZH-së.

7. KLP-ja³ ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 dhe pesë dokumentet e tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit.
8. Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të plotë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.
9. Trupi gjykues i mbledhur në datën 29.7.2024, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin mbi rezultatet e hetimit administrativ dhe rekomandimin e relatores së çështjes, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht, duke u bazuar në të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale – në përputhje me pikën 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit Sabri Kastrati, njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, rezultatet paraprake të hetimit, në përputhje me nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar barrën e provës, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.
10. Për një proces të rregullt ligjor subjektit të rivlerësimit i janë garantuar të drejtat, si: njoftimi për fillimin e procedurës së rivlerësimit; njoftimi mbi përbërjen e trupit gjykues; për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës mbi rezultatet e hetimit. Në datën 29.7.2024, subjektit iu dërguan rezultatet paraprake të hetimit administrativ dhe iu dha koha e nevojshme për t'u njohur me dosjen dhe për të disponuar kopje të saj.
11. Subjekti i rivlerësimit, përmes postës elektronike, me *email*-in e datës 16.8.2024 ka kërkuar zgjatjen e afatit për paraqitjen e shpjegimeve dhe depozitimin e dokumentacionit mbështetës në lidhje me rezultatet e hetimit. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit, në datën 17.8.2024 i komunikoi në rrugë elektronike afatin e ri të dërgimit të parashtrimeve, brenda datës 29.8.2024.
12. Z. Sabri Kastrati, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat brenda afatit të përcaktuar, në datën 29.8.2024, lidhur me rezultatet e hetimit, si dhe kërkesën⁴ për marrjen e provave, përmes së cilës ka paraqitur dy kërkesa, konkretisht ka kërkuar kryerjen nga ana e Komisionit të një ekspertimi grafik për kontratën me FSHU-në në lidhje me furnizimin me energji elektrike të datës 11.2.2016, për sa i përket nënshkrimit të saj nga bashkëjetuesja e tij, si dhe kërkimin e informacionit pranë autoriteteve përkatëse kanadeze lidhur me pasaportën kanadeze, pasi mohon që ky dokument të jetë disponuar prej tij. Lidhur me rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk është dakord me gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni.
13. Trupi gjykues, me vendimin e datës 4.9.2024, pasi mori në shqyrtim dy kërkesat e subjektit, ka vendosur refuzimin e tyre, pasi referuar pikës 2 të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime, për të provuar të

³ Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale nr. *** prot., datë 3.6.2021, i miratuar me vendimin e KLP-së nr. ***, datë 3.6.2021.

⁴ Kërkesë e regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 29.8.2024.

kundërtën e rezultateve të hetimit, duke e njoftuar subjektin me arsyetimin e këtij refuzimi, në përputhje me nenin 49/6 të ligjit nr. 84/2016.

14. Trupi gjykues, pasi u njoh me shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

15. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e kryer elektronikisht në datën 9.9.2024. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 17.9.2024, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger.
16. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti nuk pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

17. Subjekti i rivlerësimit Sabri Kastrati nuk ka qenë plotësisht bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit të kryer ndaj tij, në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, duke mos iu përgjigjur në mënyrë direkte dhe të qartë disa pyetjeve të dërguara gjatë hetimit administrativ apo shpjegimeve të kërkuara me dërgimin e rezultateve të hetimit, si dhe duke mos depozituar kopje të pasaportës së tij, dokumentacion ky i kërkuar gjatë hetimit nga Komisioni.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

18. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.
19. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.
20. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.
21. Ndërsa, sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.
22. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

23. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara, ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private;
- e) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja;
- f) raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja;
- g) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- h) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituara nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

24. Komisioni, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, mundësitë për fshehje të pasurisë, deklarin e rremë apo konfliktin e interesit.

25. Në deklaratën e pasurisë *Vetting* (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 30.1.2017, subjekti ka deklaruar pasuritë në vijim:

26. **Apartament⁵ në Tiranë**, me sipërfaqe 76 m², i ndodhur në rrugën “A.D”, blerë në vlerën 55.000 euro.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

26.1 Nga verifikimi i akteve në dosje ka rezultuar se apartamenti është porositur nga z. Sabri Kastrati përmes kontratës së porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.2.2006, të lidhur me shoqërinë sipërmarrëse “S” sh.p.k., për ndërtimin⁶ e një apartamenti me sipërfaqe 84,19 m², në katin e parë teknik, pranë shkollës “A.D”, Tiranë, kundrejt çmimit 55.000 euro, likuiduar plotësisht nga porositësi. Afati i dorëzimit të ambienteve është përcaktuar në datën 30.6.2006.

⁵ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 7.5.2013, për apartamentin me sip. 76,07 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. **, fq. **, Tiranë, në pronësi të z. Sabri H Kastrati dhe kartelë pasurie e lëshuar në datën 13.5.2013; (ii) kontratë porosisë nr. ***, datë 22.2.2006, sipas së cilës z. Sabri Kastrati porosit pranë shoqërisë “S” sh.p.k. apartamentin me sip. 84,19 m² në katin e parë teknik në pallatin në rrugën “S. G” përballë shkollës “A.D”, Tiranë, me çmim 55.000 euro, likuiduar plotësisht, dhe dokumentacionin e shoqërisë së ndërtimit; (iii) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 13.4.2013, sipas së cilës z. Sabri Kastrati blen nga shoqëria “S” sh.p.k. apartamentin me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. **, fq. **, me sip. 76,07 m², në rrugën “A.D”, Tiranë, kundrejt çmimit 55.000 euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale dhe dokumente identifikimi të palëve.

⁶ Shoqërisë ndërtuese “S” sh.p.k. i është miratuar leja e ndërtimit me nr. *** prot., datë 23.5.2005, bazuar në vendimin e KRRT-së nr. ***, datë 21.12.2004, për objektin godinë banimi dhe shërbime 6 dhe 7 kate, dy kate parkim nëntokë, në rrugën “A. D”, në pronësi të familjeve Xh, B, D, S, P, H, K, V, K, B, S dhe Sh. Afati kohor i kësaj lejeje ndërtimi ishte deri në dhjetor të vitit 2009. Në kontratën e porosisë datë 22.2.2006 citohet se shoqëria sipërmarrëse “S” sh.p.k., në bazë të kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. ** kol., datë 27.1.2004, të lidhur me përfaqësuesit e pronarëve të truallit, ndërton një godinë banimi dhe shërbimi 7 kate mbi tokë, dy kate nëntokë, sipas lejes së sheshit të ndërtimit nr. ***, datë 26.10.2004, të KRRT-së, Bashkia Tiranë.

26.2 Subjekti e ka deklaruar këtë apartament në DPV-në e vitit 2006, ku ka deklaruar: “Blerje apartamenti k. porosie nr. ***, datë 22.2.2006, me sip. 84 m². Shuma e blerjes e likuiduar. Vlera e deklaruar 55.000 euro, me pjesë takuese 50%”.

26.3 Midis subjektit dhe shoqërisë ndërtuese është nënshkruar kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.4.2013, për blerjen e apartamentit me nr. pasurie ***, me sipërfaqe 76.07 m², në vlerën 55.000 euro, e likuiduar nga blerësi jashtë zyrës noteriale.

26.4 ASHK Tirana Veri⁷ ka konfirmuar pasurinë apartament, me sip. 76,07 m², të regjistruar në emër të z. Sabri Kastrati, duke u pajisur me certifikatën e pronësisë në datën 7.5.2013.

Lidhur me mënyrën e pagesës së apartamentit

26.5 Komisioni i ka kërkuar⁸ subjektit të deklarojë mënyrën e pagesës për shumën 55.000 euro, si dhe të dokumentojë pagesat e kryera, për të cilën subjekti ka shpjeguar⁹ se pagesa ndaj kompanisë është kryer me lekë në dorë ditën e nënshkrimit të kontratës së porosisë, jashtë zyrës noteriale. Subjekti ka shpjeguar¹⁰ se për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar nuk disponon dokumentacion mbi pagesën e kryer.

26.6 Subjekti ka deklaruar¹¹ se banimi në këtë apartament ka filluar në vitin 2007. Nga të dhënat e dërguara nga Zyra e Gjendjes Civile¹² ka rezultuar se subjekti është shkëputur nga trangu familjar i origjinës në datën 4.3.2005, duke ndryshuar vendbanim nga Kukës në Tiranë.

26.7 Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se për vitet 1993 – 1998 ka bashkëjetuar me familjen e tij (prindërit, vëllezërit dhe motrat) dhe në vijim, prej vitit 1998 deri në 2005-ën, është larguar nga funksioni i prokurorit, pasi ka emigruar në Australi. Subjekti ka deklaruar se pas rifillimit të detyrës së prokurorit në vitin 2005 e në vijim ka bashkëjetuar me bashkëjetuesen e tij dhe fëmijët, ku shpenzimet e jetesës janë përballuar nga pagat e tij dhe të bashkëjetueses.

26.8 Komisioni verifikoi lidhur me çmimin e blerjes së apartamentit dhe nuk rezultoi ndonjë trajtim preferencial.

26.9 Komisioni hetoi lidhur me ndonjë konflikt të mundshëm interesi të subjektit të rivlerësimit me shoqërinë e ndërtimit “S” sh.p.k., apo me administratorin/ortakun e saj, z. A.S, dhe nga të dhënat e ardhura nga prokuroritë¹³, ku subjekti ka ushtruar detyrën nga viti 2005 e në vijim, nuk kanë rezultuar procedime penale të mosfilluara, pushuara, pezulluara apo të dërguara në gjykim në ngarkim të këtij shtetasi/subjekti ndërtimor.

Analizimi i burimit të krijimit për apartamentin në Tiranë nga Komisioni

26.10 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si burimi krijimi të ardhurat e qirasë nga pasuria bar-restorant “K”, i ndodhur në Lagjen Nr. *, K, pasuri e cila është trashëgimi nga

⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 26.2.2024.

⁸ Përmes pyetësorit me *email*-in datë 12.3.2024.

⁹ Shpjegimet e subjektit të dërguara në datën 2.4.2024, në përgjigje të pyetësorit datë 12.3.2024.

¹⁰ Shpjegimet e subjektit të dërguara në datën 2.4.2024, në përgjigje të pyetësorit datë 12.3.2024.

¹¹ Shpjegimet e subjektit me *email*-in datë 2.4.2024, në përgjigje të pyetësorit datë 12.3.2024.

¹² Me shkresën nr. *** prot., datë 11.8.2021.

¹³ (i) Shkresa nr. *** prot., datë 4.4.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibrë (përfshirë edhe ish-Prokurorinë e Rrethit Mat); (ii) shkresa nr. *** prot., datë 5.4.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës; (iii) shkresa nr. *** prot., datë 24.4.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë (përfshirë edhe ish-Prokuroria e Rrethit Mirditë); (iv) shkresa nr. *** prot., datë 23.4.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

babai, e ndërtuar para kohës së fillimit të punës si prokuror dhe e deklaruar që në momentin e fillimit të detyrës.

26.11 Sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.2.2006, të nënshkruar midis subjektit Sabri Kastrati dhe vëllait të tij M.K, subjekti deklaron se në bazë të dëshmisë së trashëgimisë është bashkëpronar i pasurisë bar-restorant “K” në K, të ndodhur në katin i dytë, lokal të cilin ia jep me qira vëllait, M.K, për një periudhë 5-vjeçare, me qira mujore 800 euro, likuidimi i së cilës është bërë paradhënie (në dorë) për gjithë periudhën.

26.12 Nga verifikimi i deklarimeve periodike në vite të subjektit, ka rezultuar se:

- a) Në DPV-në e vitit 2005 para fillimit të detyrës¹⁴, subjekti ka deklaruar: *“Supermarket, restaurant, hotel, garazh (objekt 5-katësh), i ndodhur në K, i quajtur Kompleksi K, është në pronësinë time dhe të dy vëllezërve M dhe V.K, me pjesë takuese 33% dhe vit krijimi 1998”*.
- b) Në DPV-në e vitit 2006, subjekti ka deklaruar: *“Të ardhura nga dhënia me qira e pjesës time takuese të bar-restorant “K”, për një periudhë 5-vjeçare, qiraja është parapaguar nga qiramarrësi M.K dhe restoranti është dhënë me qira në shkurt të vitit 2002, me 800 euro/muaji. Vlera e deklaruar është 48.000 euro”*. Në vijim ka deklaruar: *“Objekt supermarket, restaurant, hotel, garazh (5-katësh), me sip. 1500 m² (afërsisht) dhe pjesa ime takuese 420 m² e trashëguar nga babai, me zotërim rreth 33%, që ndodhet në Lagjen Nr. *, K, me vit krijimi 1998”*.

Verifikimi nga Komisioni lidhur me pasurinë bar-restorant “K”

26.13 Nga informacioni i ardhur nga Drejtoria Vendore e ASHK-së Kukës¹⁵ konfirmohet pasuria hotel-restorant-market “K”, me adresë Lagjja Nr. *, K, e cila është në proces legalizimi, sipas vetëdeklarimit të kryer në datën 15.11.2006 nga vëllai M.K.

26.14 Nga verifikimi i akteve të administruara në dosje ka rezultuar se:

- i) Ky objekt është ndërtuar bazuar në lejen e ndërtimit nr. **, datë 10.5.2000, për “Rikonstruksion + shtesë kati * kat” me sip. 131 m², në Lagjen Nr. *, K, me investitor privat H.K dhe subjekt ndërtues shoqëria “M” sh.p.k.
- ii) Sipas procesverbalit të kolaudimit, koha e ndërtimit të objektit ka qenë 5 vjet, dorëzimi i objektit është bërë në vitin 2005 dhe vlera fillestare sipas preventivit është 20.000.000 (njëzet milionë) lekë.
- iii) Sipas vetëdeklarimit për legalizimin e shtesës në hotel-restorant-market “K”, të kryer në datën 15.11.2006 nga shtetasi M.K, deklarohet ndërtimi i përfunduar, numri i kateve 4+2, me subjekt ndërtues “M” sh.p.k. dhe investitor M.K.
- iv) Sipas vendimit gjyqësor nr. **, datë 12.7.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor K, është çelur dëshmia e trashëgimisë ligjore të të ndjerit H.K (babai i subjektit, i cili ka ndërtuar jetë në datën 27.3.2003), ku subjekti ka trashëguar 1/8 pjesë të pasurive trashëgimore.

26.15 Gjatë hetimit, subjekti ka shpjeguar¹⁶ se për këtë pasuri është kërkuar leja e ndërtimit fillimisht nga babai H.K në vitin 2000, e cila ka dalë në emër të shoqërisë “M” sh.p.k. Më pas, për shkak të disa shtesave, në zbatimin e projektit është kryer vetëdeklarimi për legalizim nga

¹⁴ Dorëzuar pranë ILDKPKI-së në datën 24.3.2005.

¹⁵ Dërguar me shkresat nr. *** prot., datë 19.2.2024 dhe nr. *** prot., datë 7.5.2024.

¹⁶ Shpjegimet e subjektit të dërguara me email-in datë 20.5.2024.

vëllai i madh M.K, në lidhje me objektin bar-restorant-hotel-market “K”, pasi ai gjendej në K në ato momente.

26.16 Subjekti ka shpjeguar¹⁷ ndër të tjera se për ndërtimin e këtij objekti kanë kontribuar vëllezërit dhe babai, i cili ka përdorur edhe kursimet familjare ndër vite. Sipas subjektit, babai në atë kohë administronte gjithë buxhetin e familjes, pasi si familje nuk ishin të ndarë, dhe këtu përfshihej kontributi i subjektit dhe vëllezërve të cilët janë marrë me tregti që nga viti 1991, si dhe të ardhurat e dërguara nga subjekti gjatë kohës si emigrant në Australi (për vitet 1998 – 2005).

26.17 Referuar shpjegimeve të dhëna nga subjekti pranë ILDKPKI-së¹⁸, në procesverbalin e mbajtur në datën 13.1.2016, subjekti ka deklaruar se objekti 5-katësh në K është investim total i familjarëve të tij, babait dhe 2 vëllezërve, pasi vetë subjekti gjatë viteve 1998 – 2005 ka jetuar në Australi dhe nuk ka investuar në këtë ndërtim.

26.18 Nisur nga fakti që kjo pasuri rezulton ende e paregjistruar pranë ASHK-së, e vetëdeklaruar në vitin 2006 pranë ALUIZNI-t dhe në DPV-të e viteve 2005 dhe 2006, subjekti ka deklaruar zotërimin në masën 33% (ose 1/3 pjesë) mbi këtë pasuri. Komisioni i ka kërkuar¹⁹ subjektit të shpjegojë qartë nga buron pjesa e tij takuese e deklaruar.

26.19 Subjekti ka shpjeguar²⁰ se: *“Pas vdekjes së babait, të tre vëllezërit me marrëveshje kanë rënë dakord me mirëkuptim që objekti të ndahet midis tyre dhe ka depozituar një deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.10.2010²¹, të nënshkruar midis tij dhe dy vëllezërve V e M.K, të cilët deklarojnë se janë bashkëpronarë të pasurisë së trashëguar nga babai dhe kanë rënë dakord me mirëkuptim që objekti të ndahet midis tyre, ku supermarketi (kati i parë) t’i kalojë në pronësi M.K, restoranti (kati i dytë) t’i kalojë subjektit dhe 2 kate hotel t’i kalojnë V.K, ndërsa shtesat janë në proces legalizimi dhe pas përfundimit të procedurave të legalizimit objekti do të regjistrohet përkatësisht në emër të pronarëve të sipërpërmendur”.*

26.20 Nga aktet në dosje ka rezultuar se pasuria bar-restorant “K” në K është ende në proces legalizimi, pasuri e paregjistruar, dhe sipas një deklarate noteriale të vitit 2010, subjekti me vëllezërit e tij kanë ndarë me mirëkuptim pjesët takuese të secilit mbi këtë pasuri.

Lidhur me të ardhurat nga qiradhënia në shumën 48.000 euro

26.21 Në pyetësorin standard, subjekti ka deklaruar se pasi është kthyer nga Australia ka rifilluar detyrën e prokurorit dhe administrimin e pjesës së tij takuese në pasurinë bar-restorant “K” ia ka lënë vëllait M.K. Sipas subjektit, duke qenë se i duhej të siguronte një banesë në Tiranë, me marrëveshje kanë rënë dakord që për administrimin e pjesës së tij takuese vëllai t’i jepte si parapagim shumën 48.000 euro, për shkak të marrëdhënies së posaçme midis vëllezërve, faktit që prej vitit 1993 deri në vitin 2005 të gjitha të ardhurat e fituara prej tij janë dorëzuar në ekonominë e përbashkët familjare, si dhe faktit që vëllai M.K ishte në rolin e kryefamiljarit (pas vdekjes së babait) dhe ndjente detyrimin për ta ndihmuar në sigurimin e një banese. Subjekti ka sqaruar se dhënia e kësaj vlere nuk është në këndvështrimin e një kontratë qiraje sipas përcaktimeve të Kodit Civil dhe prandaj për këtë shumë nuk ka paguar tatim mbi qiranë.

¹⁷ Shpjegimet e subjektit të depozituara në datën 30.10.2023.

¹⁸ Me shkresën e ILDKPKI-së nr. *** prot., datë 27.12.2023.

¹⁹ Përmes pyetësorit me email-in datë 12.3.2024.

²⁰ Shpjegimet e subjektit me email-in datë 2.4.2024.

²¹ Dokument i depozituar nga subjekti në datën 30.10.2023.

26.22 Meqenëse shuma 48.000 euro është një e ardhur e konsiderueshme që ka shërbyer si burim krijimi për pasurinë apartament, Komisioni i ka kërkuar²² subjektit të depozitohë dokumentacion justifikues mbi pagesat e detyrimeve tatimore, si të ardhura nga qiradhënia, apo mbi të ardhurat e ligjshme të vëllait, për shumën 48.000 euro.

26.23 Subjekti ka shpjeguar²³ se një pjesë të kësaj shume prej 30.000 euro vëllai i tij M.K ia ka marrë hua shtetasit Y.E, i cili ushtron aktivitetin për ndërtimin e rrugëve me shoqërinë “M” sh.p.k. në K, hua e marrë në janar të vitit 2006 dhe kthyer në dhjetor të vitit 2008.

i. Lidhur me huan e marrë shtetasit Y.E

26.24 Komisioni, nisur nga fakti që huaja e marrë nga vëllai ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit, i kërkoi subjektit dokumentacion provues mbi të ardhurat e ligjshme të huadhënësit për huan në shumën 30.000 euro. Gjatë hetimit, subjekti depozitoi si dokumentacion provues për të provuar të ardhurat e huadhënësit:

- kopje të bilanceve²⁴ të viteve 2004, 2005 dhe 2006 të shoqërisë “M” sh.p.k., në pronësi të shtetasit Y.E, të cilat sipas subjektit provojnë se ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme;
- deklaratë noteriale²⁵ (për njohje të likuidimit të huas pa interes) të datës 26.1.2017, të nënshkruar nga shtetasit M.K dhe Y.E, ku ky i fundit deklaron se në datën 13.1.2006 i ka dhënë shtetasit M.K shumën 30.000 euro, pa interes, të cilën e ka likuiduar me këste brenda datës 31.12.2008.

26.25 Nga verifikimi i ekstraktit historik të QKB-së për shoqërinë “M” sh.p.k. (me NUIS J***P) ka rezultuar se kjo shoqëri është regjistruar në datën 1.7.1996 në Kukës, me administrator dhe ortak të vetëm shtetasin Y.E, zotërues 100% i kuotave.

26.26 Komisioni kërkoi informacion pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Kukës²⁶, e cila ka dërguar bilancet e shoqërisë “M” sh.p.k. për vitet 2000, 2003, 2004, 2005, 2006 dhe 2007 (ku fitimi i realizuar për vitin 2004 është në shumën rreth 1.100.000 lekë dhe viti 2005 me fitim në shumën rreth 3.200.000 lekë) dhe ka informuar se kjo shoqëri nuk ka bërë shpërndarje të dividendit për asnjë nga bilancet e mësipërme.

26.27 Nisur nga fakti se në bilancet e shoqërisë “M” sh.p.k. nuk ka rezultuar të jetë shpërndarë dividend për periudhën 2004 – 2006, Komisioni i ka kërkuar²⁷ subjektit të depozitohë dokumentacion justifikues mbi të ardhurat e ligjshme të shtetasit Y.E deri në janar të vitit 2006, deri në masën e huas, si dhe çdo të ardhur tjetër për këtë shtetas, ku të provohet pagesa e tatimit në kuptim të ligjit. Subjekti nuk ka depozituar dokumentacion justifikues, duke shpjeguar²⁸ se bilancet e shoqërisë “M” sh.p.k. për vitet 2004 – 2005, të depozituara më herët prej tij, provojnë se shtetasi Y.E ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme, si dhe deklarata noteriale provon dhënien dhe shlyerjen e kësaj huaje. Subjekti thekson se huaja nuk është marrë prej tij, por nga vëllai i tij M.K, i cili nuk është subjekt rivlerësimi dhe sipas subjektit nuk ka detyrim për të provuar burimin e tyre.

²² Përmes pyetësorit me *email*-in datë 20.10.2023.

²³ Shpjegimet e subjektit të depozituara në datën 30.10.2023, si dhe shpjegimet në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së në datën 28.1.2016.

²⁴ Dokumentacion i depozituar nga subjekti në datën 30.10.2023, në përgjigje të pyetësorit datë 20.10.2023.

²⁵ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. ** kol., datë 26.1.2017, dërguar nga noteri me shkresën nr. ** prot., datë 15.2.2024.

²⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 9.4.2024.

²⁷ Përmes pyetësorit me *email*-in datë 12.3.2024.

²⁸ Shpjegimet e subjektit me *email*-in datë 2.4.2024 dhe shpjegimet shtesë të dërguara në datën 30.4.2024.

26.28 Në vijim, subjekti ka shpjeguar²⁹ se kjo shoqëri ka pasur aktivitet të suksesshëm ndër vite dhe fakti që nuk ka shpërndarë dividend në vitet në fjalë nuk do të thotë që shtetasi Y.E nuk ka pasur mundësi financiare për t'i dhënë këtë hua vëllait të tij M.K. Sipas subjektit, të ardhurat e shtetasit Y.E kanë qenë si rezultat i aktivitetit të tij të biznesit dhe janë të ligjshme. Ato janë rezultat i kursimeve të tij disavjeçare, por ai nuk i ka ruajtur bilancet e viteve të mëparshme në mënyrë që të provojë burimin e ligjshëm të këtyre të ardhurave.

Analiza mbi mundësitë e shtetasit Y.E për dhënien e shumës 30.000 euro në janar të vitit 2006

26.29 Sipas dokumentacionit të administruar për shoqërinë "M" sh.p.k., subjekti nuk ka dokumentuar të ardhurat e ligjshme të shtetasit Y.E për shumën 30.000 euro, në kuptim të ligjit, për rrjedhojë analiza financiare mbi mundësitë e këtij për dhënien e huas do të rezultonte me balancë negative për të gjithë shumën.

ii. Lidhur me shumën 18.000 euro, si e ardhur e vëllait M.K

26.30 Gjatë hetimit, subjekti shpjegoi³⁰ se vëllai ka pasur aktivitet privat, si administrator i shoqërisë "V.K" sh.p.k., dhe ka depozituar³¹ si dokumentacion provues një ekstrakt të llogarisë bankare të kësaj shoqërie pranë Raiffeisen Bank, ku evidentohen veprime në llogari gjatë periudhës 2004 – 2008.

26.31 Gjithashtu, në deklaratën *Vetting* subjekti ka paraqitur dokumentacion³² voluminoz të aktivitetit të shoqërisë "V.K" sh.p.k., që i përket projekteve të zbatuara në ndërtime, kontrata të furnizimit me mallra dhe shërbime të lidhura me ente të ndryshme shtetërore e private, por jo pasqyra financiare vjetore dhe fitimin e realizuar apo shpërndarjen e tij. Subjekti ka depozituar dokumentacionin bankar³³ të shoqërisë "V.K" sh.p.k. për periudhën 2009 – 2016, duke deklaruar se kontratat e realizuara nga kjo shoqëri provojnë se vëllai M.K ka pasur aktivitet të ligjshëm dhe mundësi për kursimin e shumës 18.000 euro.

26.32 Nga verifikimi i ekstraktit historik të QKB-së për shoqërinë "V.K" sh.p.k. (me NUIS K***V), ka rezultuar se kjo shoqëri është regjistruar në datën 7.4.2003, me seli në Lagjen Nr. *, K, me ortak të vetëm shtetasin M.K (zotërues i 100% të kuotave), ku objekti i veprimtarisë është gjithëpërfshirës. Gjatë periudhës 2001 – 2008, shtetasi M.K ka qenë administrator i kësaj shoqërisë.

26.33 Komisioni ka kërkuar informacion pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Kukës³⁴, e cila ka dërguar bilancet e shoqërisë "V.K" sh.p.k. për vitin 2003 (me humbje në shumën 492.288 lekë),

²⁹ Shpjegime shtesë të dërguara nga subjekti në datën 30.4.2024, në vijim të përgjigjeve të pyetësorit të dërguar në datën 2.4.2024.

³⁰ Shpjegimet e subjektit të depozituara në datën 30.10.2023, në përgjigje të pyetësorit datë 20.10.2023.

³¹ Dokumenti i depozituar nga subjekti në datën 30.10.2023.

³² Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën *Vetting* dokumentacionin vijues: (1) vendim nr. ***, datë 12.7.2006, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, për çeljen e trashëgimisë ligjore të trashëgimlënësit H.K, me trashëgimtarë të radhës së parë bashkëshorten dhe 7 fëmijët e tij, të cilët trashëgojnë secili nga 1/8 pjesë, bashkëlidhur certifikata familjare e datës 11.10.2016, e gjendjes së trungut të vitit 1994 të shtetasit H.K; (2) ekstrakt historik i QKR-së datë 19.1.2016, i shoqërisë "V.K" sh.p.k. me NIPT K***V, me datë regjistrimi 7.4.2003, datë themelimi 10.2.2000, me aktivitet në Kukës, Lagja Nr. **, në pronësi 100% të shtetasit M.K, me status aktiv, me objekt të veprimtarisë gjithëpërfshirës; (3) përshkrim i aktivitetit të shoqërisë "V.K" sh.p.k., i bërë nga shtetasi M.K, sipas të cilit kjo shoqëri është krijuar në vitin 2001 dhe ka realizuar disa kontrata në fushën e ndërtimit dhe shërbimeve sociale; (4) kontrata shërbimesh mbi projekte të ndryshme.

³³ Dokumentacioni i depozituar nga subjekti në datën 2.4.2024 si vijon: nxjerrje llogarie të lëshuar nga Raiffeisen Bank në datën 7.3.2007, të shoqërisë "V.K", për periudhën 2006 – 2007; *statement* të llogarisë të lëshuar nga Raiffeisen Bank në datën 14.1.2016 për shoqërinë "V.K", për periudhën 5.1.2009 – 14.1.2016; nxjerrje llogarie e Alpha Bank datë 14.1.2016, për shoqërinë "V.K", për periudhën 2.7.2010 – 14.1.2016; nxjerrje llogarie e Credins Bank datë 14.1.2016, për shoqërinë "V.K", për periudhën 20.6.2014 – 31.12.2015; praktika shkresore e preventive.

³⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 9.4.2024.

vitin 2004 (me humbje në shumën 345.431 lekë) dhe për vitin 2005 (fitim në shumën 126.345 lekë).

26.34 Analiza mbi mundësitë financiare të shtetasit M.K për dhënien e shumës 18.000 euro – gjatë hetimit subjekti nuk mundi të depozitojë dokumentacion mbi të ardhurat e ligjshme të vëllait në kuptim të ligjit, për rrjedhojë analiza mbi mundësinë financiare të vëllait do të rezultonte me balancë negative për të gjithë shumën 18.000 euro.

iii. Lidhur me të ardhurat e subjektit në shumën 7.000 euro

26.35 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si burim për blerjen e apartamentit vetëm shumën 48.000 euro, por nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave për diferencën e çmimit të apartamentit prej 7.000 euro.

26.36 Gjatë hetimit subjekti ka shpjeguar³⁵ se shuma 7.000 euro ka qenë nga kursimet e tij ndër vite, të ardhura nga punësimi në Australi pranë kompanisë “M.C”, nga viti 1999 deri në vitin 2001, por e ka të pamundur të gjejë dokumentacion justifikues për pagimin e taksave, pasi detyrimi për ruajtjen e këtij dokumentacioni ka një afat të caktuar ligjor dhe maksimumi i kohës për të cilën kompanitë janë të detyruara të ruajnë të dhënat është 7 vjet. Subjekti ka dërguar *link-un*³⁶ e faqes zyrtare të qeverisë australiane për verifikimin e këtij fakti. Lidhur me mosdeklarimin e këtyre të ardhurave, subjekti ka shpjeguar³⁷ se kjo ka ardhur për shkak të mungesës së eksperiencës, pasi ishte hera e parë që bënte një deklaram të tillë dhe ka menduar se një gjë e tillë do të kuptohej vetvetiu.

26.37 Nga verifikimi i deklarimeve periodike, në DPV-në e viteve 2005 dhe 2006 (vit i blerjes së apartamentit), subjekti nuk ka deklaruar të ardhura të realizuara nga emigracioni, as kursime *cash* apo likuiditete në bankë.

26.38 Nga hetimi i Komisionit rezultoi mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me të ardhurat e ligjshme për krijimin e kursimeve në shumën 7.000 euro dhe, për pasojë, kjo shumë u konsiderua si balancë negative në analizën financiare.

Shpenzime mobilimi

26.39 Në pyetësorin standard, subjekti ka deklaruar se vlera totale e arredimit të apartamentit në Tiranë është afërsisht 500.000 lekë. Sipas deklarimeve të tij, ka filluar të banojë në këtë apartament në vitin 2007. Shpenzimet e mobilimit janë reflektuar në analizën financiare në periudhën 2006 – 2007, meqenëse dorëzimi i apartamentit është në qershor të vitit 2006.

Analiza financiare

26.40 Komisioni kreu analizën financiare mbi mundësitë e subjektit për blerjen e apartamentit për vitin 2006 dhe nga analiza e kryer ka rezultuar një balancë negative në shumën -6.832.166 lekë.

Konstatime të Komisionit për apartamentin e blerë në vitin 2006

26.41 Nga hetimi i Komisionit për këtë pasuri rezultoi se subjekti:

³⁵ Shpjegimet e subjektit me *email*-in datë 30.10.2023.

³⁶ <https://www.record-www-to-keep-www-for>

³⁷ Shpjegimet e subjektit të depozituara në datën 30.10.2023.

- Ka mungesë dokumentacioni mbi pagesat e detyrimeve tatimore për shumën e përfituar nga vëllai prej 48.000 euro, si e ardhur nga qiradhënia e pasurisë në bashkëpronësi të bar-restorant “K”, e deklaruar si burim për blerjen e apartamentit.
 - Nuk u provuan të ardhurat e ligjshme të vëllait për shumën 48.000, dhënë subjektit.
 - Në DPV-në e vitit 2005, subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash* nga puna në emigracion.
 - Ka mungesë dokumentacioni për kursimet nga emigracioni në vite, në shumën 7.000 euro.
 - Analiza mbi mundësitë e subjektit për blerjen e pasurisë apartament në Tiranë, në vitin 2006, ka rezultuar me një balancë negative në shumën -6.832.166 lekë.
- ✓ Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në prapësime

26.42 Subjekti i rivlerësimit përmes prapësimeve ka pranuar faktin se ka mungesë dokumentacioni mbi pagesat e detyrimeve tatimore nga qiradhënia për shumën 48.000 euro, të cilat i janë dhënë nga vëllai M.K, duke pretenduar se kjo marrëdhënie nuk ka qenë një marrëdhënie e mirëfilltë qiradhënieje, por një ndihmë për shkak të përdorimit pa shpërblim që vëllai i ka bërë pjesës takuese të subjektit tek pasuria bar-restorant-hotel “K”, i cili u është lënë trashëgimi nga babai. Sipas subjektit, ndarja e pjesëve takuese të kësaj pasurie nuk është formalizuar me dokumente për shkak të marrëdhënies familjare dhe me mirëbesim tre vëllezërit kane bërë ndarjen me short. Subjekti ka sqaruar se, duke qenë se ishte pa shtëpi, pasi ishte kthyer nga emigrimi, vëllai i madh ka menduar që t’i kthejë kontributin e tij të mëparshëm ndaj familjes, një lloj shpërblimi për përdorimin e pjesës takuese të pasurisë së lënë trashëgim nga babai, duke bërë të mundur blerjen e një apartamenti në Tiranë.

26.43 Sa i përket shumës 30.000 euro, që vëllai i ka marrë hua shtetasit Y.E, subjekti ka prapësuar se, ashtu siç është konstatuar edhe nga Komisioni, në vitet 2004 dhe 2005 ka pasur një fitim në vitin 2004 në shumën rreth 1.100.000 lekë dhe në vitin 2005 një fitim në shumën rreth 3.200.000 lekë dhe pavarësisht faktit nëse ka shpërndarë dividend apo jo, shtetasi Y.E ka pasur të ardhura të ligjshme për dhënien e huas prej 30.000 euro.

26.44 Subjekti thekson se kjo shumë nuk i është dhënë direkt atij si person, por vëllait të tij M.K, dhe në bazë të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, personi në fjalë do të kishte detyrimin të justifikonte të ardhurat nëse do të ishte në marrëdhënie huaje ose dhurimi me subjektin personalisht dhe jo me vëllain e tij. Subjekti ka referuar vendimin nr. ***, datë 16.5.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit³⁸, duke pretenduar se është mbajtur i njëjti qëndrim në një situatë të ngjashme.

26.45 Sa i përket shumës 7.000 euro, subjekti ka shpjeguar se kanë qenë kursime të tij ndër vite nga punësimi në Australi, por e ka të pamundur të gjejë dokumentacion justifikues për evidentimin dhe pagimin e taksave, pasi detyrimi për ruajtjen e këtij dokumentacioni ka një afat të caktuar ligjor dhe maksimumi i kohës për të cilën kompanitë janë të detyruara të ruajnë të dhënat është 7 vjet. Subjekti ka vënë në dijeni gjatë procesit të rivlerësimit se i është drejtuar me *email* kompanisë “M.C”, por nuk ka marrë përgjigje në lidhje me të dhënat e punësimit të

³⁸ Vendim i Kolegjit nr. 14/2022, datë 16.5.2022, paragrafët 17.7 dhe 17.8.

tij. Për sa më sipër, subjekti pretendon se ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi mosparaqitja e këtij dokumentacioni është për shkaqe të arsyeshme, nisur nga fakti që me ligj kompanitë janë të detyruara të ruajnë të dhënat deri në 7 vjet. Për sa më sipër, subjekti kërkon që të vlerësohet nga Komisioni se mosparaqitja e këtij dokumentacioni është bërë për shkaqe të arsyeshme.

26.46 Subjekti ka prapësuar se mosdeklarimi i këtyre të ardhurave prej tij ka ardhur për shkak të mungesës së eksperiencës, pasi ishte hera e parë që bënte një deklaram të tillë, dhe ka menduar se një gjë e tillë kuptohet vetvetiu. Në lidhje me këtë shumë, subjekti shprehet se nuk është pyetur asnjëherë nga ILDKPKI-ja as në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting* dhe në asnjë rast nuk ka pasur qëllim fsheheje, por ka qenë një harresë në plotësimin e deklaratës së pasurisë. Sipas subjektit, këto të ardhura janë krijuar përpara fillimit të detyrës dhe në qëndrimet e mbajtura nga Komisioni, rast pas rasti, mungesa e dokumentacionit justifikues për pasuritë e krijuara përpara fillimit të detyrës nuk përbën shkak për penalizimin e subjekteve të rivlerësimit, duke referuar për analogji vendimin nr. 81, datë 26.11.2018, të Komisionit³⁹, i cili ka marrë formë të prerë. Subjekti pretendon se të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie janë të ligjshme dhe nuk ka asnjë balancë negative në blerjen e saj. Subjekti ka depozituar si dokumentacion provues dokumentin e datës 11.1.2001 “F i P- A. M”, i lëshuar nga Konsulenca *** (i përkthyer nga gjuha angleze), drejtuar z. S. Kastrati, duke e njoftuar se sipas njoftimit të punëdhënësit anëtarësia në fondin e pensioneve ka përfunduar, duke pasur një përfitim total prej 2.641 USD. Sipas subjektit, ky dokument vërteton punësimin gjatë qëndrimit të tij në Australi pranë kompanisë “M.C”.

Vlerësimi i Komisionit për pasurinë apartament në Tiranë

26.47 Në lidhje me burimet e krijimit për pasurinë apartament në Tiranë, Komisioni pasi analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, konstaton se pas kalimit të barrës së provës ai nuk dokumentoi të ardhurat e ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit në vitin 2006, si dhe nuk provoi pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e përfituara nga qiradhënia e pasurisë, në kuptim të nenit D/3 të Aneksit të Kushtetutës, duke analizuar si vijon:

26.48 Sa i përket shumës 30.000 euro, marrë hua shtetasit Y.E, dhe pretendimit të subjektit se nuk ka detyrim të provojë burimet e ligjshme për këtë shumë, pasi ajo është hua e marrë nga vëllai dhe jo e subjektit të rivlerësimit, Komisioni konkludon se ky pretendim nuk qëndron, pasi huaja e marrë nga vëllai është përdorur si burim nga subjekti për krijimin e pasurisë apartament dhe në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjektet e rivlerësimit duhet të shpjegojnë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.

26.49 Përfundimisht, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të ardhurat e ligjshme të huadhënësit për shumën 30.000 euro, e përdorur si burim për krijimin e pasurisë apartament.

26.50 Lidhur me kursimet në vite në shumën 7.000 euro, subjekti përmes dokumentacionit të paraqitur në prapësime ka provuar anëtarësinë e tij në fondin e pensioneve deri në janar të vitit 2001, duke përfituar vlerën 2.641 USD. Këto të dhëna në mënyrë indirekte provojnë punësimin e subjektit në Australi, por jo masën e të ardhurave të realizuara nga ky punësim. Lidhur me pretendimet e subjektit se ndodhet në pamundësi objektive sipas parashikimeve të nenit 32/2 të

³⁹ Vendim i Komisionit nr. 81, datë 26.11.2018.

ligjit nr. 84/2016 për të siguruar dokumentacion të plotë mbi të ardhurat nga punësimi në Australi, Komisioni konkludon se ky pretendim i subjektit edhe në rast se do të konsiderohej si i tillë nuk do të ishte me peshë në vlerësimin përfundimtar, parë kjo së bashku me problematikat e tjera për kriterin e pasurisë.

26.51 Shpjegimet e subjektit mbi mosdeklarimin e kursimeve në DPV-në e vitit 2005 (para fillimit të detyrës), për shkak të mungesës së eksperiencës në plotësimin e deklarimit, nuk mund të justifikojnë detyrimin e tij ligjor për të deklaruar kursimet *cash* ndër vite. Nisur nga këto rrethana, bazuar edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit lidhur me mosdeklarimin e kursimeve *cash* ndër vite, Komisioni vlerëson se mungesa e deklarimit të kursimeve *cash* passjell pamundësinë për t'i përlllogaritur ato si të ardhura për vitin pasardhës.

26.52 Në lidhje me pasurinë apartament në Tiranë, trupi gjykues, pas vlerësimit të të gjithë dokumentacionit të administruar në dosje, si dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit dhe në seancë dëgjimore, konkludon se nuk u provuan nga subjekti të ardhurat e ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë apartament, sipas nenin D/3 të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

27. Apartament⁴⁰ i ndodhur në C, Durrës, blerë në vlerën 26.300 euro

27.1 Nga informacioni i ardhur nga Drejtoria Vendore e ASHK-së Durrës⁴¹ konfirmohet pasuria apartament, e regjistruar në pronësi të z. Sabri Kastrati.

27.2 FSHU-ja⁴² ka informuar se me gjeneralitetet Sabri Kastrati identifikohet një abonent me kontratën e furnizimit nr. DU***, në instancën Durrës. Nga të dhënat evidentohet se kontrata me FSHU-në është lidhur në datën 13.9.2007.

27.3 Ujësjellës Kanalizime Durrës⁴³ ka konfirmuar se në emrin e shtetasit Sabri Kastrati figuron në kontratë me nr. ***, me adresë Lagjja Nr. **, rruga “T”, pallati nr. ***, Durrës, e cila në sistemin e faturimit figuron në datën 1.1.2006, vit ky në të cilin është krijuar sistemi elektronik i shoqërisë. Kontrata është me status aktiv dhe me planin tarifor “sipas matësit familje me kanalizime”.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

27.4 Nga aktet në dosje ka rezultuar se subjekti Sabri Kastrati përmes kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.2.2008, ka blerë nga shoqëria “K” sh.p.k. një apartament me sipërfaqe 93,84 m², të ndodhur në Lagjen Nr. *, C, Durrës, kundrejt çmimit 26.300 euro. Kjo shumë është likuiduar midis palëve jashtë zyrës noteriale dhe apartamenti është regjistruar në pronësi të z. Sabri Kastrati, në datën 22.2.2008.

27.5 Subjekti ka deklaruar blerjen e këtij apartamenti në DPV-në e vitit 2008, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie.

27.6 Komisioni verifikoi lidhur me çmimin e blerjes së apartamentit krahasuar me vlerën e tregut të lirë të apartamenteve sipas çmimit të EKB-së⁴⁴ në vitin 2008, ku në zonën e Durrësit

⁴⁰ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.2.2008, sipas së cilës z. Sabri Kastrati blen nga shoqëria “K” sh.p.k. apartamentin me sip. 93,84 m² në z. k. ***, me nr. pasurie ***, vol. **, fq. **, në Lagjen Nr. *, C, Durrës, me çmim 26.300 euro, shumë e likuiduar jashtë zyrës noteriale, bashkëlidhur ndodhet kartela e pasurisë, me shënimin “Vihet në hipotekë ligjore në favor të Raiffeisen Bank me kontratë kredie nr. ***, datë 6.5.2008, për shumën 20.000 euro.

⁴¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.2.2024.

⁴² Me shkresën nr. *** prot., datë 27.12.2023.

⁴³ Me shkresën nr. *** prot., datë 22.2.2024.

⁴⁴ Udhëzimi nr.1, datë 20.8.2008 “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB për vitin 2008”.

vlera e apartamenteve ishte 70.586 lekë/m² dhe për apartamentin e blerë nga subjekti çmimi duhet të ishte 6.623.790 lekë (rreth 53.772 euro), ndërsa subjekti e ka blerë 26.300 euro, nga ku ngrihen dyshime për çmim fiktiv në blerjen e apartamentit, apo një çmim preferencial.

27.7 Komisioni ka hetuar lidhur me ndonjë konflikt të mundshëm interesi të subjektit të rivlerësimit me shoqërinë sipërmarrëse dhe administratorin e saj, ku nga përgjigjet e ardhura nga prokuroritë⁴⁵ ku subjekti ka ushtruar detyrën e tij nuk kanë rezultuar procedime penale të mosfilluara, pushuara, pezulluara apo të dërguara në gjykim në ngarkim të këtyre shtetasve.

Analizimi i burimit të krijimit të apartamentit nga Komisioni

27.8 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si burim për krijimin e kësaj pasurie një kredi bankare marrë në Raiffeisen Bank në shumën 20.000 euro dhe pjesa tjetër prej 6.300 euro është mbuluar nga kursimet e akumuluar ndë vite.

a) Lidhur me kredinë bankare në shumën 20.000 euro

27.9 Nga informacioni i ardhur nga Raiffeisen Bank⁴⁶ konfirmohet kredia bankare në shumën 20.000 euro, e marrë nga z. Sabri Kastrati me kontratën e kredisë datë 3.5.2008, disbursuar në datën 16.5.2008. Referuar të dhënave bankare, ka rezultuar se subjekti Sabri Kastrati përmes kontratës së kredisë bankare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.5.2008, ka marrë kredi në shumën 20.000 euro, me qëllim blerje shtëpie, me afat 300 muaj. Si garanci për ripagimin e kredisë është ofruar apartamenti me sip. 93,84 m², i ndodhur në C, Durrës, mbi të cilin është vendosur barrë hipotekore në favor të bankës.

27.10 Në deklaratën *Vetting*, si dhe deklaratimet periodike vjetore 2008 – 2016, subjekti ka deklaruar kredinë bankare dhe detyrimin e mbetur të pashlyer të kredisë.

27.11 Nga dokumentacioni bankar ka rezultuar se në datën 16.5.2008 subjekti ka transferuar fondet e kredisë në shumën 19.700 euro tek administratorin i kompanisë, me përshkrimin “Likuidim detyrimi ndaj Sh.K, për blerje apartamenti nga Sabri Kastrati”.

b) Lidhur me huan në shumën 20.000 euro, marrë nga shtetasi Sh.K në janar të vitit 2008

27.12 Në dosje është administruar kontrata e huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.1.2008, e nënshkruar midis z. Sabri Kastrati në cilësinë e huamarrësit dhe shtetasit Sh.K në cilësinë e huadhënësit, përmes së cilës subjekti ka marrë një hua në shumën 20.000 euro, pa interes dhe garanci hipotekore. Në kontratë përcaktohet se likuidimi i huas do të kryhej nga z. Sabri Kastrati në momentin e plotësimit të dokumentacionit për t’iu akorduar një kredi bankare dhe në rast se nuk i përgjigjet për likuidimin e huas, i jep të drejtën huadhënësit Sh.K që të ndërhyjë ligjërisht dhe t’i kompensohet kjo vlerë e dhënë hua nga vlera e apartamentit të banimit (2+1) në Durrës.

27.13 Komisioni ka hetuar lidhur me ndonjë konflikt të mundshëm interesi të subjektit me huadhënësin, apo administratorin e kompanisë “K”, ku nga përgjigjet e ardhura nga prokuroritë⁴⁷ ku subjekti ka ushtruar detyrën nuk ka rezultuar ndonjë procedim penal i regjistruar/heluar nga subjekti në ngarkim të këtij shtetasi.

⁴⁵ (1) Shkresa nr. *** prot., datë 4.4.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër (përfshirë edhe ish-Prokurorinë e Rrethit Mat); (2) shkresa nr. *** prot., datë 5.4.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës; (3) shkresa nr. *** prot., datë 24.4.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë (përfshirë edhe ish-Prokurorinë e Rrethit Mirditë); (4) shkresa nr. *** prot., datë 23.4.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

⁴⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 26.7.2021.

⁴⁷ (1) Shkresa nr. *** prot., datë 4.4.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dhe ish-Prokuroria e Rrethit Mat; (2) shkresa nr. *** prot., datë 5.4.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së

27.14 Në DPV-në e vitit 2008, subjekti nuk e ka deklaruar huan afatshkurtër në shumën 20.000 euro, marrë nga shtetasi Sh.K (deri në çeljen e kredisë nga Raiffeisen Bank), megjithëse është marrje/likuidim brenda vitit kalendarik. Gjithashtu, në deklaratën *Vetting* subjekti nuk e ka deklaruar këtë hua si burim për pagesën e kryer për blerjen e apartamentit.

27.15 Lidhur me këtë konstatim, subjekti ka shpjeguar⁴⁸ gjatë hetimit se mosdeklarimi i kësaj kontrate huaje ka ndodhur për faktin se huaja është shlyer brenda vitit, pasi ka marrë kredinë për blerje shtëpie dhe duke qenë se kjo shlyerje është kryer brenda vitit kalendarik nuk e ka deklaruar në deklarinimin periodik dhe as në deklaratën *Vetting*, pasi burimi real i krijimit të pasurisë është kredia bankare, të cilën vijon ta shlyejë edhe sot e kësaj dite.

Burimet e ligjshme të huadhënësit për shumën 20.000 euro

27.16 Komisioni, për shkak të marrëdhënies së huas, ka konsideruar shtetasin Sh.K si person tjetër i lidhur, në kuptim të pikës 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë i ka kërkuar⁴⁹ subjektit të deklarojë marrëdhënien që ka me këtë shtetas, si dhe të depozitojë dokumentacion provues mbi të ardhurat e ligjshme të huadhënësit për shumën 20.000 euro, deri në momentin e dhënies së huas.

27.17 Subjekti ka shpjeguar⁵⁰ se marrëdhënia e tij me këtë shtetas është marrëdhënie miqësore dhe farefisnore, përveç faktit se ka lidhje gjaku, janë rritur bashkë dhe miqësia e tyre është që nga fëmijëria. Sipas subjektit, pallati ku ka blerë apartamentin është ndërtuar nga shoqëria “K”. Lidhur me të ardhurat e ligjshme të huadhënësit, subjekti ka depozituar⁵¹ si dokumentacion provues:

- deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.10.2023, e lëshuar nga shtetasi Sh.K, i cili deklaron se në janar të vitit 2008 i ka dhënë z. Sabri Kastrati shumën prej 20.000 euro për blerjen e një apartamenti, të cilën ia ka kthyer pasi ka marrë kredinë bankare në datën 16.5.2008. Ky shtetas deklaron se burimi është nga të ardhurat e tij si ortak dhe administrator i shoqërive “K” sh.p.k dhe “K” sh.a.
- bilancin e shoqërisë “K” sh.a., për periudhën 1.1.2007 – 31.12.2007;
- ekstraktin e regjistrit tregtar të shoqërisë “K” sh.a., me NIPT J***N, e datës 27.10.2023;
- nxjerrje llogarie bankare⁵² e shoqërisë “K” sh.a. për periudhën 1.12.2007 – 17.12.2007;
- dy vërtetime⁵³ të lëshuara nga administratori i shoqërisë “K” sh.a. (pa datë), ku konfirmohet se shtetasi Sh.K ka qenë aksioner me 17.35 % të aksioneve, gjithashtu i punësuar pranë kësaj shoqërie për vitet 1999 – 2012, në pozicionin drejtor dege- menaxher shitjeje, me pagë vjetore 296.499 lekë;
- kopje të listëpagesave⁵⁴ mbi punësimin e shtetasit Sh.K për periudhat korrik – dhjetor 1999, maj – dhjetor 2000, janar – dhjetor dhe për vitet 2001 – 2007.

27.18 Nga verifikimi i regjistrit tregtar në sistemin e QKB-së, ka rezultuar se shtetasi Sh.K deri në vitin 2011 nuk figuron as ortak dhe as administrator i shoqërisë “K” sh.p.k. (me NUIS

Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës; (3) shkresa nr. prot. ***, datë 24.04.2024 e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe ish-Prokuroria e Rrethit Mirditë; (4) shkresa nr. *** prot., datë 23.4.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

⁴⁸ Shpjegimet e subjektit të depozituara në datën 30.10.2023, në përgjigje të pyetësorit datë 20.10.2023.

⁴⁹ Përmes pyetësorit me *email*-in datë 20.10.2023.

⁵⁰ Shpjegimet e subjektit të depozituara në datën 30.10.2023.

⁵¹ Dokumentacion i depozituar në datën 30.10.2023.

⁵² Dokument i depozituar nga subjekti në datën 2.4.2024.

⁵³ Dokumentacion shtesë i dërguar nga subjekti në datën 30.4.2024, në vijim të përgjigjeve të pyetësorit të dërguar në datën 2.4.2024.

⁵⁴ Shpjegimet e subjektit të depozituara në datën 13.6.2024, në përgjigje të pyetësorit datë 28.5.2024.

J***P), ndërsa tek shoqëria “K” sh.a. (me NUIS J***N) nga viti 2004 ky shtetas rezulton aksioner me 17.35% të aksioneve të shoqërisë.

27.19 Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës⁵⁵ ka dërguar bilancet e shoqërisë “K” sh.a. për periudhën 2007 – 2011, duke informuar se nuk ka pagesë për tatimin mbi dividendin dhe se bazuar në vendimet e Asamblesë së Shoqërisë është vendosur që për fitimet e viteve 2007, 2009, 2010 dhe 2011 të mos shpërndahet dividend.

27.20 Gjatë hetimit, subjekti ka shpjeguar⁵⁶ se fakti që administratori i shoqërisë “K” nuk ka tërhequr dividend në vitin 2007, nuk do të thotë se ai nuk ka pasur mundësi që të tërheqë para nga llogaria e shoqërisë e më pas t’i depozitojë këto para përsëri në llogarinë e shoqërisë brenda po këtij viti, në rastin konkret brenda 3 muajve. Subjekti ka sqaruar se ky veprim nuk i bën këto të ardhura të paligjshme, pasi ato janë tërhequr dhe depozituar në llogarinë e shoqërisë brenda vitit dhe nuk janë rezultat i tërheqjes së dividendit dhe nëse shihet bilanci i shoqërisë, dukshëm tregohet se ka pasur mundësi për tërheqjen e kësaj shume.

Analiza mbi mundësitë financiare të huadhënësit për shumën 20.000 euro

27.21 Komisioni analizoi të ardhurat nga paga neto e huadhënësit për periudhën 1999 – 2007, duke i zbritur shumës totale neto vetëm shpenzimet për një person sipas standardit të ILDKPKI-së dhe nga analiza ka rezultuar një balancë negative, në shumën -2.119.480 lekë.

c) Kursimet ndër vite në shumën 6.300 euro

27.22 Gjatë hetimit, subjekti ka shpjeguar⁵⁷ se pagesa e shumës 6.300 euro është kryer në momentin e lidhjes së kontratës dhe ka qenë nga kursimet ndër vite, ku për vitin 2007 ka deklaruar gjendje *cash* 750.000 lekë, të kursyera nga paga e tij dhe e bashkëshortes.

27.23 Nga verifikimi i deklarimeve periodike, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në banesë vetëm në DPV-në e vitit 2007⁵⁸, në shumën 750.000 lekë. Kjo shumë e konvertuar në euro me kursin mesatar vjetor të vitit 2008, do të ishte rreth 6.200 euro.

27.24 Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni për vitin 2007 (referuar tabelës së përgjithshme të analizës financiare), subjekti ka rezultuar me balancë negative në shumën 970.870 lekë, për vitin 2007, çka tregon pamundësi për krijimin e kursimeve *cash*. Gjithashtu, subjekti nuk ka deklaruar pakësimin e gjendjes *cash* prej 750.000 lekësh në DPV-në e vitit 2008, vit i blerjes së apartamentit në Durrës.

27.25 Shpenzimet e mobilimit sipas deklarimeve të subjektit në pyetësorit standard për banesën në Durrës janë rreth 500.000 lekë, të cilat janë reflektuar në analizën financiare në vitet 2008 e 2009, përkatësisht 250.000 lekë për secilin vit.

Konstatimet e Komisionit

27.26 Nga hetimi i Komisionit për apartamentin e ndodhur në C, Durrës, rezultoi:

- Pasaktësi në deklarimin e subjektit, pasi gjatë hetimit ka rezultuar se huaja prej 20.000 euro është përdorur si pagesë për blerjen e apartamentin në Durrës, ndërsa kredia bankare

⁵⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 5.4.2024 dhe shkresën nr. *** prot., datë 7.5.2024.

⁵⁶ Shpjegimet e subjektit të depozituara në datën 2.4.2024.

⁵⁷ Shpjegimet e subjektit të depozituara në datën 20.5.2024.

⁵⁸ Dorëzuar në datën 28.3.2008 pranë ILIDKPKI-së.

është marrë disa muaj pas blerjes së apartamentit, e cila ka shërbyer për shlyerjen e huas gjatë po këtij viti, 2008.

- Subjekti ka lidhur me FSHU-në kontratën për furnizim me energji elektrike në datën 13.9.2007, disa muaj para blerjes së apartamentit, dhe subjekti nuk e ka deklaruar në DPV-në e vitit 2007 përdorimin e kësaj pasurie deri në vitin 2008. Është e paqartë se si është lidhur kontrata me FSHU-në nga subjekti, ndërsa veprimet për marrjen e huas për blerjen e apartamentit dhe kredia bankare janë kryer disa muaj më vonë.
 - Subjekti nuk ka dokumentuar të ardhurat e ligjshme të huadhënësit për shumën 20.000 euro.
 - Pamundësi financiare për krijimin e kursimeve *cash* në shumën 6.300 euro, për vitin 2007.
 - Ngrihen dyshime për çmim fiktiv në blerjen e apartamentit, pasi referuar çmimit të EKB-së për vitin 2008, vlera e apartamentit do të ishte 6.623.790 lekë (rreth 53.772 euro), ndërsa subjekti e ka blerë 26.300 euro.
- ✓ Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

27.27 Subjekti ka shpjeguar se burimi real i krijimit të kësaj pasurie është kredia bankare e marrë prej tij, të cilën ia ka kthyer huadhënësit brenda 3 muajsh. Lidhur me çmimin e blerjes së apartamentit, subjekti ka shpjeguar se marrëdhënia e tij me shtetasin Sh.K është një marrëdhënie fafëfisnore dhe miqësore, dhe fakti që çmimi i blerjes së apartamentit ka qenë preferencial, është sepse ka paguar vetëm çmimin e kostos së këtij apartamenti, por nuk ka asnjë lidhje me funksionin e tij si prokuror. Ashtu siç edhe e ka përmendur gjatë hetimit, me huadhënësin ka lidhje gjaku, por edhe marrëdhënie shoqërore që në kohën e fëmijërisë. Subjekti ka prapësuar se edhe nga Komisioni është vërtetuar se nuk ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, pasi nuk ka hetuar ndonjëherë ndonjë çështje penale ndaj shoqërisë “K” apo shtetasit Sh.K.

27.28 Sa i përket lidhjes së kontratës së energjisë elektrike të datës 13.9.2007, subjekti pranon se kjo kontratë është lidhur përpara marrjes në dorëzim të apartamentit dhe blerjes së tij, por kjo ka ndodhur se në këtë kohë apartamenti nuk kishte përfunduar ende dhe kishin rënë dakord në parim që në fillim se këtë apartament do ta blinte subjekti. Subjekti ka prapësuar se në rast se nuk do të kishte mundësi të blinte apartamentin, kjo kontratë mund të zgjidhej lehtësisht dhe do të lidhej me një blerës tjetër potencial. Subjekti sqaron sa nuk mund të deklaronte blerjen e apartamentit në vitin 2007, në një kohë që nuk e kishte blerë ende.

27.29 Në lidhje me të ardhurat e ligjshme të huadhënësit, subjekti ka sqaruar se është e vërtetë se shoqëria nuk ka shpërndarë dividend, por është gjithashtu e vërtetë se kjo shoqëri ka marrë kredi për zhvillimin e biznesit dhe shtetasi Sh.K ka tërhequr nga llogaritë e shoqërisë shumën në fjalë në atë periudhë, gjë që provohet nga veprimet e tij bankare. Sipas subjektit, shtetasi Sh.K ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për të dhënë hua shumën në fjalë, pavarësisht se shoqëria nuk ka shpërndarë dividend, duke referuar vendimin e Kolegjit të Posaçëm i Apelit nr. 14, datë 16.5.2022.

27.30 Për sa i përket mosdeklarimit të huas, marrë shtetasit Sh.K në vitin 2008, subjekti ka shpjeguar se kjo ka ardhur për faktin se huaja është shlyer brenda vitit në fjalë dhe në leximin

e formularit të vetëdeklarimit nuk ka pasur rubrikë për deklarimin e kësaj huaje, pasi realisht objekti është blerë me të ardhurat e marra nga kredia bankare. Subjekti ka prapësuar se është provuar se kjo shumë sapo është tërhequr nga banka është depozituar në llogarinë bankare të shtetasit Sh.K dhe nuk ka pasur asnjë qëllim fshehjeje, pasi këto veprime janë kryer nëpërmjet sistemit bankar dhe janë lehtësisht të verifikueshme.

27.31 Lidhur me konstatimin e Komisionit për pamundësi financiare për krijimin e shumës 6.300 euro, subjekti prapëson se ky konstatim nuk i përgjigjet realitetit, pasi po të merren në konsideratë të ardhurat e tij dhe të bashkëjetueses, si dhe shpenzimet e deklaruara për atë vit, balanca është pozitive.

27.32 Lidhur me mosdeklarimin e pakësimit të kursimeve *cash* në vitin 2008, subjekti sqaron se kjo është një pasaktësi në plotësimin e formularit, pasi në vitet në vijim nuk ka deklaruar kursime *cash* dhe kjo është lehtësisht e verifikueshme nga formularët e deklarimit të pasurisë ndër vite. Duke qenë se në formularin e vitit 2008 nuk ka deklaruar gjendje *cash* në banesë, ka menduar se ky pakësim do të kuptohej vetvetiu. Subjekti kërkon që në këtë rast Komisioni të marrë në konsideratë situatën faktike dhe jo lapsuset në plotësimin e formularit, pasi kjo nuk ka qenë e qëllimshme, duke iu referuar vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 28, datë 23.10.2020, i cili ka mbajtur qëndrim në lidhje me pasaktësitë në deklarime. Për sa shpjeguar më sipër, subjekti pretendon se të ardhurat për blerjen e kësaj pasurie janë të ligjshme dhe nuk ka balanca negative, ndërsa për mosdeklarimin e pakësimit të gjendjes *cash* në vitin 2008, thekson se kjo ka ardhur pasi ka menduar se kjo gjë do të kuptohej vetvetiu.

27.33 Subjekti, ndër të tjera, ka prapësuar se balanca negative e llogaritur nga Komisioni për vitin 2008 është nxjerrë për shkak të mosmarrjes parasysh të kredisë për blerjen e apartamentit në C, si dhe duke konsideruar pamundësinë e huadhënësit Sh.K për dhënien e huas, pasi shoqëria nuk ka shpërndarë dividend. Subjekti thekson se burimi real i blerjes së kësaj pasurie është kredia bankare, si dhe fakti që shtetasi Sh.K shumë e dhënë hua e ka tërhequr nga llogaritë e shoqërisë. Kjo mund të përbëjë shkelje administrative për subjektin, por nuk mund të përliqë shkarkimin nga detyra si subjekt rivlerësimi, kjo duke u bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Subjekti ka depozituar si dokumentacion provues⁵⁹ kontratat për marrjen e kredive bankare nga shoqëria “K” sh.a.

Vlerësimi i Komisionit për apartamentin në C, Durrës

27.34 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit dhe akteve të administruara në dosje, çmon të renditë disa fakte të rezultuara gjatë hetimit administrativ, si vijon:

i) Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe as në DPV-në e vitit 2008 huan në shumë 20.000 euro, të marrë nga shtetasi Sh.K, si burim për blerjen e apartamentit, ndërsa ka deklaruar si burim të vetëm kredinë bankare të marrë pranë Raiffeisen Bank.

⁵⁹ Dokumentacion i depozituar nga subjekti në prapësime: (1) kontratë kredie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.1.2008 “Shtojcë kontratë për dhënie kredie bankare në një llogari huaje” nr. ***, datë 4.1.2008, përmes së cilës shoqëria “K” sh.a. ka marrë nga Tirana Bank një kredi në vlerën 78.000.000 lekë. Bashkëlidhur ndodhet nxjerrja e llogarisë së shoqërisë “K.G” sh.a. në monedhat lek dhe euro, për periudhën 26 gusht – 28 gusht 2024 (dokumentacion i njehsuar me origjinalin me vërtetimin nr. *** rep., datë 28.8.2024); (2) kontratë kredie bankare nr. ***rep., nr. *** kol., date 3.12.2008, përmes së cilës shoqëria “K” sh.a. ka marrë pranë Intesa Sanpaolo Bank një kredi në shumë 700.000 euro (dokumentacion i njehsuar me origjinalin me vërtetimin nr. *** rep., datë 28.8.2024).

ii) Përmes kontratës së huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.1.2008, subjekti ka provuar e dokumentuar marrëdhënien e huas.

iii) Referuar lëvizjeve bankare, provohet se subjekti ka transferuar fondet e kredisë tek huadhënësi, administratori i kompanisë, për shlyerjen e huas.

iv) Huaja e marrë provohet të jetë shlyer me kredinë brenda disa muajve, brenda të njëjtit vit.

Për rrjedhojë, trupi gjykues konkludon se kredia, në vlerësim përfundimtar të fakteve dhe provave, duhet konsideruar si burim i ligjshëm për krijimin e pasurisë.

27.35 Sa i përket pretendimit të subjektit për përfshirjen në analizë financiare të kredisë bankare të marrë pranë Raiffeisen Bank, në shumën 20.000 euro, nga aktet e administruara në dosje rezulton e provuar që kjo kredi në mënyrë direkte ka shlyer huan e marrë disa muaj më parë, duke shërbyer si burim për blerjen e apartamentit në Durrës. Për rrjedhojë, Komisioni rishikoi analizën financiare, duke e konsideruar kredinë bankare si burim për krijimin e kësaj pasurie.

27.36 Në lidhje me të ardhurat e ligjshme të huadhënësit në shumën 20.000 euro, Komisioni konstaton se, edhe pse marrëdhënia e huas rezulton e dokumentuar/provuar dhe bindëse, subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimin e nenit 32/3 për të provuar me dokumentacion justifikues ligjor burimet e ligjshme të huadhënësit.

27.37 Në lidhje me kursimet në shumën 6.300 euro, në vitin 2007, nga analiza pas prapësimeve ka rezultuar pamundësi për krijimin e këtyre kursimeve.

27.38 Në lidhje me pretendimet e subjektit se mosdeklarimi i pakësimit të kursimeve *cash* në DPV-në e vitit 2008 është një pasaktësi në deklaram, Komisioni, referuar ligjit nr. 9049/2003, i cili në mënyrë të qartë kërkon nga subjektet deklaruese të shprehen për ndryshimet (shtesa dhe pakësime) edhe të vlerës së likuiditeteve, gjendjes *cash* apo llogarisë bankare, vëren se nga hetimi i kryer nuk ka rezultuar që kjo pasaktësi të ketë shërbyer për fshehjen e veprimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë pasuri, apo të ketë shërbyer si burim për krijimin e ndonjë pasurie tjetër, çka krijon bindjen se pasaktësia e konstatuar është e paqëllimshme.

27.39 Në lidhje me konstatimin për çmim fiktiv në blerjen e apartamentit, Komisioni, nisur nga një diferencë e konsiderueshme midis çmimit të blerjes së apartamentit krahasuar me çmimet referuese sipas udhëzimit të EKB-së për vitin 2008, konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar në deklaratën periodike të këtij viti këtë “trajtim preferencial” në çmimin e blerjes, për shkak të marrëdhënies miqësore dhe fafëfisnore që ka pasur me këtë shtetas.

27.40 Trupi gjykues, duke mbajtur në konsideratë: (i) parashikimet e nenit 660 të Kodit Civil, lidhur me lirinë kontraktore të palëve të përfshira në transaksionin e shitblerjes; (ii) faktin që gjatë hetimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë në drejtim të ekzistencës së një konflikti të mundshëm interesi mes subjektit dhe shitësit, apo huadhënësit; (iii) ashtu sikundër nuk rezultoi që të ketë pasur gjetje nga hetimi administrativ që të provojë se subjekti ka paguar efektivisht një vlerë më të lartë nga ajo e deklaruar në kontratë, si dhe bazuar në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjtit⁶⁰ – konkludoi se ky konstatim nuk mund të sjellë pasoja në vlerësimin e kësaj pasurie.

28. Njësi⁶¹ me sipërfaqe 61,2 m² në Y, Tiranë, në vlerën 100.000 euro

⁶⁰ Vendim i Kolegjtit nr. 11, datë 22.5.2019, paragrafi 19.

⁶¹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (1) Deklaratë për heqje dorë nga pronësia nr. ***, datë 16.9.2013, ku shtetasi V.K deklaroi se ka lidhur kontratë porosie nr. ***, datë 11.5.2010, me shoqërinë “E” sh.p.k., për njësi me sip. 70,4 m², përfshirë edhe sipërfaqen e përbashkët, në rrugën “U e R”, Tiranë; (2) Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 1.10.2013, për njësi me sip. 61,2 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. **, fq. ***, në pronësi të z. Sabri Kastrati. Bashkëlidhur kartela e pasurisë;

28.1 Nga informacioni i ardhur nga Drejtoria Vendore e ASHK-së Tirana Rurale ⁶², konfirmohet pasuria njësi me sip. 61,2 m², me nr. ***, e regjistruar në emër të z. Sabri Kastrati.

28.2 FSHU-ja⁶³ ka informuar se z. Sabri Kastrati nuk rezulton të jetë abonent apo të ketë kontratë të furnizimit me energji elektrike me FSHU/OSHE, ndërsa në emër të shtetasit V.K identifikohet një kontratë furnizimi në instancën Tiranë. Nga të dhënat evidentohet kontrata e datës 23.7.2010, me vendndodhje në zonën e Kasharit.

28.3 UKT-ja⁶⁴ ka informuar se në emër të shtetasit V.K rezulton kontrata nr. ***, për objektin në adresën rruga “T.K” (U e R), Tiranë, me status aktiv, në kategorinë e konsumatorëve privatë. Bashkëlidhur shkresës ndodhet kontrata e porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.5.2010, e lidhur midis shoqërisë “E” sh.p.k. dhe porositësit V.K.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

28.4 Nga aktet e administruara në dosje, kanë rezultuar faktet si vijon:

- i) Vëllai i subjektit, z. V.K, ka nënshkruar në cilësinë e porositësit një kontratë porosie (për ndërtim ambienti shërbimi dyqan) me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.5.2010, me shoqërinë investitore “E” sh.p.k., me ortak dhe administrator të vetëm shtetasin E. D, për ndërtimin⁶⁵ e një dyqani me sipërfaqe totale 70,4 m², të ndodhur në rrugën “T.K”, U e R, Tiranë, në katin * teknik, në vlerën 100.000 euro.
- ii) Përmes një deklarate për heqje dorë nga pronësia, me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.9.2013, vëllai i subjektit, z. V.K, ka hequr dorë nga vazhdimi i procedurave të hipotekimit të kësaj njësie, duke ia kaluar këtë të drejtë z. Sabri Kastrati, me kushtin që

(3) Kontratë porosie nr. ***, datë 11.5.2010, përmes së cilës shtetasi V.K porosit pranë shoqërisë “E” sh.p.k. pasurinë dyqan me sip. 70,4 m², përfshirë sipërfaqen e përbashkët, në katin * teknik, në rrugën “T.K”, U e R, Tiranë, me çmim 1.420 euro/m², në total 100.000 uro. Bashkëlidhur leja e ndërtimit dhe dokumentet e identifikimit të palëve; (4) Mandat tërheqjeje nga ProCredit Bank, datë 11.5.2010, nga shtetasi V.K të shumës 50.000 euro; mandatarëtimi nr. ***, datë 11.5.2010, i shoqërisë “E” sh.p.k., për shumën 50.000 euro, arkëtuar nga shtetasi V.K për paradhënie për blerje njësi tregtare; mandatarëtimi nr. ***, datë 14.6.2010, i shoqërisë “E” sh.p.k., për shumën 15.000 euro, arkëtuar nga shtetasi V.K për blerje dyqani me sip. 70,4 m²; mandatarëtimi nr. ***, datë 23.10.2010, i shoqërisë “E” sh.p.k., për shumën 5.000 euro, arkëtuar nga shtetasi V.K; mandatarëtimi nr. ***, datë 31.1.2012, i shoqërisë “E” sh.p.k., për shumën 5.000 euro, arkëtuar nga shtetasi V.K; mandatarëtimi nr. ***, datë 2.5.2011, i shoqërisë “E” sh.p.k., për shumën 5.000 euro, arkëtuar nga shtetasi V.K; mandatarëtimi nr. ***, datë 9.6.2011, i shoqërisë “E” sh.p.k., për shumën 5.000 euro, arkëtuar nga shtetasi V.K; (5) Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 20.9.2013, sipas së cilës z. Sabri Kastrati ka blerë nga shoqëria “E” sh.p.k. njësinë nr. *, me sip. 61,2 m² + 9,2 m² sipërfaqe të përbashkët, në katin përdhe, shkalla *, z. k. ***, me nr. pasurie ***, vol. **, fq. ***, me çmim 100.000 euro ose 13.500.000 lekë, shumë e likuiduar sipas kontratës së porosisë nr. ***, datë 11.5.2010. Bashkëlidhur certifikata e pronësisë në emër të shoqërisë; (6) Prokurë e posaçme nr. ***, datë 12.10.2015, për dhënien e tagrave të përfaqësimit V.K nga Sabri Kastrati, për lidhjen e kontratave të qirasë, nënqirasë, huapërdorjes pa kundërshpërbllim të pasurisë nr. ***, njësi me sip. 61,2 m². Përfaqësuesi ka të drejtë të vendosë vetë çmimin, afatin, kushtet etj. dhe kjo prokurë është pa afat, deri në revokimin e saj; (7) Kontratë qiradhënieje nr. ***, datë 12.10.2015, sipas së cilës shtetasi V.K, si përfaqësues i z. Sabri Kastrati, u jep me qira shtetasve M dhe E.H njësinë me sip. 61,2 m², me afat 5 + 5 vjeçar, me të drejtë ripërsëritjeje, me qira 50.000 lekë/muaj; (8) Certifikatë e regjistrimit të biznesit të vogël V.K me NIPT K***C, regjistruar në gjykatë me vendimin nr. **, datë 1.3.2007; (9) Ekstrakt historik i QKR-së, V.K, me NIPT K***C, person fizik, dt. regjistrimi 16.1.2007, me aktivitet ‘Tregtim i artikujve të përzier ushqimore, industrialë, pjesë këmbimi, mobilieri, prodhime buke, hotel-restorant, vendimi ushtrimi të aktivitetit Lagjja Nr. *, Kukës, me status “aktiv”; (10) Shkresë nr. *** prot., datë 24.3.2015, i DRT Tiranë drejtuar shtetasit V.K, me NIPT L***U, me aktivitet bar-kafe, në godinën ** kat, Unaza e re, pranë A, Tiranë, për pagesë të detyrimeve tatimore; (11) Formular i pagesës së sigurimeve shoqërore nga shtetasi V.K me NIPT L***U, datë 3.2.2014; (12) Nxjerrje llogarie e shtetasit V.K në Raiffeisen Bank, e datës 20.1.2016, për periudhën 18.12.2006 – 20.1.2016; (13) Nxjerrje llogarie në ALL e shtetasit V.K në Raiffeisen Bank, e datës 20.1.2016, për periudhën 18.12.2006 – 20.1.2016; (14) Nxjerrje llogarie e shtetasit V.K në *** për periudha të ndryshme të vitit 2014 dhe 2015, me transferata kreditore pagash, kryesisht nga “****”, dhe nxjerrje balancash të muajve të ndryshëm; (15) Nxjerrje llogarie e shtetasit V.K në ***, printim i datës 1.2.2016, me transaksione debi - kredi, të periudhave të ndryshme gjatë viteve 2010, 2011 dhe 2016.

⁶² Me shkresën nr. *** prot., datë 21.3.2024.

⁶³ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.12.2023.

⁶⁴ Me shkresat nr. K-*** prot., datë 2.8.2021 dhe nr. K-*** prot., datë 30.7.2021.

⁶⁵ Sipas lejes së ndërtimit të lëshuar për subjektin ndërtues, shoqëria “E” sh.p.k., bazuar në vendimin e KRRT-së nr. **, datë 18.10.2006, për “Godinë banimi dhe shërbimi 3-8-9-10-11 kate + 1 kat nëntokë”, ku afati kohor i kësaj lejeje është deri në datën 18.10.2008.

subjekti të kalojë në favor të vëllait pasurinë bar-restorant “K” në Lagjen Nr. *, Kukës, i cili është në proces legalizimi. Pas nënshkrimit të aktit përfundimtar të shitblerjes së bar-restorantit dhe pajisjes me certifikatë pronësie, shtetasi V.K i detyrohet z. Sabri Kastrati edhe shumë prej 100.000 euro.

iii) Në vijim, midis subjektit dhe shoqërisë ndërtuese “E” sh.p.k. është lidhur kontrata e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.9.2013, për blerjen e njësisë kundrejt çmimit 100.000 euro/13.500.000 lekë, i likuiduar sipas kontratës së porosisë datë 11.5.2010. Kjo pasuri është regjistruar në pronësi të z. Sabri Kastrati në datën 1.10.2013.

28.5 Në DPV-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar pasurinë njësi me sip. 61,2 m², në Yzberisht, në vlerën 13.500.000 lekë/100.000 euro.

28.6 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se deri në momentin e kryerjes së procedurave të regjistrimit, njësia është në përdorim⁶⁶, pa kundërshtim, të vëllait V.K dhe në rast se nuk bëhet regjistrimi i pronës bar-restorant “K” sipas kushteve të përmendura në deklaratën e heqjes dorë, pronësia mbi këtë njësi i kalon përsëri të vëllait V.K.

Lidhur me pagesat për blerjen e dyqanit

28.7 Referuar kontratës së porosisë datë 11.05.2010, pala porositore V.K (vëllai i subjektit) dhe pala investitore kanë përcaktuar çmimin e dyqanit prej 100.000 euro dhe shuma prej 6.000 euro i likuidohet në momentin e firmosjes së kontratës, kësti prej 70.000 euro do të paguhej deri në datën 2.6.2010, kësti prej 15.000 euro do të paguhej në momentin e marrjes së lejes së shfrytëzimit dhe kësti i fundit prej 9.000 euro me marrjen e hipotekës. Palët kanë përcaktuar se pagesat do të bëhen me mandatpagesë ose transfertë bankare.

28.8 Në dosje janë administruar mandatet e arkëtimit⁶⁷ për pagesat e kryera nga vëllai i subjektit V.K, të cilat në total shkojnë në vlerën 85.000 euro, ndërsa pagesa e mbetur prej 15.000 euro nuk u dokumentua nga subjekti.

28.9 I pyetur nga Komisioni në lidhje me këtë pagesë, subjekti ka shpjeguar⁶⁸ se shuma 15.000 euro është paguar nga vëllai V.K, por nuk rezulton ta ketë ruajtur këtë mandatarëkëtim.

28.10 Komisioni ka hetuar lidhur me ndonjë konflikt të mundshëm interesi të subjektit me shoqërinë ndërtuese dhe përfaqësuesit e tyre dhe nga përgjigjet e ardhura nga prokuroritë⁶⁹ nuk rezultuan procedime penale të regjistruara në ngarkim të këtyre shtetasve.

⁶⁶ Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka depozituar aktet noteriale si vijon: (1) prokurë e posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.10.2015, përmes së cilës subjekti cakton si përfaqësues ligjor vëllain e tij V.K, duke i dhënë tagra të plota veprimi për lidhjen e kontratave të qirasë, nënqirasë, huapërdorjes pa kundërshtim të pasurisë njësi me sip. 61,2 m², në Yzberisht; (2) kontratë qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.10.2015, e lidhur midis qiradhënësit Sabri Kastrati, i përfaqësuar me prokurë nga V.K, dhe qiramarrësve M.H e E.H, për dhënien me qira të njësisë, për aktivitet privat bar-kafe, me afat 5 + 5 vjeçare, me të drejtë ripërsëritjeje me marrëveshje të përbashkët, me qira mujore 50.000 lekë/muaj. Kontrata i fillon efektet në datën 1.12.2015.

⁶⁷ (1) Mandat tërheqjeje datë 11.5.2010 nga ProCredit Bank, për tërheqjen e shumës 50.000 euro nga shtetasi V.K, ku duket se kjo shumë është tërhequr në të njëjtën datë kur është nënshkruar kontrata e porosisë datë 11.5.2010; (2) mandatarëkëtimi nr. ***, datë 11.5.2010, i shoqërisë “E” sh.p.k., për arkëtimin e shumës 50.000 euro nga shtetasi V.K, me përshkrimin “Paradhënie për blerje njësi tregtare”; (3) mandatarëkëtimi nr. **, datë 14.6.2010, i shoqërisë “E” sh.p.k., për arkëtimin e shumës 15.000 euro nga shtetasi V.K, me përshkrimin “Blerje dyqani Njësia nr. *, shk. *, me sip. 70,4 m²”; (4) mandatarëkëtimi nr. ***, datë 23.10.2010, për arkëtimin e shumës 5.000 euro nga shtetasi V.K; (5) mandatarëkëtimi nr. ***, datë 2.5.2011, për arkëtimin e shumës 5.000 euro nga shtetasi V.K; (6) mandatarëkëtimi nr. ***, datë 9.5.2011, për arkëtimin e shumës 5.000 euro nga shtetasi V.K; (7) mandatarëkëtimi nr. ***, datë 31.1.2012, për arkëtimin e shumës 5.000 euro nga shtetasi V.K.

⁶⁸ Shpjegimet e subjektit të depozituara në datën 2.4.2024.

⁶⁹ (1) Shkresa nr. *** prot., datë 4.4.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër (përfshirë edhe ish-Prokurorinë e Rrethit Mat); (2) shkresa nr. *** prot., datë 5.4.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së

Burimi i krijimit

28.11 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si burim për krijimin e kësaj pasurie deklaraten noteriale nr. ***, datë 16.9.2013, përmes së cilës vëllai V.K ka hequr dorë nga pronësia mbi njësinë (dyqanin), duke ia kaluar këtë të drejtë subjektit Sabri Kastrati, duke e shkëmbyer me pjesën e bar-restorant “K”, të ndodhur në K.

28.12 Komisioni i ka kërkuar⁷⁰ subjektit të deklarojë lidhur me vlerat e dy pasurive të shkëmbyera, pasi është e qartë vetëm vlera e njësisë plus shuma prej 100.000 euro që vëllai do të paguajë, në total vlera 200.000 euro. Ndërsa për pasurinë tjetër, subjekti ka shpjeguar⁷¹ ndër të tjera se *kanë rënë dakord me vëllain për ta shkëmbyer me bar-restorant “K” në Kukës (si pasuri e tij), pasi të kryhen veprimet për regjistrimin e saj pranë ASHK-së. Sipas subjektit, ky shkëmbim do të quhet i përfunduar kur të kryhet legalizimi dhe regjistrimi përfundimtar i objektit dhe në bazë të deklaratës noteriale datë 16.9.2013 vëllai do të paguajë edhe shumë prej 100.000 euro. Subjekti ka sqaruar⁷² se shkëmbimi përfundimtar i kësaj pasurie nuk ka ndodhur, pasi nuk është kryer legalizimi i objektit akoma e, për pasojë, edhe pagesa prej 100.000 euro nuk është kryer. Sipas subjektit, nëse nuk ndodh legalizimi i objektit, në bazë të neneve 757 e vijues të Kodit Civil, palët do të kthehen në gjendjen e mëparshme. Subjekti ka shpjeguar se vlerat e përcaktuara në shkëmbim janë vlera të dakordësuara ndërmjet tij dhe vëllait, me vullnetin e tyre të lirë, në bazë të parimit të lirisë ekonomike të sanksionuar në Kushtetutë (neni 11) dhe kanë të bëjnë me vlerën reale të tregut të këtyre objekteve në vitin 2013, dhe nuk është vlera e investimit në vitet 2000 për pasurinë bar-restorant “K”, pas 13 vitesh normalisht që vlera e objektit është rritur.*

Lidhur me të ardhurat e ligjshme të vëllait të subjektit për blerjen e njësisë

28.13 Nisur nga fakti që njësia është pasuri në pronësi të subjektit, e deklaruar në deklaratën *Vetting*, në përputhje me nenin D/3 të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave, dhe në përputhje me nenin 32/1 të ligjit nr. 84/2016 iu kërkuar⁷³ dokumentacion justifikues mbi burimin e ligjshëm të të ardhurave të vëllait V.K, të cilat kanë shërbyer për blerjen e njësisë në vlerën 100.000 euro.

28.14 Subjekti ka shpjeguar⁷⁴ se vëllai i tij ka pasur aktivitet tregtar si person fizik në Shqipëri dhe gjithashtu ka jetuar e punuar edhe në Angli. Për të provuar burimin e ligjshëm të këtyre të ardhurave, subjekti ka depozituar⁷⁵ kopje të disa kontratave të tij si person fizik, si dhe gjendjet e llogarive të tij të ndryshme bankare ndër vite. Gjithashtu, në deklaratën *Vetting*, subjekti ka

Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës; (3) shkresa nr. *** prot., datë 24.4.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë (përfshirë edhe ish-Prokurorinë e Rrethit Mirditë); (4) shkresa nr. *** prot., datë 23.4.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

⁷⁰ Përmes pyetësorit me *email*-in datë 20.10.2023.

⁷¹ Shpjegimet e subjektit të depozituara në datën 30.10.2023.

⁷² Shpjegimet e subjektit të depozituara në datat 30.10.2023 dhe 2.4.2024.

⁷³ Përmes pyetësorit me *email*-in datë 12.3.2024.

⁷⁴ Shpjegimet e subjektit të depozituara në datën 2.4.2024.

⁷⁵ Dokumentacioni i depozituar nga subjekti në datën 2.4.2024, si vijon: nxjerrje llogarie e Raiffeisen Bank datë 20.1.2016, për shtetasin V.K, për periudhën 18.12.2006 – 20.1.2016; ekstrakt historik i QKB-së për subjektin tregtar “V.K”, person fizik, me NUIS K***C, datë 20.1.2016; certifikatë regjistrimi në organet tatimore të pushtetit vendor, viti 2007, për shtetasin V.K; kontratë për shërbimet nr. ***, datë 3.6.2010, e lidhur midis *** d.d. dhe hotel “K”, përfaqësuar nga shtetasi V.K; kontratë e lidhur midis firmës së ndërtimit “G” sh.a., Sh dhe hotel-bar-restorant “K”, me president të firmës V.K; nxjerrje llogarie e Raiffeisen Bank datë 20.1.2016, për shtetasin V.K, për periudhën 18.12.2006 – 20.01.2016; nxjerrje llogarie e lëshuar nga Raiffeisen Bank në datën 13.3.2024, për shtetasin V.K.

depozituar⁷⁶ dokumentacion lidhur me aktivitetin tregtar në emër të vëllait V.K, të regjistruar me vendimin gjyqësor nr. **, datë 1.3.2007 (me NIPT K***C), me objekt veprimtarie “Tregtim të artikujve të përzier ushqimorë, industrialë, pjesë këmbimi, mobilieri, prodhime buke, hotel-restorant”, në Lagjen Nr. **, Kukës.

28.15 Komisioni hetoi lidhur me aktivitetin e vëllait dhe nga informacioni i ardhur nga QKB-ja⁷⁷ shtetasi V.K figuron i regjistruar si person fizik me NIPT K***C, nga data 16.1.2007 (aktualisht i pezulluar nga data 23.12.2016) dhe si person fizik i regjistruar me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës nr. ***, datë 1.3.2007, për të cilën nuk është e mundur të identifikohet NUIS. Gjithashtu, shtetasi V.K rezulton të ketë qenë edhe administrator në shoqërinë “V.K” sh.p.k., me NIPT K***V, që nga data 18.4.2008, larguar në datën 20.1.2012.

28.16 Komisioni kërkoi informacion pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Kukës dhe Bashkisë Kukës lidhur me aktivitetin tregtar të shtetasit V.K, të regjistruar në vitin 2007 me NUIS K***C. Në përgjigje, DRT Kukës⁷⁸ ka informuar se nuk disponojnë asnjë dokumentacion për këtë subjekt, i cili është pasiv në sistemin tatimor C@ts në datën 23.12.2016 e në vazhdim. Bashkia Kukës⁷⁹ ka informuar se ky aktivitet për periudhën 2007 – 2010 nuk ka asnjë lloj detyrimi për pushtetin vendor sipas regjistrimit të ngarkesave dhe pagesave që disponojnë, duke mos provuar me ndonjë dokumentacion të dhënë për aktivitetin e shtetasit V.K.

Analiza financiare mbi mundësitë e shtetasit V.K për blerjen e njësisë në vlerën 100.000 euro

28.17 Në lidhje me të ardhurat e shtetasit V.K nga aktiviteti i regjistruar në QKB, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, në *statement*-et bankare në emër të këtij shtetasi u evidentuan depozitime nga firma të ndryshme, në vlera të konsiderueshme, por për këto të ardhura nuk u provuan pagesat e detyrimeve tatimore dhe, si të tilla, nuk mund të analizohen nga Komisioni.

28.18 Në lidhje me të ardhurat e shtetasit V.K në Angli, nga *statement*-et bankare të depozituara (*statement* për periudhën 2014 – 2016), këto të ardhura nuk i përkasin periudhës së blerjes së pasurisë, por disa vite më vonë, për pasojë ato nuk mund të përfshihen në analizë.

Konstatimet e Komisionit

28.19 Nga hetimi i kryer për pasurinë njësi, sipas dokumentacionit të administruar rezultoi:

⁷⁶ Dokumentacion i depozituar nga subjekti bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, si vijon: (1) certifikatë e regjistrimit të biznesit të vogël në emër të shtetasit V.K, me NIPT K***C regjistruar, me objekt “Tregtim i artikujve të përzier ushqimore, industrialë, pjesë këmbimi, mobilieri, prodhime buke, hotel-restorant”, vendimi ushtrimit të aktivitetit në Lagjen Nr. *, K; (2) ekstrakt historik i QKR-së, i lëshuar në datën 20.1.2016, për aktivitetin e biznesit V.K, person fizik, me NIPT K***C, i regjistruar në datën 16.1.2007, me status “aktiv”; (3) shkresë nr. *** prot., datë 24.3.2015, i DRT Tiranë drejtuar shtetasit V.K, me NIPT L***U, me aktivitet bar-kafe në godinën *katëshe, Unaza e re, pranë A, Tiranë, për pagesë të detyrimeve tatimore; (4) formular i pagesës së sigurimeve shoqërore nga shtetasi V.K, me NIPT L***U, datë 3.2.2014; (5) nxjerrje llogarie (në euro) e shtetasit V.K në Raiffeisen Bank, datë 20.1.2016, për periudhën 18.12.2006 – 20.1.2016, ku evidentohen kreditime për likuidime faturash, në favor të këtij shtetasi; (6) nxjerrje llogarie (në lekë) e shtetasit V.K në Raiffeisen Bank, datë 20.1.2016, për periudhën 18.12.2006 – 20.1.2016, ku evidentohen kreditime për likuidime faturash nga shoqëri të ndryshme, transfertat nga shtetasi M.K; kreditim të vlerës së shitjes automjetit Komunës T në vitin 2008; likuidim huaje nga “V.K” në vitin 2009; pagesë këstesh qiraje në vitin 2014, derdhe në llogari nga vetë V.K etj., në shumta të konsiderueshme; (7) nxjerrje llogarie e shtetasit V.K në *** për periudha të ndryshme të vitit 2014, me transfertat kreditore pagash, kryesisht nga “***”, si dhe nxjerrje balancash të muajve të ndryshëm gjatë periudhës 2014 – 2015; (8) nxjerrje llogarie e shtetasit V.K në ***, printim i datës 1.2.2016, me transaksione debi - kredi të periudhave të ndryshme gjatë viteve 2010 – 2016.

⁷⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 26.7.2021.

⁷⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 9.4.2024.

⁷⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 30.5.2024.

- Paqartësi lidhur me vlerat e pasurive që shkëmbehen, specifikuat vlera e pjesës takuese të subjektit (restoranti) bar-restorant “K” në Kukës, këmbëhet me njësinë e blerë nga vëllai plus një shumë prej 100.000 euro (këmbëhet për një vlerë prej 200.000 euro).
 - Mungesë dokumentacioni mbi burimet e ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e njësisë në Yzberisht, Tiranë, pasuri kjo e blerë në vitin 2010 nga vëllai i subjektit të rivlerësimit, në shumën 100.000 euro.
- ✓ Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në D/3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

28.20 Në prapësime, subjekti ka shpjeguar se ky është një veprim juridik shkëmbimi me kusht dhe nëse nuk përmbushet kushti i legalizimit palët do të kthehen në gjendjen e mëparshme.

28.21 Sipas subjektit, kjo marrëdhënie nuk është as marrëdhënie dhurimi as huaje dhe në bazë të nenit 34, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, vëllai V.K nuk ka detyrimin për të justifikuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të tij. Sipas subjektit, ai do ta kishte këtë detyrim nëse do të ishte në marrëdhënie dhurimi apo huaje me vetë subjektin dhe ligji nuk ka parashikuar një gjë të tillë për shkëmbimin e pasurive, që është një tjetër institut juridik.

28.22 Në prapësime, subjekti ka argumentuar se ligji nr. 84/2016 ka parashikuar kritere rigorozë për sa i përket objektit të vlerësimit të pasurisë, dhe më konkretisht në nenin 30 të ligjit është përcaktuar në mënyrë eksplicite se objekti i vlerësimit të pasurisë nga organet e rivlerësimit është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Sipas subjektit, ligji në fjalë ka parashikuar si objekt të rivlerësimit pasurinë e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të dhe jo atë të personave të tjerë të lidhur, duke referuar edhe një qëndrim të mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, ku në vendimin nr. 15, datë 17.7.2019⁸⁰, ka argumentuar se: *“Sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, një subjekt rivlerësimi do të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e krijimit të pasurisë së personit tjetër të lidhur vetëm kur me të ka hyrë në një marrëdhënie huaje ose dhurimi, në raste të tjera të marrëdhënieve të interesit, pasuria e personave të tjerë të lidhur duhet të jetë objekt verifikimi në kontekst të verifikimit të gjendjes së konfliktit të interesave”*.

28.23 Sa i përket vlerave të dakordësuara midis palëve, subjekti ka prapësuar se nuk ka asgjë të paqartë, pasi me vëllain kane rënë dakord që ai të paguajë edhe 100.000 euro përveç njësisë, pasi do të marrë pjesën e tij takuese në objektin bar-restorant-hotel “K”, që i intereson më shumë sesa kjo njësi në Tiranë. Subjekti ka argumentuar se vlerat janë përcaktuar me vullnetin e lirë të dy palëve bazuar në parimin e lirisë ekonomike, të sanksionuar në nenin 11 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Sipas subjektit, në kushtet kur liria e veprimtarisë ekonomike është përcaktuar në Kushtetutë, çmimet i vendos tregu dhe nuk ka një ent rregullues apo çmime që përcaktohen nga organizma zyrtare, por është tregu që i përcakton çmimet në bazë të kërkesës dhe ofertës, dhe konkluzioni i Komisionit në lidhje me paqartësitë e vlerës i duket paragjykes. Sipas subjektit, nuk ka ndonjë ligj që pengon lirinë kontraktore, ose që

⁸⁰ Vendimi i Kolegjit, paragrafi 109.

përcakton çmimet e shitjes apo shkëmbimit të pasurive të paluajtshme jashtë vullnetit të dakordësuar të palëve në kontratë.

Vlerësimi i Komisionit për pasurinë njësi në Y, Tiranë

28.24 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura në prapësime, vëren se në përmbushje të barrës së provës, subjekti nuk depozitoi dokumentacion justifikues ligjor mbi të ardhurat e ligjshme të vëllait për blerjen e njësisë me vlerë 100.000 euro, pasuri e cila *de jure* figuron e regjistruar në pronësi të subjektit.

28.25 Pretendimi i subjektit se kjo pasuri rrjedh nga një veprim juridik shkëmbimi, nuk qëndron, pasi referuar akteve të administruara në dosje, ky veprim bazohet në një deklaram noterial midis subjektit dhe vëllait, akt i cili mund të shfuqizohet në çdo moment nga palët, e ndërsa subjekti figuron pronar i vetëm i ligjshëm i kësaj pasurie. Referuar nenit 757 të Kodit Civil, shkëmbimi është një kontratë që ka për objekt kalimin e ndërsjellë të pronësisë së sendeve ose të të drejtave të tjera nga njëri kontraktues tek tjetri, ndërsa akti deklarativ noterial, e realizuar midis subjektit dhe vëllait, pavarësisht përmbajtjes së saj, nuk përmban elementet e një kontrate të mirëfilltë shkëmbimi.

28.26 Në lidhje me pasurinë njësi, Komisioni vlerëson se subjekti ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor mbi të ardhurat e ligjshme të të vëllait, që kanë shërbyer për blerjen e njësisë në vlerën 100.000 euro, në kundërshtim me sa parashikon neni D/3 i Aneksit të Kushtetutës, duke u gjendur kështu nën parashikimin e shkronjës “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

29. Automjet⁸¹ tip “Mercedes-Benz”, me vlerë 500.000 lekë

29.1 Nga informacioni i ardhur nga DPSHTRR-ja⁸² konfirmohet automjeti i regjistruar në pronësi të z. Sabri Kastrati.

29.2 Nga aktet e administruara në dosje ka rezultuar se subjekti përmes kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.8.2009, ka blerë nga shitësi Z.L një automjet tip “Mercedes-Benz”, vit prodhimi 2002, në shumën 500.000 lekë, të likuiduar mes tyre. Automjeti është regjistruar në pronësi të subjektit, i cili është pajisur me certifikatën e pronësisë së mjetit rrugor në datën 19.3.2010.

29.3 Komisioni verifikoi lidhur me çmimin e blerjes së automjetit, ku sipas aktit të zhdoganimit të kryer në datën 4.8.2009 nga shitësi Z.L (një ditë para nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, datë 5.8.2009), vlera e mjetit rezulton 250.000 lekë + zhdoganimi 239.007 lekë, nga ku nuk evidentohet ndonjë trajtim preferencial lidhur me çmimin e blerjes së tij.

29.4 Komisioni hetoi lidhur me ndonjë konflikt të mundshëm interesi të subjektit të rivlerësimit me shitësin, ku nga përgjigjet e ardhura nga prokuroritë⁸³ nuk kanë rezultuar procedime penale të regjistruara në ngarkim të këtij shtetasi.

Analizimi i burimit të krijimit nga Komisioni

⁸¹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* dokumentacionin vijues: (1) kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 5.8.2009, për blerjen nga z. Sabri Kastrati të automjetit tip “Mercedes-Benz E***CDI”, me çmim 500.000 lekë; (2) leje qarkullimi e automjetit me targë TR *** T, në pronësi të z. Sabri Kastrati.

⁸² Me shkresat nr. *** prot., datë 30.7.2021 dhe nr. *** prot., datë 30.8.2021.

⁸³ (1) Shkresa nr. *** prot., datë 4.4.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër (përfshirë edhe ish-Prokurorinë e Rrethit Mat); (2) shkresa nr. *** prot., datë 5.4.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës; (3) shkresa nr. *** prot., datë 24.4.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë (përfshirë edhe ish-Prokurorinë e Rrethit Mirditë); (4) shkresa nr. *** prot., datë 23.4.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

29.5 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si burim për blerjen e automjetit të ardhurat nga pagat, ndërsa në DPV-në e vitit 2009 (vit i blerjes së automjetit) nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë.

29.6 Komisioni analizoi mundësitë financiare të subjektit për blerjen e automjetit në datën 5.8.2009, në shumën 500.000 lekë. U morën në konsideratë të ardhurat dhe shpenzimet familjare për subjektin, bashkëjetuesen dhe dy fëmijët, për periudhën janar – gusht 2009.

Konstatimi i Komisionit për automjetin

29.7 Nga analiza financiare e kryer mbi mundësitë e subjektit për blerjen e automjetit, ka rezultuar një balancë negative në shumën 143.912 lekë, në momentin e blerjes së automjetit.

- ✓ Në lidhje me këtë balancë negative, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

29.8 Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi se konstatimi i Komisionit nuk është i drejtë dhe i bazuar në situatën faktike, pasi subjekti nuk ka detyrimin të deklarojë gjendjen *cash* nën shumën 300.000 lekë në vitin paraardhës dhe kjo nuk do të thotë se ai nuk ka pasur gjendje *cash* të mbartur.

29.9 Subjekti pretendon se shpenzimet për mobilimin e shtëpisë në Durrës janë llogaritur apriori nga Komisioni dhe nuk është e qartë sesi ka arritur në konkluzionin se ka shpenzuar shumën prej 145.833 lekësh për mobilim, kur një gjë e tillë nuk është deklaruar asnjëherë prej tij. Sipas subjektit: *“Fakti që ke blerë një shtëpi nuk do të thotë se duhet ta mobilosh patjetër, pasi kjo gjë bëhet kur t’i kesh mundësitë financiare”*.

Vlerësimi i Komisionit

29.10 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura në prapësime, konstaton se pretendimi i subjektit se nuk ka detyrim të deklarojë gjendjen *cash* nën shumën 300.000 lekë në vitin paraardhës, nuk qëndron, pasi në referim të nenit 4, shkronja “d” e ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, parashikohet se subjektet detyrohen të deklarojnë vlerën e likuiditeteve, gjendjen *cash* jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, depozitë, bono thesari huadhënie, lekë ose valutë të huaj. Sipas kësaj dispozite, nuk ka një limit të përcaktuar në deklarimin e pasurive dhe likuiditeteve nga ana e subjektit, pasi ky kufizim i referohet shpenzimeve të deklarueshme, të cilat duhet të deklarohen mbi vlerën 300.000 lekë, sipas shkronjës “h” të nenit 4 të këtij ligji. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit duhet të deklaronte vit pas viti gjendjen e likuiditeteve *cash*, për të mundësuar në këtë mënyrë kontrollin e pasurisë.

29.11 Sa i përket pretendimit të subjektit se shpenzimet për mobilimin e shtëpisë në Durrës i janë llogaritur apriori nga Komisioni, pasi nuk e ka deklaruar asnjëherë një shpenzim të tillë, ky pretendim nuk qëndron, pasi në pyetësin standard subjekti ka deklaruar qartësisht se vlera totale e arredimit të banesës në Durrës është afërsisht 500.000 lekë. Referuar këtij deklarimi, si dhe nisur nga fakti se gjatë hetimit subjekti nuk mundi të përcaktonte një periudhë kohore konkrete në të cilën ka kryer mobilimin, Komisioni ka ndarë midis viteve 2008 – 2009 shumën e shpenzuar për arredim, prej 500.000 lekësh.

29.12 Në përfundim, Komisioni konstaton se subjekti në prapësime nuk përmbysi të kundërtën e barrës së provës mbi mundësitë financiare për blerjen e automjetit. Për rrjedhojë, subjekti ka

pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit, në kuptim të nenit D/3 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe shkronjës “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

30. Gjendje *cash* në shumat 5.000 euro dhe 100.000 lekë

30.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se shumat 5.000 euro dhe 100.000 lekë kanë si burim kursimet.

30.2 Nga verifikimi i deklarimeve periodike ndër vite, evidentohet se kjo gjendje *cash* vjen e mbartur nga viti 2016, ku në DPV-në e këtij viti subjekti ka deklaruar gjendje *cash* nga kursimet, në shumat 5.000 euro dhe 100.000 lekë. Ndërsa gjatë periudhës 2004 – 2015, subjekti nuk ka deklarime të kursimeve *cash*, përveç DPV-së së vitit 2007, ku ka deklaruar gjendje *cash* në banesë në shumën 750.000 lekë.

30.3 Komisioni i ka kërkuar⁸⁴ subjektit të saktësojë periudhën e krijimit të këtyre kursimeve, si dhe të depozitojë dokumentacion provues mbi burimet e krijimit të tyre, për të cilat ka shpjeguar⁸⁵ se këto shuma janë kursime familjare ndër vite, me të ardhurat e krijuara nga pagat e tij dhe të bashkëjetueses nga aktiviteti privat i përkthimeve/interpretimeve ndër vite.

30.4 Duke marrë në konsideratë faktin se subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* nga viti 2008 deri në 2016, Komisioni kreu analizën financiare, duke e përllogaritur shumën *cash* të kursyer në vitin 2016.

Konstatimi i Komisionit

30.5 Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni ka rezultuar se në vitin 2016 subjekti nuk ka pasur mundësi për krijimin e kursimeve *cash*, duke rezultuar me një balancë negative në shumën 338.813 lekë.

✓ Në lidhje me këtë balancë negative, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

30.6 Në lidhje me këtë konstatim, subjekti thekson se nuk ka pasur detyrim të deklarojë gjendjen *cash* nën shumën 300.000 lekë dhe pretendon se shpenzimet e udhëtimit janë llogaritur në një shumë më të madhe se ato faktike. Subjekti prapëson se edhe shpenzimet e mobilimit në shumën 80.000 lekë janë llogaritur apriori nga ana e Komisionit, pa u bazuar në asnjë deklaram të tij. Sipas subjektit, shpenzimet e udhëtimit të deklaruara prej tij kanë qenë në shumën 3.450 euro dhe jo 514.026 lekësh, siç janë paraqitur nga Komisioni, dhe nëse merren parasysh këto fakte edhe në këtë vit balanca del pozitive.

Vlerësimi i Komisionit

30.7 Sikurse është arsyetuar edhe në pikën 29.10 të këtij vendimi, lidhur me deklaramin e gjendjes *cash*, Komisioni vlerëson se, për të njëjtat arsye, pretendimet e subjektit nuk mund të pranohen. Komisioni çmon se nuk ka vend për të parashtuar paaftësi për të kuptuar ligjin nga magjistratët, pasi ligji nr. 9049/2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, ka përcaktuar qartësisht detyrimin e subjekteve për të deklaruar çdo lloj pasurie, si dhe gjendjen e likuiditeteve *cash*, pa vendosur kufizime në vlerë.

⁸⁴ Përmes pyetësorit me *email*-in datë 12.3.2024.

⁸⁵ Shpjegimet e subjektit të depozituara në datën 2.4.2024.

30.8 Komisioni konstaton se subjekti është kontradiktor në deklaratimet e tij, pasi në prapësime pretendon se shpenzimi i mobilimit në shumën 80.000 lekë është llogaritur apriori, pretendim i cili nuk qëndron, pasi gjatë hetimit vetë subjekti ka deklaruar në pyetësorin standard se për banesën në Durrës, përveç shpenzimeve për kuzhinën në vlerën 80.000, në vitin 2016, nuk ka bërë shpenzime të tjera, pasi mobiliet janë zëvendësuar me ato që kishin.

30.9 Për sa më sipër, Komisioni çmon se subjekti nuk arriti të përmbysë të kundërtën e barrës së provës, duke u gjendur në parashikimet e shkronjës “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

DEKLARIMI I DETYRIMEVE

31. Në deklaratën *Vetting*, tek rubrika e detyrimeve, subjekti ka deklaruar:

Kredi bankare⁸⁶ sipas kontratës së kredisë dhe hipotekës nr. ***, datë 6.2.2008⁸⁷, për shumën e kredisë 20.000 euro. Detyrimi i mbetur është në shumën 15.601 euro.

31.1 Nga informacioni i ardhur nga Raiffeisen Bank⁸⁸ konfirmohet kredia në emër të z. Sabri Kastrati në shumën 20.000 euro, marrë në datën 16.5.2008, me qëllim blerje shtëpie. Subjekti ka deklaruar çdo vit detyrimin e mbetur të pashlyer të kredisë në deklaratimet periodike për periudhën 2008 – 2016.

✓ Nga verifikimi i kryer nuk u evidentuan problematika.

DEKLARIMI I BASHKËJETUESËS SË SUBJEKTIT

32. Në deklaratën *Vetting*, bashkëjetuesja e subjektit, znj. D.H, ka plotësuar autorizimin, ku ka deklaruar se nuk disponon pasuri të regjistruar veçmas në emrin e saj. Në rubrikën “Të dhëna konfidenciale” ka deklaruar:

33. **Apartament⁸⁹ me sipërfaqe 68,2 m², i porositur me kontratë porosie datë 8.8.2014, në vlerën 61.000 euro**

⁸⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin vijues: (1) kontratë kredie bankare dhe hipoteke nr. ***, datë 6.5.2008, me kredidhënës Raiffeisen Bank dhe kredimarrës Sabri Kastrati, të shumës 20.000 euro, për blerje shtëpie, e cila do të transferohet në llogarinë e shtetasit Sh.K, për të mbyllur detyrimin e klientit që rrjedh nga kontrata e huas nr. ***, datë 29.1.2008; (2) kontratë huaje nr. ***, datë 29.1.2008, ndërmjet huadhënësit Sh.K dhe huamarrësit Sabri Kastrati, të shumës 20.000 euro, e cila do të likuidohet në momentin e lëvrimin të kredisë bankare për blerje shtëpie. Në rast moslikuidimi të huas, shtetasi Sh.K ka të drejtë të ndërhyjë ligjërisht dhe shuma 20.000 euro të kompensohet nga vlera e apartamentit të banimit me sip. 93,84 m², në z. k. ***, rruga “T”, në pronësi të tij; (3) vërtetim nr. ***, datë 25.1.2017, i Raiffeisen Bank “Mbi produktet bankare të klientit Sabri Kastrati”, sipas të cilit balanca në fund të vitit 2016 e kredisë është 15.601 euro.

⁸⁷ Duket se ka një gabim material në deklaratimin e datës së kontratës, e cila duhet të jetë 3.5.2008.

⁸⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 26.7.2021.

⁸⁹ Bashkëlidhur deklaratës *Vetting* ndodhet dokumentacioni vijues: (1) deklaratë noteriale nr. ***, datë 29.1.2017, nga shtetasit B dhe L.H, si dhe dokumentet e identifikimit të tyre; (2) kontratë porosie nr. ***, datë 8.8.2014, sipas së cilës shtetasja D.H porosit nga shoqëria “K” sh.p.k. apartament 1+1 me sip. 68,8 m², në rrugën “K e P”, Tiranë, me çmim 61.000 euro; (3) raporti i personit D.H dhe D.K, e datëlindjes 4.5.1978, nga sistemi TIMS, sipas të cilit dalja nga Republika e Shqipërisë për D.H është në datën 26.6.2014 dhe hyrja për D.K (me pasaportë australiane) në datën 23.8.2015; (4) nxjerrje llogari rrjedhëse e shtetasit B.H në Raiffeisen Bank, e datës 30.1.2017, për periudhën 10.5.2005 – 29.1.2017, në të cilën evidentohen kreditime për pagesë sipas kontratave dhe paga e shpërblime; (5) nxjerrje llogari rrjedhëse e shtetasit B.H në NBG Bank, e datës 30.1.2017, për periudhën 30.7.2012 – 3.1.2017, si dhe nga data 28.7.2011 deri më 1.8.2014, në të cilën evidentohen kreditime për depozita, të cilat nga akumulimet kanë arritur rreth 1.000.000 lekë në vitin 2011, 1.500.000 lekë në vitin 2013, dhe në datën 1.8.2014 është tërhequr shuma 2.000.000 lekë, me përshkrimin “Dhënie borxhi H.J.K nga B.H”; (6) nxjerrje llogari rrjedhëse e shtetasit B.H në Alpha Bank, e datëlindjes 30.1.2017, për periudhën 1.3.2009 – 30.1.2017, në të cilën evidentohen në vitin 2009 mbyllje depozite 1.200.000 lekë dhe çelje më pas depozite 2.000.000 lekë, në vitin 2011 – 2012 depozita bëhet 2.500.000 lekë, në vitin 2013 bëhet 3.500.000 lekë dhe në datën 31.7.2014 shtetasi B.H debiton llogarinë në shumën 4.000.000 lekë, me përshkrimin “B.H për H.K, dhënie borxhi”; (7) nxjerrje llogarie rrjedhëse e shtetasit B.H në BKT, e datës 30.1.2017, për periudhën 1.1.2009 – 30.1.2017, në të cilën evidentohen kreditimet nga paga të këtij shtetasi; (8) kontratë depozite në Intesa Sanpaolo Bank, fillimisht e çelur në emër të shtetasës L.H me shumën 5.914 USD, në maj të vitit 2001, e cila me rinovimet ndër vite arrin në nëntor të vitit 2003 në shumën 10.292 USD (dyemërore L.H & D.H).

33.1 Në deklaratën *Vetting*⁹⁰, bashkëjetuesja e subjektit, znj. D.H, ka deklaruar se në janar të vitit 2017 ka marrë dijëni për ekzistencën e një kontrate porosie me nr. ***, datë 8.8.2014, sipas së cilës znj. D.H ka porositur tek shoqëria ndërtuese “K” sh.p.k. një apartament në vlerën 61.000 euro. Nga data 26.6.2014 e deri më 23.8.2015 ka qenë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, fakt të cilin e vërteton me të dhënat për hyrje-daljet e regjistruara në sistemin TIMS. Meqenëse kjo kontratë ekziston e regjistruar në regjistrin e noterit publik, për këtë arsye e bën këtë deklaram. Në vijim, znj. D.H deklaroi se kjo kontratë ka qenë e lidhur nga prindërit e saj, B.H dhe L.H, të cilët për shkak të rrethanave familjare kanë vënë emrin e saj si porositëse të kësaj prone.

Hetimi i Komisionit

33.2 Nga informacioni i ardhur nga ASHK Tiranë⁹¹ nuk ka rezultuar pasuri e paluajtshme e regjistruar në pronësi të shtetas D.H.

33.3 Zyra e Regjistrimit Noterial⁹² ka dërguar të dhëna mbi veprimet noteriale të kryera nga znj. D.H, ku ndër të tjera evidentohet edhe kontrata e porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.8.2014, i redaktuar pranë noteres E.T.

33.4 FSHU-ja⁹³ ka konfirmuar se në emër të znj. D.H identifikohet një abonent në instancën Tiranë. Nga të dhënat evidentohet se kontrata e furnizimit është lidhur në datën 11.2.2016, në adresën “K e P”, K, Tiranë, si dhe shënimi “Prot. ***, datë 25.5.2018, S.K”.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

33.5 Në dosje është administruar kontrata e porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.8.2014, e nënshkruar nga znj. D.H në cilësinë e porositëses dhe shoqëria ndërtuese “K” sh.p.k., me administrator z. S.K, për blerjen e një apartament 1+1, me sip. 68,8 m² (sipërfaqe e brendshme 61,4 m² dhe sipërfaqe e përbashkët 7,4 m²) në rrugën “K e P”, Tiranë, me çmim 61.000 euro, ku shuma prej 50.000 euro do të paguhej me hartimin e kontratës, 10.000 euro me dorëzimin e apartamentit në gusht të vitit 2015, si dhe 1.000 euro në momentin e hipotekimit dhe hartimit të kontratës së shitjes.

33.6 Në kontratë përcaktohet se pagesat do të kryhen në numrin e llogarisë bankare të shoqërisë “K” sh.p.k. Gjithashtu, palët kanë përcaktuar se apartamenti do t’i dorëzohet porositësit brenda datës 31.7.2015, ku porositësi duhet të firmosë procesverbalin e marrjes në dorëzim të apartamentit.

33.7 Nga hetimi i kryer evidentohet se shtetasja D.H ka lidhur me FSHU/OSHEE kontratën për furnizimin me energji elektrike në datën 11.2.2016.

33.8 Në deklaratën *Vetting*, bashkëjetuesja e subjektit, znj. D.H, ka deklaruar se nuk ka qenë në Shqipëri gjatë periudhës 26.6.2014 – 23.8.2015, kur është nënshkruar kontrata e porosisë datë 8.8.2014, fakt të cilin e vërteton me të dhënat e regjistruara në sistemin TIMS. Sipas saj, kontrata e porosisë ka qenë e lidhur nga prindërit e saj, duke depozituar aktet si vijon:

- Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.1.2017, lëshuar nga shtetasit B dhe L. H, të cilët deklarojnë se kanë lidhur me shoqërinë “K” sh.p.k. kontratën e porosisë nr. ***,

⁹⁰ Tek rubrika “Të dhënat konfidenciale”.

⁹¹ Shkresa nr. *** prot., datë 21.6.2023, e ASHK Tirana Rurale 1; shkresa nr. *** prot., datë 11.7.2023, e ASHK Tirana Rurale 2; shkresa nr. *** prot., datë 26.6.2023, e ASHK Tirana Veri; shkresa nr.*** prot, datë 21.6.2023, e ASHK Tirana Jug.

⁹² Me shkresën nr. *** prot., datë 26.7.2021.

⁹³ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.12.2023.

datë 8.8.2014, për apartamentin e ndodhur në rrugën “K e P”, ku palë porositëse figuron vajza e tyre D.H, e cila në atë kohë nuk ndodhej në Shqipëri, por në Australi. Këta shtetas deklarojnë se këtë veprim e kanë kryer për shkak të disa rrethanave familjare në lidhje me djalin dhe këtë fakt nuk ia kanë bërë të ditur vajzës së tyre D.H asnjëherë, pasi e gjykuan të arsyeshme dhe të domosdoshme ta vënë në dijeni në këtë moment, për ta përjashtuar atë nga çdo përgjegjësi.

- Kopje ekstrakti mbi të dhënat e sistemit TIMS në emër të D.H dhe D.K, e datëlindjes 4.5.1978, nga e cila rezulton dalje jashtë Shqipërisë nga D.H në datën 26.6.2014 dhe hyrje nga D.K (me pasaportë australiane) në datën 23.8.2015.

33.9 Gjatë hetimit, subjekti ka shpjeguar⁹⁴ se bashkëshortja e tij nuk ka qenë në dijeni të ekzistencës së kontratës së porosisë datë 8.8.2014, pasi është hartuar nga prindërit e saj, pa dijeninë e bashkëshortes, të cilët kanë dashur t’ia bëjnë dhuratë, në formë surprize. Subjekti ka sqaruar se nuk ka asnjë veprim tjetër në lidhje me këtë kontratë, e cila nuk është regjistruar në ASHK në dijeninë e tyre. Sipas subjektit, nëse kjo kontratë do të regjistrohej në ASHK, do të duhej të bëhej në formën e kontratës së dhurimit dhe sipas ligjit bashkëshortja duhet të japë pëlqimin për pranimin e dhurimit, sipas përcaktimeve të nenit 761 të Kodit të Procedurës Civile, fakt i cili nuk ka ndodhur. Subjekti shpjegon se nga ana e bashkëshortes së tij nuk është nënshkruar asnjë kontratë dhurimi e, për rrjedhojë, nuk është kryer asnjë veprim për regjistrimin e kësaj kontrate apo pasurie pranë ASHK-së.

33.10 Komisioni i ka kërkuar⁹⁵ subjektit të dokumentojë martesën e lidhur me shtetasen D.H, si dhe të shpjegojë mospërputhjen në deklaratimet e tij, pasi në certifikatën familjare të datës 26.1.2017 subjekti figuron me status “beqar”, në deklaratimet periodike të viteve 2005 – 2015 ka deklaruar gjendjen civile “martuar”, ndërsa në DPV-në e vitit 2016 dhe në deklaratën *Vetting* ka deklaruar se është me status “beqar”. Gjithashtu, nga të dhënat e TIMS, bashkëjetuesja D.H nga viti 2015 ka përdorur 3 herë pasaportën australiane me gjeneralitetet D.K. Subjekti ka shpjeguar⁹⁶ se në deklaratat periodike për vitet 2005 – 2015 kjo rubrikë është plotësuar gabim prej tij, për shkak të një lapsusi në plotësimin e deklaratës, pasi nuk i është kushtuar vëmendja e duhur plotësimit të saj. Subjekti ka sqaruar se që nga viti 2005 e në vijim gjendja e tyre civile nuk ka ndryshuar asnjëherë, ku statusi i tyre është “beqar”.

33.11 Sa i përket ndryshimit të mbiemrit të bashkëjetueses nga H në K, subjekti ka shpjeguar⁹⁷ se kjo ka ndodhur në shtetin australian, ku për shkak të problemeve gjatë udhëtimit me fëmijët si rrjedhojë e mbiemrave të ndryshëm, bashkëshortja në momentin e marrjes së pasaportës ka bërë kërkesën në shtetin australian që të ndryshonte mbiemrin nga H në K dhe duke qenë se në këtë shtet ndryshimi i mbiemrit bëhej me një kërkesë të thjeshtë, ajo i është drejtuar autoriteteve përkatëse dhe i është miratuar ndryshimi i mbiemrit⁹⁸.

Lidhur me pagesat për blerjen e apartamentit

33.12 Përmes deklaratës noteriale datë 29.1.2017, prindërit e bashkëjetueses së subjektit kanë deklaruar se i kanë shlyer shoqërisë ndërtuese shumën 50.000 euro.

⁹⁴ Shpjegimet e subjektit të depozituara në datën 30.10.2023, në përgjigje të pyetësorit datë 20.10.2023.

⁹⁵ Përmes pyetësorit me *email*-in datë 12.3.2024.

⁹⁶ Shpjegimet e subjektit të depozituara në datën 2.4.2024.

⁹⁷ Shpjegimet e subjektit të depozituara në datën 20.5.2024, në përgjigje të pyetësorit datë 30.4.2024.

⁹⁸ Dokumentacioni i depozituar në datën 20.5.2024 nga subjekti: (1) akt i datës 26.5.2015, për shtetësinë australiane të shtetas D.H (në gjuhën angleze, por është i papërkthyer, vërtetuar nga noteri në kuptim të ligjit); (2) kopje e pasaportës australiane të shtetas D.K, e lëshuar në gusht të vitit 2015.

33.13 Komisioni i ka kërkuar⁹⁹ subjektit të depozitave dokumentacion provues mbi pagesat e kryera pranë shoqërisë ndërtuese, për të cilën ka sqaruar¹⁰⁰ ndër të tjera se kjo banesë është marrë në dorëzim nga nëna e bashkëjetueses, L.H, dhe në vitin 2021 është paguar edhe kësti i fundit prej saj. Sipas subjektit, në dijeninë e tij, pasuria nuk është regjistruar ende në hipotekë dhe nuk është lidhur kontrata përfundimtare e shitjes. Subjekti ka depozituar¹⁰¹ si dokumentacion provues aktin e dorëzimit të apartamentit të datës 20.10.2016 dhe mandatin bankar datë 3.6.2021 për pagesën e shumës 11.000 euro nga shtetasja L.H, me përfitues shoqërinë “K” sh.p.k., me përshkrimin “L,H blerje apartamenti kësti i fundit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.8.2014”.

33.14 Ndërsa nga informacioni i ardhur nga shoqëria “K” sh.p.k.¹⁰² ka rezultuar se kjo pasuri është ende në pronësi të shoqërisë, pasi detyrimi nuk është shlyer plotësisht dhe nuk ka kaluar e drejta e pronësisë, prandaj nuk ka një kontratë përfundimtare shitblerjeje. Në vijim, shoqëria ka informuar se sipas kontabilitetit në sistemin financiar këto pagesa janë kryer nga shtetasja L.H, përkatësisht shumat 3.600.000 lekë dhe 10.000 euro.

Burimi i krijimit të kësaj pasurie, i verifikuar nga Komisioni

33.15 Në deklaratën noteriale nr. ***, datë 29.1.2017, shtetasit B dhe L.H (prindërit e bashkëjetueses së subjektit) kanë deklaruar se i kanë shlyer shoqërisë ndërtuese shumën 50.000 euro, e siguruar nga kursimet e tyre familjare. Konkretisht, shtetasja L.H ka pasur në Bankën Amerikane (sot Intesa Sanpaolo Bank) një shumë rreth 8.000 USD dhe shtetasi B.H deklaroi se pothuajse prej 10 vitesh ka pasur të depozituara në Alpha Bank dhe NBG Bank kursimet e tij në shumat 4.000.000 lekë dhe 2.000.000 lekë, të cilat më pas janë konvertuar në euro dhe janë përdorur për blerjen e apartamentit.

33.16 Nisur nga deklaratimet e shtetasës D.H në deklaratën *Vetting*, si dhe deklaratimet e prindërve të saj në deklaratën noteriale datë 29.1.2017, Komisioni ka verifikuar burimet e ligjshme të prindërve, nëse do të kishin mundësi financiare me të ardhurat e tyre për blerjen e kësaj pasurie.

a) Lidhur me depozitën në shumën 8.000 USD pranë Intesa Sanpaolo Bank

33.17 Nga të dhënat bankare të ardhura nga Intesa Sanpaolo Bank¹⁰³ ka rezultuar një depozitë bankare në monedhën dollar, me nr. ref. ***, në emër të shtetaseve D.H dhe L.I, çelur në datën 23.11.2003 dhe mbyllur në datën 9.10.2008.

33.18 Referuar të dhënave bankare, rezultoi se kjo depozitë fillimisht është çelur në emër të shtetasës L.H me shumën 5.914 USD, në maj të vitit 2001, e cila me rinovimet ndër vite arrin në shumën 8.016 USD, në vitin 2003, dhe në datën 31.12.2007 ka qenë në shumën 8.733 USD. Kjo depozitë është mbyllur në vitin 2008 dhe shuma 8.876 USD është tërhequr nga shtetasja D.H.

⁹⁹ Përmes pyetësorit me *email*-in datë 30.4.2024.

¹⁰⁰ Shpjegimet e subjektit të dërguara në datën 20.5.2024.

¹⁰¹ Dokumentacioni i depozituar nga subjekti në datën 20.5.2024: (1) akti i dorëzimit të apartamentit datë 20.10.2016, ku citohet se shtetasja L.H ka shlyer detyrimet për apartamentin 1+1 në katin e katërt të banimit me sip. 68,8 m²; (2) procesverbal dorëzimi për apartamentet, i datës 19.10.2016, i nënshkruar nga inxhinieri për shoqërinë “K” sh.p.k; (3) mandat bankar datë 3.6.2021, nga Raiffeisen Bank, për depozitimin e shumës 11.000 euro nga shtetasja L.H, me përfitues “K” sh.p.k.

¹⁰² Përgjigje e dërguar me *email*-in datë 27.5.2024.

¹⁰³ Me shkresat nr. *** prot., datë 30.7.2021 dhe nr. *** prot., datë 17.4.2024.

33.19 Gjithashtu, në po të njëjtën bankë ka rezultuar edhe një depozitë e çelur në datën 5.5.2003 në emër të shtetaseve L dhe D.H, me nr. ref. ***, në shumën 10.292 USD. Kjo shumë është mbajtur në depozitë deri në muajin nëntor 2003, ku është tërhequr dhe mbyllur.

33.20 Në deklaratimet periodike për periudhën 2005 – 2007, bashkëjetuesja D.H nuk ka deklaruar depozitën e kursimit të përbashkët me nënën e saj pranë Intesa Sanpaolo Bank.

33.21 Nisur nga të dhënat bankare, ku bashkëjetuesja figuron mbajtëse e llogarisë së depozitës dhe ka kryer veprime në periudhën 2003 – 2008, Komisioni i ka kërkuar¹⁰⁴ subjektit të deklarojë nëse ka kontribute në krijimin e kësaj depozite dhe, nëse po, në çfarë mase, si dhe të dokumentojë burimet e ligjshme për masën e kontributeve.

33.22 Subjekti ka sqaruar¹⁰⁵ se bashkëjetuesja ka kryer veprime në bankë për shkak të pamundësisë fizike të nënës së saj L.H dhe kjo është edhe arsyeja që kjo llogari është mbyllur në vitin 2008 dhe këto para janë mbajtur *cash* në banesë nga nëna e saj dhe më pas janë përdorur në vitin 2014 për blerjen e apartamentit. Subjekti ka sqaruar se bashkëjetuesja as ka kontribuar në krijimin e kësaj depozite dhe as ka përfitur ndonjë shumë nga kjo depozitë, por veprimet e kryera nga ana e saj kanë qenë për shkak të pamundësisë fizike të nënës së saj për të shkuar vazhdimisht bankë.

33.23 Subjekti ka depozituar¹⁰⁶ si dokumentacion provues *statement*-in bankar të shtetases L. H, të lëshuar nga Intesa Sanpaolo Bank për periudhën janar 2014 – janar 2017, vërtetimet mbi veprimet e kryera në llogarinë e depozitës, si dhe vërtetime për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të lëshuar nga Drejtoria e Shëndetit Publik Elbasan dhe Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë, ku konfirmohen të ardhurat dhe kontributet e derdhura për shtetasen L.H për periudhën 1994 – qershor 2009.

Analiza financiare

33.24 Komisioni kreu analizën financiare mbi të ardhurat e ligjshme të prindërve të bashkëjetueses në vite, duke filluar nga viti 1998 deri në vitin 2003, kur është hapur depozita në emër të shtetaseve L dhe D.H, fillimisht 7.500 USD. Në analizë u morën në konsideratë të ardhurat nga paga dhe pensionet e shtetaseve L dhe B.H, shpenzimet e jetesës për dy persona, të ardhurat nga shitja e një prone në vitin 2000, në shumën 1.400.000 lekë, si dhe depozitat bankare.

33.25 Nga analiza financiare ka rezultuar se prindërit e bashkëjetueses nuk kanë pasur mundësi për të krijuar depozitën deri në fund të vitit 2001, duke rezultuar me një balancë negative në shumën -2.477.626 lekë.

b) Lidhur me shumat 4.000.000 lekë dhe 2.000.000 lekë, kursime në llogari nga shtetasi B.H

¹⁰⁴ Përmes pyetësorit me *email*-in datë 30.4.2024.

¹⁰⁵ Shpjegimet e subjektit të dërguara në datën 20.5.2024.

¹⁰⁶ Dokumentacion i depozituar nga subjekti me nr. *** prot., datë 20.5.2024: (1) *statement* bankar i shtetases L.H, lëshuar nga Intesa Sanpaolo Bank për periudhën 1.1.2014 – 26.1.2017; (2) *deposit credit advice*, lëshuar nga Intesa Sanpaolo Bank mbi veprimet e kryera në llogarinë e depozitës; (3) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare neto, lëshuar nga Drejtoria e Shëndetit Publik Elbasan për shtetasen L.H, për periudhën 1.1.1994 – 8.11.1999; (4) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare neto, lëshuar nga Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë për shtetasen L.H, për periudhën 1.1.2000 – 30.6.2009.

33.26 Nga verifikimi i të dhënave bankare të shtetasit B.H pranë Alpha Bank¹⁰⁷, ka rezultuar se në datën 31.7.2014 është transferuar një shumë prej 4.000.000 lekësh midis 2 llogarive pranë Alpha Bank, me përshkrimin “Sa kaluar nga B.H për H.K, dhënie borxhi”.

33.27 Nga verifikimi të dhënave bankare pranë ABI Bank¹⁰⁸ (shoqëria përthithëse e ish-NBG Bank), evidentohet se në datën 1.8.2014 është kryer transferimi i shumës 2.000.000 lekë shtetasit J.H.K, me përshkrimin “Dhënie borxhi nga B.H”.

33.28 Komisioni i ka kërkuar¹⁰⁹ subjektit të depozitujë dokumentacion provues mbi burimet e ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e shumave 4.000.000 leke dhe 2.000.000 lekë, të depozituara në llogari nga shtetasi B.H, për të cilat subjekti ka shpjeguar¹¹⁰ se këto shuma janë kursime ndër vite të këtij shtetasi dhe, për sa kohë bashkëjetuesja nuk e ka pranuar dhurimin e kësaj banese, gjykon se në bazë të ligjit nr. 84/2016 nuk ka detyrim për justifikimin e ligjshmërisë së këtyre të ardhurave. Megjithatë, subjekti ka depozituar dokumentacionin bankar¹¹¹, si *statement* llogarie, mandatarkëtime, si dhe kontratat e hapjes së depozitës në afat të shtetasit B.H mbi veprimet e kryera prej tij, shuma të cilat sipas shpjegimeve të subjektit kanë qenë të depozituara në bankë e më pas janë tërhequr për t’u këmbyer në euro, me qëllim blerjen e apartamentit.

33.29 Referuar përshkrimeve bankare, duket se shumat 4.000.000 lekë dhe 2.000.000 lekë nuk janë përdorur për blerjen e apartamentit, por u janë dhënë borxh shtetasve H.K dhe J.K.

33.30 Subjektit i janë kërkuar¹¹² shpjegime në lidhje me këto transfertat, për të cilat ka shpjeguar¹¹³ ndër të tjera se qëllimi i tyre ishte këmbimi në euro i shumave dhe jo dhënia e huas. Subjekti ka depozituar¹¹⁴ vërtetime dhe prova për të ardhurat e shtetasit B.H në vite, si dhe deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.6.2024, përmes së cilës shtetasi H.K ka deklaruar se shtetasi B.H i ka transferuar atij dhe babait të tij të ndjerë, J.K, shumat 4.000.000 lekë, 2.000.000 lekë dhe 8.000 USD, me qëllim këmbimin në euro, për arsye sigurie, pasi kursi i këmbimit në banka ishte më i lartë.

Konstatimet e Komisionit

33.31 Nga hetimi i kryer ka rezultuar se:

¹⁰⁷ Me shkresat nr. *** prot., datë 26.7.2021 dhe nr. ***tbo prot., datë 23.4.2024, të OTP Bank (shoqëria përthithëse e Alpha Bank).

¹⁰⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 22.7.2021.

¹⁰⁹ Përmes pyetësorit me *email*-in datë 30.4.2024.

¹¹⁰ Shpjegimet e subjektit të dërguara në datën 20.5.2024, në përgjigje të pyetësorit datë 30.4.2024.

¹¹¹ Dokumentacioni i depozituar nga subjekti me nr. *** prot., datë 20.5.2024: (1) kontratë e hapjes së depozitës me afat pranë Alpha Bank, për shumën 2.000.000 lekë, në datën 14.7.2009 (me afat maturimi 14.7.2010); (2) kontratë e hapjes së depozitës me afat pranë Alpha Bank, për shumën 2.000.000 lekë, në datën 14.7.2010 (me afat maturimi 14.7.2011); (3) kontratë e hapjes së depozitës me afat pranë Alpha Bank, për shumën 2.500.000 lekë, në datën 14.7.2011 (me afat maturimi 16.7.2012); (4) kontratë e hapjes së depozitës me afat pranë Alpha Bank për shumën 2.500.000 lekë, në datën 16.7.2012 (me afat maturimi 16.7.2013) dhe pasqyra e veprimeve bankare; (5) kontratë e hapjes së depozitës me afat pranë Alpha Bank, për shumën 3.500.000 lekë, në datën 16.7.2013 (me afat maturimi 16.7.2014); (6) nxjerrje llogarie e shtetasit B.H, lëshuar nga Alpha Bank, për periudhën 1.3.2009 – 30.1.2017; (7) mandatarkëtim te NBG Bank, për depozitimimin e shumave nga shtetasi B.H, konkretisht shuma 337.000 lekë në datën 30.7.2012, shuma 1.000.000 lekë në datën 28.7.2010 dhe shuma 1.000 lekë në datën 30.7.2012; (8) kontratë për depozitën bonus të lidhur në datën 28.7.2010 me NBG Bank, për shumën e depozitës 1.000.000 lekë (me afat maturimi 28.7.2011); (9) kontratë për depozitën “E ardhura mujore”, datë 29.7.2011, e lidhur me NBG Bank, për shumën 1.104.949 lekë (me afat maturimi 29.7.2012); (10) kontratë për depozitën “E ardhura mujore”, datë 30.7.2012, e lidhur me NBG Bank, për shumën 1.500.000 lekë (me afat maturimi 30.7.2013); (11) *statement* llogarie e NBG Bank mbi veprimet bankare të shtetasit B.H, për periudhat 28.7.2011 – 1.8.2014 dhe 30.7.2012 – 3.1.2017; (12) *statement* llogarie e shtetasit B.H, lëshuar nga BKT në datën 30.1.2017, për periudhën 1.1.2009 – 30.1.2017; (13) nxjerrje llogarie për shtetasin B.H, lëshuar në datën 30.1.2017 nga Raiffeisen Bank, për periudhën 10.5.2005 – 29.1.2017.

¹¹² Përmes pyetësorit me *email*-in datë 28.5.2024.

¹¹³ Shpjegimet e subjektit të depozituara në datën 13.6.2024.

¹¹⁴ Dokumentacioni i depozituar nga subjekti në datën 13.6.2024, regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 13.6.2024.

- Ka deklarime kontradiktore nga shtetasja D.H, pasi nga aktet e administruara ka rezultuar se kjo shtetase ka lidhur në datën 11.2.2016 kontratën e furnizimit me energji elektrike me FSHU-në, ndërsa në deklaratën *Vetting* deklaroi se ka marrë dajeni në lidhje me kontratën e porosisë në janar të vitit 2017.
 - Ngrihen dyshime lidhur me vërtetësinë e vetëdeklarimeve të shtetases D.H se pasuria apartament është porositur nga prindërit e saj, kjo pasi:
 - a) nga të dhënat bankare ka rezultuar se likuiditetet në depozitat e prindërve, shumat 4.000.000 lekë dhe 2.000.000 lekë, nuk janë përdorur për blerjen e apartamentit, por janë transferuar me përshkrimin “Dhënie borxhi”, palëve të treta;
 - b) shuma e depozitës 8.000 USD është tërhequr në vitin 2008 nga shtetasja D.H, ndërsa apartamenti është porositur në vitin 2014, pas 6 vitesh;
 - c) nuk provohen pagesat e kryera për blerjen e kësaj pasurie tek shoqëria “K”, edhe pse në kontratën e porosisë përcaktohet se ato do të kryheshin në numrin e llogarisë në bankë pranë kësaj shoqërie.
 - Ka mospërputhje deklarimesh në lidhje me pagesat e kryera për apartamentin.
 - Duket se prindërit e shtetases D.H nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e apartamentit, pasi kanë rezultuar me pamundësi financiare për krijimin e depozitave, me një balancë negative në shumën totale -2.477.626 lekë, deri në vitin 2001.
- ✓ Në lidhje me këto konstatime, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

33.32 Në lidhje me këtë pasuri, subjekti sqaron se bashkëjetuesja e tij nuk ka pasur asnjë dajeni për lidhjen e kontratës së porosisë datë 8.8.2014, e cila nuk është nënshkruar prej saj, pasi në datën në fjalë ndodhej në Australi, gjë e cila provohet nga sistemi TIMS, dhe kjo kontratë është një veprim juridik nul, absolutisht i pavlefshëm. Duke iu referuar nenit 761 të Kodit Civil mbi dhurimin e pasurive të paluajtshme, subjekti ka sqaruar se nga ana e bashkëjetueses nuk është nënshkruar asnjë kontratë për pranimin e dhurimit e, për rrjedhojë, nuk është kryer asnjë veprim për regjistrimin e kësaj kontrate apo pasurie pranë ASHK-së. Ndodhur në këto kushte, nuk ka detyrimin ligjor për të justifikuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të prindërve të bashkëjetueses, për sa kohë nuk e kanë pranuar këtë pasuri.

33.33 Sa i përket konstatimit të Komisionit për lidhjen e kontratës së FSHU-së nga bashkëjetuesja, subjekti deklaroi me përgjegjësi të plotë se bashkëjetuesja D.H nuk ka lidhur asnjë kontratë me FSHU-në për energjinë elektrike dhe nënshkrimi i kësaj kontrate nuk është bërë prej saj. Për të vërtetuar sa më sipër, subjekti kërkoi nga Komisioni që kontrata e datës 11.2.2016 t'i nënshtrohet një ekspertimi grafik, për të vërtetuar nëse është nënshkruar apo jo nga ana e bashkëjetueses. Subjekti ka shpjeguar se, nisur nga praktika që ndiqet për lidhjen e kontratave me FSHU-në, ku administratori i pallatit nënshkruan kontratat fillestare për të gjithë banorët, mendon se kjo do të ketë ndodhur edhe në rastin në fjalë, por gjithsesi subjekti pretendon se kjo kontratë në asnjë mënyrë nuk është nënshkruar nga bashkëjetuesja e tij, pasi kjo pasuri nuk është pranuar si dhurim.

33.34 Subjekti ka prapësuar se të gjitha konkluzionet mbi këtë pasuri bazohen në një kontratë absolutisht të pavlefshme, e cila nuk mund të prodhojë asnjë pasojë juridike. Sqarimet e

dërguara për të ardhurat e shtetasve B dhe L.H janë bërë në kuadrin e të qenit transparent e bashkëpunues me Komisionin. Sipas subjektit, në kushtet kur bashkëjetuesja nuk e ka pranuar dhurimin sipas kërkesave të nenit 761 të Kodit Civil, si dhe duke u bazuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk ka detyrimin ligjor për të paraqitur dokumente justifikuese për ligjshmërinë e burimeve të pasurisë së shtetasve B dhe L.H. Subjekti i referohet edhe vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 15, datë 17.7.2019, e cili, ndër të tjera, ka argumentuar se: *“Sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, një subjekt rivlerësimi do të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e krijimit të pasurisë së personit tjetër të lidhur vetëm kur me të ka hyrë në një marrëdhënie huaje ose dhurimi, në raste të tjera të marrëdhënieve të interesit, pasuria e personave të tjerë të lidhur duhet të jetë objekt verifikimi në kontekst të verifikimit të gjendjes së konfliktit të interesave”*. Subjekti ka prapësuar se nuk ka asnjë detyrim ligjor për të justifikuar burimin e krijimit të saj, pasi ajo nuk është pranuar asnjëherë nga bashkëjetuesja dhe as kontrata me FSHU-në në vitin 2016 nuk është nënshkruar prej saj, dhe kërkon që kjo kontratë t'i nënshtrohet një ekspertimi grafik. Subjekti ka depozituar si dokumentacion provues aktin ekspertimit grafik (shkrimi e nënshkrimi) nr. ***, datë 9.9.2024, të hartuar nga një ekspert kriminalist, për ekspertimin e nënshkrimit të bashkëjetueses D.H në kontratën për shërbime të Ujësjetës Kanalizime Tiranë, datë 12.4.2017, akt i cili nuk ka rezultuar të jetë shkruar e nënshkruar nga kjo shtetase.

Vlerësimi i Komisionit

33.35 Komisioni vlerëson se pretendimet e subjektit se kontrata me FSHU-në për furnizim me energji elektrike, e datës 11.2.2016, nuk është nënshkruar nga bashkëjetuesja e tij, mbetet në nivel deklarativ dhe e paprovuar me dokumentacion mbështetës, e ndërsa subjekti ka depozituar në prapësime një akt ekspertimi grafik për kontratën datë 12.4.2017, e lidhur me Ujësjetës Kanalizime Tiranë, ku shtetasja D.H nuk rezultoi ta ketë nënshkruar këtë akt.

33.36 Nga ana e Komisionit mbeten të paqarta dhe pa shpjegime bindëse e logjike pyetjet se nga kush janë nënshkruar aktet si kontratë porosie, kontrata me FSHU-në për furnizimin me energji elektrike apo kontrata me UKT-në, nëse nuk janë nënshkruar nga bashkëjetuesja, siç pretendohet nga subjekti. Deklarimet e subjektit se kontrata me FSHU-në, e po ashtu kontrata e porosisë datë 8.8.2014, nuk janë nënshkruar nga bashkëjetuesja, mbeten të paprovuara, pasi, në të kundërt, do të çonin në dyshimet për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

33.37 Sa i përket pamundësisë financiare të prindërve të bashkëjetueses për blerjen e apartamentit dhe pretendimeve të subjektit se nuk ka detyrimin për të justifikuar burimet e ligjshme të krijimit të kësaj pasurie, pasi nuk është pranuar si dhurim nga bashkëjetuesja e tij, Komisioni çmon se ky shpjegim nuk qëndron në rastin konkret, pasi pas marrjes dijeni mbi këtë kontratë porosie nuk rezultoi e provuar me ndonjë akt nga bashkëjetuesja mospranimi i dhurimit.

33.38 Në kontratën e porosisë datë 8.8.2014, bashkëjetuesja D.H figuron *de jure* porositëse e këtij apartamenti dhe në mungesë të një akti heqjeje dorë nga e drejta e pronësisë, ajo vijon të mbetet ende pronare e ligjshme e kësaj pasurie. Gjithashtu, gjatë hetimit, si dhe pas kalimit të barrës së provës, nuk u provuan pagesat e kryera për këtë apartament dhe kush i ka kryer ato. Sa më sipër, mungesa e përgjigjeve bindëse, si dhe e ndonjë prove konkrete për të vërtetuar sa pretendohet nga subjekti, krijon për Komisionin bindjen se me qëndrimet e tij subjekti kërkon

të shmangë përgjegjësitë që rrjedhin nga pamjaftueshmëria financiare për krijimin e kësaj pasurie.

33.39 Komisioni çmon se problematikat e konstatuara në këtë pasuri lidhur me pamundësinë e të ardhurave të ligjshme të prindërve të bashkëjetueses për blerjen e apartamentit, të konsideruara së bashku me problematikat e tjera të kriterit të pasurisë, përbëjnë shkak që subjekti të gjendet nën parashikimet e nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

VERIFIKIME TË TJERA

34. Verifikimi i llogarive bankare të subjektit dhe bashkëjetues nga Komisioni

34.1 Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se subjekti ka pasur likuiditeteve në llogari¹¹⁵ bankare (kryesisht llogari page/rrjedhëse ose *overdraft*) dhe nuk i ka deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe as në deklaratimet periodike vjetore, sipas përcaktimeve të nenit 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 4, shkronja “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar).

✓ Lidhur me këtë konstatim të Komisionit, subjektit iu kërkuan shpjegime.

Prapësimet e subjektit të rivlerësimit

34.2 Subjekti në prapësimet e tij e pranon të drejtë këtë konstatim të Komisionit, duke shpjeguar se kjo ka ardhur për faktin se gjendja e llogarive ka qenë minimale dhe ka menduar se nuk duhet të deklaroheshin, pasi ishte poshtë kufirit prej 300.000 lekësh dhe nuk ka pasur asnjë qëllim fshehjeje nga ana e tij, pasi duke qenë të depozituara në bankë si shuma, ashtu edhe burimi i tyre, është lehtësisht e verifikueshme.

Vlerësimi i Komisionit

34.3 Lidhur me prapësimet e subjektit për mosdeklarimin e likuiditeteve poshtë kufirit prej 300.000 lekësh, Komisioni, sikurse ka arsyetuar edhe në pikën 29.10 të këtij vendimi, vlerëson se, për të njëjtat arsye, pretendimet e subjektit nuk mund të pranohen, pasi ligji nr. 9049/2003 ka përcaktuar qartësisht detyrimin e subjekteve për të deklaruar çdo lloj pasurie, si dhe gjendjen e likuiditeteve bankare, pa vendosur kufizime në vlerë.

34.4 Komisioni çmon se, pavarësisht se gjendjet e llogarive bankare kanë qenë në vlera minimale, subjekti duhej të deklaronte gjendjet e likuiditeteve të llogarive në deklaratimet periodike vjetore dhe në deklaratën *Vetting*, sipas përcaktimeve të nenit 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 4, shkronja “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.

35. Automjet tip “Mercedes-Benz”, i blerë në vitin 2004 dhe çregjistruar në vitin 2009

35.1 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar nga DPSHTRR-ja¹¹⁶, ka rezultuar se subjekti, në datën 28.5.2004, ka blerë në Gjermani nga shtetasi I.K automjetin tip “Mercedes-Benz”, vit prodhimi 1989, në vlerën 1.500 euro. Në datën 30.12.2004, subjekti ka kryer zhdoganimin e mjetit, ku vlera e tij sipas faturës së zhdoganimit rezulton 300.000 lekë + zhdoganim 188.773 lekë. Ndërsa, në DPV-në e vitit 2005 para fillimit të detyrës, subjekti e ka deklaruar këtë automjet në vlerën 2.000 euro, blerë në vitin 2004.

¹¹⁵ (1) Raiffeisen Bank me shkresën nr. *** prot., datë 26.7.2021, ka konfirmuar se z. Sabri Kastrati disponon llogari bankare dhe një *overdraft*, ku nga të dhënat gjendja e llogarisë së subjektit në dhjetor të vitit 2016 ka qenë -14.876 lekë; (2) Intesa Sanpaolo Bank me shkresën nr. *** prot., datë 30.7.2021, ka informuar se z. Sabri Kastrati ka pasur llogari pranë bankës, ku nga të dhënat bankare evidentohet: (a) llogari rrjedhëse e çelur në datën 16.3.2005 dhe mbyllur në datën 11.9.2008; (b) llogari *overdraft* e hapur në datën 30.11.2006 dhe mbyllur në datën 30.11.2007, në vlerën 204.000 lekë.

¹¹⁶ Dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 20.3.2024.

35.2 Nga aktet ka rezultuar se ky mjet është hequr nga qarkullimi dhe çregjistruar në datën 9.4.2009, bazuar në kërkesën e subjektit Sabri Kastrati, fakt i cili nuk është deklaruar në DPV-në e vitit 2009. Komisioni i ka kërkuar¹¹⁷ subjektit të shpjegojë lidhur me arsyen e mosdeklarimit të këtij fakti në DPV-në e vitit 2009, për të cilën ka shpjeguar¹¹⁸ se automjeti në fjalë është blerë në shumën e 200.000 lekë dhe ka menduar se është nën limitin e 300.000 lekëve të parashikuara nga ligji për deklarimin e shpenzimeve vjetore dhe, për këtë arsye, nuk është deklaruar çregjistrimi. Sipas subjektit, nuk ka pasur asnjë arsye tjetër, pasi është e qartë që ky çregjistrim është bërë në organet publike dhe është një veprim që nuk mund të fshihet.

Konstatimi i Komisionit

35.3 Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar mospërputhje lidhur me çmimin e blerjes së automjetit, sipas deklarimit në DPV-në e vitit 2005 (para fillimit të detyrës) dhe aktit të shitjes e zhdoganimit.

✓ Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kërkuan shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

35.4 Subjekti ka sqaruar se kjo pasuri është blerë përpara fillimit të detyrës dhe kur është bërë deklarimi fillestar është pasqyruar vetëm çmimi i blerjes së automjetit dhe jo pagesa e detyrimeve doganore, duke menduar se vetëm çmimi i blerjes duhet të deklarohej. Nuk ka pasur asnjë qëllim fshehjeje pasurie, pasi automjeti është blerë përpara fillimit të detyrës si prokuror. Kjo pasaktësi ka ndodhur nga paqartësia në plotësimin e formularit.

Vlerësimi i Komisionit

35.5 Komisioni çmon se pavarësisht se situata faktike nuk është deklaruar saktë nga subjekti i rivlerësimit në kuptim të ligjit nr. 9049/2003, nga hetimi i kryer nuk ka rezultuar që kjo pasaktësi në deklarim të ketë shërbyer për fshehjen e veprimeve të subjektit lidhur me këtë pasuri, apo të ketë shërbyer si shkak ose burim për krijimin e ndonjë pasurie tjetër nga subjekti, çka krijon bindjen e Komisionit se kjo pasaktësi e konstatuar është e paqëllimshme dhe nuk mund të përbëjë shkak për deklarim të pamjaftueshëm të pasurisë.

36. Lidhur me shpenzimet e udhëtimit

36.1 Shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit u analizuan bazuar në lëvizjet nëpërmjet sistemit TIMS¹¹⁹ të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur.

36.2 Me anë të pyetësorit për shpenzimet e udhëtimit, subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me çdo udhëtim të kryer prej tij, ndërsa për udhëtimet e kryera në Australi, ka deklaruar se nuk ka shpenzuar, pasi ka qëndruar tek të afërmit. Subjekti ka depozituar në cilësinë e provës vetëm një deklaratë me shkrim dore të personit të afërm, duke mos e shoqëruar me ID-në apo vërtetimin e adresës sipas standardit të vendosur nga Kolegji.

36.3 Nga hetimi për udhëtimet që nuk janë provuar me dokumentacion mbështetës, Komisioni i ka përlllogaritur referuar jurisprudencës së Kolegjit¹²⁰.

Prapësimet e subjektit të rivlerësimit

¹¹⁷ Përmes pyetësorit me *email*-in datë 30.4.2024.

¹¹⁸ Shpjegimet e subjektit të depozituara në datën 20.5.2024.

¹¹⁹ Dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 29.7.2021, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

¹²⁰ Vendim nr. 11-2019 (JR), datë 22.5.2019.

36.4 Subjekti, përmes prapësimeve të tij, ka pretenduar se për udhëtimet e kryera në Australi nuk kanë pasur shpenzime, pasi ato janë përballuar nga të afërmit e tyre, që prej vitesh banojnë në shtetin australian. Subjekti pretendon se kostot e këtyre shpenzimeve sipas analizës së Komisionit nuk pasqyrojnë realitetin, por janë disa herë më të larta se shpenzimet reale. Subjekti ka shpjeguar se gjatë këtyre periudhave kanë qëndruar tek shtëpia e tezes së bashkëshortes, shtetasja A.I (A), e cila sipas subjektit ka lëshuar një deklaratë me shkrim, që konfirmon qëndrimin tek banesa e saj. Subjekti ka depozituar si dokumentacion provues:

- Kopje të pasaportës dhe patentës së shtetases A.A, ku evidentohet edhe adresa e banimit të saj në Australi;
- Kontratë për shitje biznesi nga shtetasja A.A dhe bashkëshorti i saj, S.A, datë 24.4.2018 (në gjuhën angleze). Sipas subjektit, kjo kontratë tregon se teza e bashkëjetueses ka pasur një biznes të vetin deri në vitin 2018 dhe ka pasur mundësi për mbulimin e shpenzimeve e qëndrimit në Australi;
- Kopje e përkthyer e deklaratës së lëshuar nga shtetasja A.A, datë 11.6.2024, e nënshkruar në praninë e farmacistes S.R, ku znj. A deklaron se është nënshtetase australiane dhe mbesa e saj D.H e ka vizituar disa herë së bashku me familjen e saj, ku kanë qëndruar në shtëpinë e saj. Kjo shtetase deklaron se shpenzimet e qëndrimit janë përballuar prej saj dhe familjes së saj;
- Kopje e përkthyer e pjesës 4 “Deklaratat” të Ligjit për Betimet, Dëshmitë dhe Deklaratat 2005 të Australisë Perëndimore, ku sipas subjektit evidentohet lista e personave të autorizuar për të dëshmuar nënshkrimin e deklaruesit dhe nën numrin rendor 9 farmacisti që ka vërtetuar nënshkrimin e deklaratës së shtetases A.A është pjesë e listës së personave të autorizuar me ligj;
- Kopje e përkthyer e kontratës së shitjes së biznesit, datë 24.4.2018, ku shtetasja A.A ka qenë ortakë së bashku me bashkëshortin e saj S.A.

Vlerësimi i Komisionit

36.5 Komisioni, pasi vlerësoi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti në prapësime, çmon t’i konsiderojë pretendimet e subjektit, duke rishikuar analizën financiare lidhur me shpenzimet e udhëtimit. Komisioni vlerëson se, në rastet kur familjarët kanë qëndruar në shtetin australian, shpenzimet të përlllogariten sipas standardit të Kolegjit, me 5 euro/dita.

37. Shpenzimet e shkollimit të fëmijëve

37.1 Shpenzimet e shkollimit janë reflektuar në analizën financiare të Komisionit, sipas vërtetimit të lëshuar nga institucionet shkollore.

38. Analiza financiare e subjektit të rivlerësimit për periudhën 2005 – 2016

38.1 Komisioni, në vlerësim të çështjeve të trajtuara sa më sipër, të reflektuara në analizë, paraqitet situatën financiare të subjektit të rivlerësimit pas prapësimeve në tabelën vijuese.

Tabela e përgjithshme e analizës financiare për periudhën 2005 – 2016

PERSHKRIMI	PASURI	DETYRIME	PASURI NETO	TE ARDHURA	SHPENZIME	REZULTATI
2005	87 997	-	87 997	1 256 893	445 084	723 812
2006	6 764 383	-	6 764 383	1 355 133	907 102	- 6 316 352
2007	779 456	-	779 456	1 435 828	1 627 242	- 970 870
2008	2 489 822	-	2 489 822	4 136 966	1 095 147	551 997
2009	572 494	-	572 494	1 820 848	1 322 177	- 73 823
2010	- 131 698	-	- 131 698	2 520 887	998 706	1 653 879
2011	92 604	-	92 604	2 198 121	1 316 108	789 409
2012	- 67 188	-	- 67 188	2 300 534	1 196 201	1 171 521
2013	13 491 619	-	13 491 619	2 528 924	1 888 126	- 12 850 821
2014	8 696 120	-	8 696 120	2 215 241	1 838 525	- 8 319 404
2015	- 211 112	-	- 211 112	1 864 811	2 340 722	- 264 800
2016	788 502	-	788 502	3 055 651	2 605 962	- 338 813

39. Konkluzioni përfundimtar për vlerësimin e pasurisë

39.1 Në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, trupi gjykues konkludoi se:

i. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë të pasurive dhe burimeve të ligjshme të tyre në deklaratën e pasurisë *Vetting*, sipas parashikimit të shkronjës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

ii. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e pasurive, sipas parashikimit të shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

39.2 Në këto rrethana, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme për kriterin e pasurisë, në përputhje me pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, që përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

B. KONTROLLI I FIGURËS

40. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me qëllim identifikimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

41. Për këtë qëllim, AKSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar pranë Komisionit raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) bazuar në pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Sabri Kastrati ka pasaktësi në plotësimin e deklaratës për kontrollin e figurës, duke mos deklaruar kontaktet e papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar. Mosdeklarimi në këtë rast e ngarkon me përgjegjësinë e fshehjes së një fakti e plotësimit të pasaktë dhe me vërtetësi të deklaratës për kontrollin e figurës.

42. Sipas raportit të AKSIK-së, për subjektin e rivlerësimit Sabri Kastrati administrohen informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për implikimin e tij apo për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Gjithashtu, nga autoritetet verifikuese disponohen të dhëna ***, ku për subjektin ngrihen dyshime për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e

korupsionit pasiv të gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës dhe ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike. Autoritetet verifikuese kanë informuar instancat përkatëse në rastet kur subjekti i rivlerësimit ka mundësuar ndryshimin e masës së sigurisë ndaj një të pandehuri, si dhe kur ka ndryshuar akuzën kundrejt përfitimit të një shume të konsiderueshme parash.

43. Në vlerësim të të dhënave të disponuara, AKSIK-ja gjykon se informacionet që disponohen në ngarkim të z. Kastrati, për një periudhë relativisht të gjatë në kohë, në më shumë se një rast, nëpërmjet premtimit apo kërkimit të drejtpërdrejt apo tërthorazi të çfarëdolloj përfitimi të parregullt, për të kryer ose moskryer një veprim, që lidhet me detyrën e tij funksionale, e bën subjektin e rivlerësimit, në mbështetje të shkronjave “b” dhe “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, person me tendenca në përfshirjen në veprimtari kriminale dhe një individ që mund të vihet lehtësisht nën presion nga strukturat kriminale. Gjithashtu, në mbështetje të pikës 4 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, ekzistojnë të dhëna nga autoritetet verifikuese ku subjekti i rivlerësimit Sabri Kastrati ka kontakte të papërshtatshme ***.

44. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, AKSIK-ja ka dërguar një raport¹²¹, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar:

✓ Papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të z. Sabri H Kastrati.

Hetimi i Komisionit mbi kontrollin e figurës

45. Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, nisur nga raporti i dërguar nga AKSIK-ja ka aksesuar informacionin pranë institucionit verifikues, si dhe ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo të dhënë dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur lidhur me dyshimet për kontakte të papërshtatshme dhe përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e korupsionit pasiv.

45.1 Lidhur me dyshimet për kontakt të papërshtatshëm, nga verifikimi i të dhënave të sistemit TIMS të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit¹²², si nga informacioni i gjeneruar nga sistemi i AMF-së, nuk ka rezultuar që subjekti të ketë udhëtime me shtetas të cilët konsiderohen kontakt i papërshtatshëm, apo të kenë përdorur automjete në pronësi të tyre.

45.2 Lidhur me dyshimet për korupsion nga ana e subjektit, bazuar në informacionet e marra nga autoritetet verifikuese, Komisioni ka administruar disa dosje penale¹²³, si dhe vendime gjyqësore, të cilat janë analizuar, dhe të dhënat e rezultuara nga verifikimi i tyre janë vlerësuar në kriterin e vlerësimit profesional, të trajtuara tek kapitulli “V. Gjetje të tjera lidhur me kriterin profesional”.

46. Gjetje të tjera lidhur me kriterin e figurës

46.1 Nga verifikimi i të dhënave të administruara, ka rezultuar se gjeneralitetet e deklaruara nga subjekti, si dhe të konfirmuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile¹²⁴ janë *Sabri Kastrati, me datëlindje 25.9.1971, vendlindja B, K, shtetësia shqiptar*. Ndërsa nga të dhënat e

¹²¹ Raporti nr. *** prot., datë 2.11.2017, i deklasifikuar pjesërisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 4.7.2023.

¹²² Me shkresën nr. *** prot., datë 29.7.2021, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

¹²³ (1) Shkresa nr. *** prot., datë 22.4.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër; (2) shkresa nr. *** prot., datë 12.4.2024, e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër; (3) shkresa nr. *** prot., datë 24.4.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë; (4) shkresa nr. *** prot., datë 22.4.2024, e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

¹²⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 11.8.2021.

dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit¹²⁵ evidentohen regjistrime hyrje-dalje nga Shqipëria për shtetasin *Sabri H Kastrati, i ditëlindjes 17.9.1971*, për periudhën 2004 – 2021. Gjatë hetimit subjekti ka dhënë shpjegime¹²⁶ lidhur me këto udhëtime të kryera prej tij me pasaportë australiane, të ditëlindjes 17.9.1971.

46.2 Nga hetimi i Komisionit, referuar të dhënave të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, është evidentuar:

- Përdorimi i një pasaporte të padeklaruar në deklaratën për kontrollin e figurës, me nënshtetësi kanadeze, me nr. L***CA, e përdorur nga subjekti për udhëtime jashtë vendit në periudhën 2004 – 2009, me të dhëna të ndryshme nga gjeneralitet e konfirmuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, pasi ka datëlindjen 17.9.1971.
- Subjekti ka deklaruar shpenzimet e udhëtimeve lidhur me hyrje-daljet e tij dhe të familjarëve, ku ndër të tjera ka përdorur edhe pasaportën kanadeze ku ka udhëtuar në të njëjtën ditë së bashku me shtetasen D.H (bashkëjetuese), si dhe djalin A.K, konkretisht në datat 23.6.2009 (hyrje) dhe 1.8.2006 (dalje).
- Gjithashtu, nga hetimi u evidentua përdorimi i pasaportës me nënshtetësi australiane, me nr. N***AU, e përdorur për periudhën 2011 – 2021, e cila është deklaruar nga subjekti në formularin e figurës, por edhe kjo pasaportë përmban të dhëna të ndryshme nga gjeneralitet e konfirmuara nga Gjendja Civile për subjektin e rivlerësimit, pasi ka datëlindjen 17.9.1971.
- Sipas raportit të gjeneruar nga sistemi TIMS, me emrin Sabri Kastrati rezultojnë 4 shtetas me ditëlindje të ndryshme: (1) Sabri Kastrati, me datëlindje 25.9.1971; (2) Sabri Kastrati, me datëlindje ***, vendlindja Kosovë, nacionaliteti Australi; (3) Sabri Kastrati, me datëlindje ***, nacionaliteti Australi – me këto të dhëna rezulton edhe pasaportë kanadeze aktive për vitet 2001 – 2011, dokument i përdorur deri në vitin 2009, si dhe dokument ky i padeklaruar në deklaratën për kontrollin e figurës; (4) Sabri Kastrati, me datëlindje ***, vendlindja Kosovë, nacionaliteti Shqipëri.

46.3 Komisioni i ka kërkuar¹²⁷ subjektit të shpjegojë lidhur me nxjerrjen dhe përdorimin e këtyre dokumenteve, që përmbajnë të dhëna të ndryshme nga ato të konfirmuara nga Zyra e Gjendjes Civile, dhe të padeklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës.

46.4 Subjekti ka shpjeguar¹²⁸ ndër të tjera se nuk ka asnjë dizeni se nga janë gjeneruar këto të dhëna, pasi ato dhe pasaporta nuk janë përdorur dhe as deklaruar ndonjëherë prej tij përpara ndonjë autoriteti, qoftë shqiptar apo i huaj. Subjekti ka shpjeguar se ka udhëtuar gjithmonë me pasaportën australiane, me të dhënat e deklaruara prej tij, dhe nuk ka përdorur asnjë pasaportë tjetër, aq më tepër kanadeze.

46.5 Në formularin “Deklaratë për kontrollin e figurës”, subjekti ka deklaruar se nga viti 2001 ka fituar shtetësinë australiane. Komisioni i ka kërkuar¹²⁹ subjektit të deklarojë mënyrën e emigrimit dhe fitimit të kësaj shtetësie, si dhe të depozitojë kopje të pasaportës, për të cilën ka shpjeguar¹³⁰ se shtetësinë australiane e ka fituar nëpërmjet naturalizimit, duke ndjekur procedurat ligjore të shtetit australian për marrjen e shtetësisë, por nuk depozitoi kopje të

¹²⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 29.7.2021, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

¹²⁶ Shpjegimet e subjektit të dërguara me *email*-in datë 18.12.2023.

¹²⁷ Përmes pyetësorit me *email*-in datë 22.7.2024.

¹²⁸ Shpjegimet e subjektit me *email*-in datë 22.7.2024.

¹²⁹ Përmes pyetësorit me *email*-in datë 18.7.2024.

¹³⁰ Shpjegimet e subjektit me *email*-in datë 22.7.2024.

pasaportës së tij. Në vijim, subjekti ka shpjeguar¹³¹ se në shtetin australian fillimisht ka shkuar me vizë të akorduar nga Ambasada Australiane në Athinë, Greqi, pas ftesës që i kishin bërë atij dhe bashkëjetueses, të afërm që prej vitesh jetojnë në Australi. Pasi ka dhënë dorëheqjen nga funksioni si zv.prokuror rrethi, në tetor të vitit 1998 kanë shkuar në Australi dhe gjatë kohës së qëndrimit ai dhe bashkëjetuesja vendosën që të aplikonim për një vizë afatgjatë, e cila iu është miratuar dhe më pas kanë ndjekur procedurat ligjore për marrjen e shtetësisë nëpërmjet naturalizimit.

Konstatime të Komisionit për kontrollin e figurës

46.6 Nga hetimi administrativ i kryer lidhur me këtë kriter, ka rezultuar se subjekti:

- Ka pasaktësi në plotësimin e deklaratës për kontrollin e figurës, pasi subjekti nuk ka deklaruar përdorimin e pasaportës kanadeze.
 - Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën për kontrollin e figurës gjeneralitetet e ndryshme nga ato të Gjendjes Civile, të përdorura nëpër dokumente identifikimi të ndryshme.
 - Ngrihen dyshime për deklarime të rreme nga ana e subjektit, pasi gjatë hetimit subjekti ka deklaruar shpenzime për udhëtimet e kryera me pasaportë kanadeze, ndërsa në pyetësonin e dërguar së fundmi mohon të ketë dijeni lidhur me këtë pasaportë.
 - Është e paqartë nxjerrja dhe përdorimi i këtyre dokumenteve me gjeneralitete të ndryshme nga ana e subjektit të rivlerësimit.
 - Subjekti ka kryer deklaram të pamjaftueshëm, pasi nuk ka qartësuar mënyrën e fitimit të shtetësisë australiane, duke u mjaftuar vetëm me termin natyralizim, term i cili bazohet në kritere të përcaktuara.
- ✓ Në lidhje me këto konstatime, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

46.7 Sipas subjektit, këto konstatime të Komisionit janë të pavërteta dhe deklaroi se është i shokuar nga fakti sesi mund të aludohet që një prokuror ka përdorur pasaporta të ndryshme. Sipas subjektit, nga sistemi TIMS mund të verifikohen udhëtimet e tij të kryera disa herë jashtë Shqipërisë dhe tranziti apo destinacioni përfundimtar ka qenë në shtete të cilat kanë një kontroll sigurie tepër rigoroz dhe të hollësishëm dhe subjekti nuk është bërë objekt kontrolli nëpër pikat e kalimit kufitar të Shqipërisë apo shteteve të tjera ku ka kaluar tranzit, apo ka pasur destinacionin.

46.8 Për sa i përket të dhënave dhe pasaportave të ndryshme të cilat ekzistojnë nën emrin Sabri Kastrati, subjekti thekson se nuk ka asnjë dijeni se nga janë gjeneruar këto të dhëna, pasi ato dhe pasaporta nuk janë përdorur dhe as deklaruar ndonjëherë prej tij përpara ndonjë autoriteti, qoftë shqiptar apo i huaj. Subjekti deklaroi se nuk ka qenë asnjëherë në Kanada dhe se, përveç pasaportës australiane me të dhënat e deklaruara prej tij, nuk ka përdorur asnjë pasaportë tjetër, as më tepër pasaportë kanadeze.

46.9 Subjekti pretendon se nga kërkimi në sistemin TIMS pasaporta me nr. L*** një herë është pasqyruar si pasaportë australiane (nga kërkimi me emër personi) dhe pastaj si kanadeze (nga verifikimet e hyrje-daljeve), duke argumentuar se dy shtete të ndryshme nuk mund të lëshojnë

¹³¹ Shpjegimet e subjektit me *email*-in datë 22.7.2024.

dy pasaporta me të njëjtët numra. Sipas subjektit, nga oficerët e policisë në pikat e kalimit kufitar janë regjistruar gabim të dhënat e pasaportës, si dhe të dhënat të tjera si datëlindja apo vendlindja. Subjekti thekson se *të dhënat në sistemin TIMS hidheshin në mënyrë manuale nga oficerët e policisë dhe kjo ka shkaktuar pasqyrimin në mënyrë të gabuar të gjeneraliteteve jo vetëm për personin e tij, por edhe për shumë persona të tjera.*

46.10 Sipas subjektit, nga verifikimi i hyrje-daljeve i rezulton se ka dalë nga territori i Shqipërisë duke përdorur pasaportën kanadeze në datën 10.12.2009 dhe ka hyrë në Shqipëri në datën 2.3.2011 (afërsisht 2 vjet më vonë), ndërkohë që ka ushtruar funksionin e prokurorit gjatë gjithë kësaj kohe. Sipas tij, të dhënat në lidhje me këtë pasaportë kanadeze janë regjistruar gabim, pasi ai nuk ka pasur dhe as ka përdorur ndonjëherë pasaportë kanadeze.

46.11 Sipas subjektit, numrat e pasaportave kanadeze kanë tjetër formatim dhe, më konkretisht, ky numër përbëhet nga një shkronjë, pasuar nga gjashtë numra dhe më pas dy shkronja, ndërsa numrat e pasaportës australiane momentalisht përbëhen nga dy shkronja, pasuar nga shtatë numra (ndërsa më parë përbëheshin nga një shkronjë, pasuar nga shtatë numra).

46.12 Subjekti e kundërshton konstatimin e Komisionit për deklaram të pamjaftueshëm, pasi gjatë hetimit ai ka shpjeguar se ka shkuar në Australi fillimisht me vizë të akorduar nga Ambasada Australiane në Athinë, Greqi, pas ftesës që i kishin bërë atij dhe bashkëjetueses, të afërm që prej vitesh jetojnë në Australi. Gjatë kohës së qëndrimit në Australi, ai dhe bashkëjetuesja vendosën që të aplikonim për vizë afatgjatë, e cila u është miratuar, dhe më pas kanë ndjekur procedurat ligjore për marrjen e shtetësisë nëpërmjet naturalizimit. Subjekti ka shpjeguar se sipas ligjit australian nënshtetësia australianë përfitohet në dy mënyra: (a) nëpërmjet lindjes nga prindër me nënshtetësi australiane; (b) nëpërmjet natyralizimit. Subjekti ka shpjeguar se *për fitimin e shtetësisë nëpërmjet natyralizimit duhet që, së pari, të kesh leje qëndrimi të përhershme, së dyti, të jesh në Australi në kohën kur aplikimi shqyrtohet nga autoritetet përkatëse, si dhe, së treti, të kesh ndërmend të jetosh në Australi.*

46.13 Subjekti ka shpjeguar se kanë aplikuar për vizë të përhershme (leje qëndrimi të përhershme), pasi kanë menduar të jetojnë aty dhe pasi i është akorduar kjo leje qëndrimi (permanent rezident), ka aplikuar për nënshtetësi australiane.

46.14 Subjekti prapëson se mënyra e fitimit të shtetësisë së një vendi tjetër nuk është objekt i kontrollit të figurës sipas përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016, konkretisht nenit 34, i cili parashikon se: *“Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklaramëve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës”*. Sipas subjektit, në deklaratën për verifikimin e figurës në pjesën 1 “Të dhëna identifikuese” kërkohen të dhëna nëse subjekti ka ndonjë shtetësi tjetër përveç asaj shqiptare, detyrim i cili është përmbushur prej tij dhe në asnjë rresht të kësaj deklarate nuk kërkohen të dhëna për mënyrën e fitimit të shtetësisë.

46.15 Për sa i përket pasaportës kanadeze me nr. L***CA, subjekti i kërkon Komisionit që t'i drejtohet me kërkesë për informacion autoriteteve përkatëse kanadeze, nga ku do të vërtetohet fakti se kjo pasaportë nuk është disponuar prej tij, pasi subjekti është në pamundësi objektive për të siguruar këtë lloj informacioni. Përfundimisht, subjekti pretendon se deklarata për figurën është plotësuar në përputhje të plotë me ligjin dhe nuk ka asnjë deklaram të pamjaftueshëm nga ana e tij. Subjekti ka depozituar dokumentacionin vijues:

- kërkesë drejtuar Ambasadës Kanadeze për të kërkuar informacion në lidhje me këtë pasaportë, e shoqëruar me dëftesën për pranimin e objekteve postare, i datës 19.8.2024;
- kopje e përkthyer e njoftimit, datë 23.2.2001, për dhënien e nënshtetësisë australiane z. Sabri Kastrati nga ana e ministrit të Emigracionit;
- modele të pasaportave kanadeze dhe australiane me shënimet përkatëse, ku sipas subjektit pasaportat kanadeze fillojnë me dy shkronja dhe pasohen me gjashtë shifra, ndërsa pasaporta australiane fillon me një ose dy shkronja dhe pasohen nga shtatë shifra. Sipas subjektit¹³², numrat e pasaportës të përfuara nga sistemi TIMS, përkatësisht L***, përkrijnë me modelin e pasaportës australiane, ku është një shkronjë, e pasuar me shtatë shifra.

Vlerësimi i Komisionit për kontrollin e figurës

46.16 Trupi gjykues, pasi u njoh me shpjegimet e subjektit në prapësime, si dhe dokumentacionin e depozituar nga ana e tij, konstaton se subjekti sërisht nuk qartësoi mënyrën e fitimit të shtetësisë australiane dhe gjithashtu nuk depozitoi kopje të pasaportës së tij, as gjatë hetimit dhe as në prapësime, dokument i cili do të qartësonte situatën mbi gjeneralitetet e subjektit në pasaportat e përdorura. Refuzimi i subjektit për të paraqitur pasaportën australiane konsiderohet mungesë bashkëpunimi në kuptim të nenit 48 të ligji nr. 84/2016, duke krijuar bindjen e Komisionit se ai ka pasur për qëllim të shmangë verifikimin e të dhënave të këtij dokumenti për të arritur një rezultat në favor të tij.

46.17 Lidhur me konstatimin mbi ekzistencën dhe përdorimin e dokumenteve të identifikimit me gjeneralitete të ndryshme nga ato të konfirmuara nga Zyra e Gjendjes Civile, në prapësime, subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës. Shpjegimet e tij ishin të paqarta dhe jobindëse mbi mundësinë e hedhjes gabim të të dhënave nga oficerët e policisë, të cilat nuk u konsiderua bindëse nga ana e Komisionit, pasi nga hetimi rezultoi e provuar përdorimi i këtyre dokumenteve në mënyrë të përsëritur, në periudha e vite të ndryshme. Këto fakte eliminojnë mundësitë e ndonjë gabimi material të kryer nga oficerët në pikat e kontrollit.

46.18 Në vlerësim të provave të administruara për kriterin e kontrollit të figurës, trupi gjykues ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar me vërtetësi deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe ka kryer deklarin të pamjaftueshëm, në kundërshtim me parashikimet e nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, duke u gjendur në kushtet e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

47. Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në analizimin e:

- raportit¹³³ të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, sipas kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij);
- denoncimeve të paraqitura sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

48. Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga

¹³² Përmes *email*-it të datës 16.9.2024.

¹³³ Raporti nr. *** prot., datë 3.6.2021, i miratuar me vendimin e KLP-së nr. ***, datë 3.6.2021.

subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënat nga Sektori i Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme.

49. Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, konstatohet:

Saktësia e formularit të vetëdeklarimit

49.1 Formulari paraqitet i nënshkruar dhe i plotësuar sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

49.2 Gjatë periudhës së rivlerësimit, prokurori Sabri Kastrati ka paraqitur 3 dokumente ligjore, të cilat u analizuan nga Komisioni, dhe në dokumentin 1 u konstatua si vijon:

Dokumenti 1 – Vendimi datë 26.11.2014, për pushimin e procedimit penal nr. ***. Çështja penale konsiston në një kontroll të ushtruar në datën 7.7.2014 nga policia gjyqësore e Policisë Lezhë, në një lokal në fshatin B, në pronësi të shtetasit L.N, ku nga kontrolli i ushtruar janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale një kompjuter, një printer, si dhe një monitor 42 polësh. Në momentin e kontrollit këto pajisje nuk kanë qenë në gjendje pune dhe pronari i lokalit ka deklaruar se sendet e lartpërmendura nuk shërbenin për organizmin e lojërave të fatit.

Në përfundim të hetimeve, prokurori Sabri Kastrati, në mbështetje të nenit 328, shkronja “b” e Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur pushimin e çështjes, pasi fakti i referuar nuk parashikohet nga ligji si veprë penale. Subjekti ka pushuar çështjen, duke argumentuar se pajisjet elektronike nuk kanë qenë në punë dhe mbajtja e mjeteve të lojërave të fatit, pa i vënë ato në përdorim, nuk është e ndëshkueshme dhe nuk përbën elementet e figurës së veprës penale “Organizmi i lotarive të palejuara”, parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal.

Konstatimet e Komisionit

49.3 Nga akti vendim i pushimit duket se nuk janë kryer hetime të plota, pasi për të arritur në konkluzionin se mungojnë elementet e veprës penale, subjekti duhet të kishte kryer një ekspertim teknik të kompjuterit të sekuestruar, nëpërmjet të cilit do të përcaktohej saktë koha kur ka qenë në punë.

✓ Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kërkuan shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Prapësimet e subjektit të rivlerësimit

49.4 Subjekti ka prapësuar se hetimi i këtij procedimi penal nga ana e tij ka qenë korrekt, rigoroz dhe në mbështetje të plotë në ligjin penal dhe procedural penal, dhe vendimmarrja në lidhje me këtë procedim penal ka qenë tërësisht e bazuar në ligj e në prova. Subjekti ka argumentuar se kryerja e ekspertimit teknik nuk është konsideruar si veprim hetimor relevant për çështjen, pasi edhe po të përcaktohej koha e saktë kur kompjuteri ka qenë në gjendje pune, kjo nuk do të çonte automatikisht në konkluzionin se në rastin konkret ishte konsumuar vepra penale e organizimit të lotarive të palejuara, për sa kohë nuk kishte asnjë “të dhënë” tjetër, nga e cila të vërtetohej tej çdo dyshimi të arsyeshem se në rastin konkret ishin konsumuar elementet e veprës penale në fjalë.

Vlerësimi i Komisionit

49.5 Komisioni vlerësoi shpjegimet e dhëna nga subjekti në prapësime, duke i konsideruar ato bindëse. Në vlerësimin final lidhur me këtë çështje, trupit gjykues nuk i rezultuan indicie apo rrethana për fakte konkrete, të cilat të krijonin bindjen se subjekti ka kryer shkelje ligjore.

PËRSHKRIMI I 5 DOSJEVE TË PËRZGJEDHURA ME SHORT

50. Subjekti i rivlerësimit Sabri Kastrati, gjatë periudhës së rivlerësimit ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Nga analizimi i dosjeve të shortuara, për 4 prej tyre është evidentuar si vijon:

51. Dosja 2 – Vendimi datë 18.3.2016, për pushimin e procedimit penal nr. ***, të regjistruar në datën 11.1.2016 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

51.1 Çështja penale konsiston në një konflikt të ndodhur në datën 7.1.2016 midis shtetasit M. Gj, i cili ka goditur me grushte shtetasin F.B, në qendër të qytetit të Rrëshenit, për motive të dobëta, konflikte të mbartura prej vitesh. Referuar aktit të ekspertimit mjekoligjor, ka rezultuar se tek i dëmtuari F.B vërehen dëmtime të cilat kanë shkaktuar humbjen e aftësisë për punë deri në 9 ditë. Prokurori Sabri Kastrati, në mbështetje të nenit 328/1, shkronja “f” e Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur pushimin e procedimit penal në ngarkim të shtetasit M.Gj, pasi referuar nenit 59 të këtij Kodi, i dëmtuari ka të drejtë që t’i drejtohet gjykatës me kërkesëpadi. Ndaj këtij vendimi nuk rezulton të jetë bërë ankim.

Konstatimet e Komisionit

51.2 Nga analizimi i dosjes penale, evidentohet se:

- Për këtë çështje nuk duhet të ishte regjistruar procedim penal, pasi referuar akteve, në datën 7.1.2016 shtetasit F.B i është mbajtur një procesverbal kallëzimi dhe një procesverbal me të dhëna nga personi që ka dijëni për rrethana të hetimit, ku në këtë deklaram është shprehur se nuk dëshiron që çështja të ndiqet penalisht. Mbi këtë bazë, për kallëzimin penal mund të ishte vendosur mosfillimi (bazuar në nenet 284/1 dhe 291/1/c të Kodit të Procedurës Penale), pasi vepra penale e plagosjes së lehtë, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, ndiqet vetëm me ankimin e të dëmtuarit.
 - Regjistrimi i procedimit penal është bërë ditën që aktet kanë mbërritur në prokurori, duke vendosur apriori për veprën penale të plagosjes së lehtë, pa u administruar aktet e ekspertimit mjekoligjor dhe pa bërë asnjë verifikim lidhur me kallëzimin. Gjatë fazës së verifikimit, i cili sipas urdhrat të Prokurorit të Përgjithshëm mund të zgjasë 1 muaj, do të mund të administroheshin aktet e ekspertimit mjekoligjor dhe mbi bazën e tyre të vendosej mosfillimi i procedimit penal.
- ✓ Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kërkuan shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Prapësimet e subjektit të rivlerësimit

51.3 Subjekti ka prapësuar se ky procedim penal është regjistruar më 11.1.2016 dhe në kohën e regjistrimit organi i akuzës organizohej dhe funksiononte si një organ i centralizuar dhe drejtuesi i Prokurorisë ishte prokuror më i lartë në raport me prokurorët e tjerë, dhe urdhrat e udhëzimet e prokurorit më të lartë ishin të detyrueshme për prokurorët më të ulët.

51.4 Subjekti ka prapësuar se në formularin e datës 11.1.2016, nënshkruar nga drejtuesi i Prokurorisë, ndër të tjera, është përcaktuar që materiali kallëzues në fjalë të regjistrohej si procedim penal dhe në këto rrethana ka zbatuar urdhrin e prokurorit më të lartë.

51.5 Më tej, subjekti ka sqaruar se afati njëmuor nuk ishte afat procedural që parashikohej nga Kodi i Procedurës Penale, pasi ishte një afat që duhej të respektohej për materialet kallëzuese, për të cilat çmohej se nuk plotësonin kriteret për t'u regjistruar si procedim penal, dhe jo një afat i cili duhej të përmbushej përpara se prokurori të vendoste për regjistrimin e procedimit. Në lidhje me veprat që ndiqen mbi ankimin e viktimës nga vepra penale, subjekti ka shpjeguar se në rast se gjatë veprimeve të para hetimore nuk ka një akt formal për heqjen dorë nga ankimi apo tërheqjen e ankimit sipas parashikimeve të neneve 285 dhe 286 të Kodit të Procedurës Penale, shprehja e vullnetit të viktimës nga vepra penale për heqjen dorë nga ankimi, apo tërheqjen e ankimit në deklaratimet e dhëna përpara oficerëve të policisë gjyqësore, nuk plotëson kushtet formale të caktuara nga ligji procedural penal për ta konsideruar si tërheqje nga ankimi, apo e drejta e ankimit, aq më tepër që organi procedues duhet të sigurohet nëse tërheqja nga ankimi apo e drejta e ankimit është bërë me vullnetin e lirë të viktimës dhe nuk është bërë si shkak i kanosjes apo edhe për shkaqe të tjera joligjore. Kanosja për të mos bërë ankim apo tërhequr ankim është paraparë nga ligjvënësi si vepër penale, parashikuar në nenin 311 të Kodit Penal. Subjekti ka depozituar formularin për trajtimin e materialit kallëzues të datës 11.1.2016, nënshkruar nga drejtuesi i Prokurorisë.

Vlerësimi i Komisionit

51.6 Komisioni konstaton se subjekti ka shpjeguar bindshëm arsyen mbi bazën e së cilës ka kryer regjistrimin e procedimit penal, duke zbatuar urdhrin e drejtuesit të Prokurorisë. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar mënyrën e trajtimit të çështjes në rastet kur tërhiqet ankimi nga kallëzuesi. Për rrjedhojë, në këtë rast nuk janë konstatuar shkelje të subjektit.

52. Dosja 3 – Vendimi datë 4.11.2015, për pushimin e procedimit penal nr. ***, i regjistruar në datën 12.8.2015 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

52.1 Çështja penale konsiston në një kontroll të ushtruar në datën 10.8.2015 nga Njësia Operacionale Speciale Tiranë, në objektin e shtetasit K.P, në lagjen “K”, Sh, Lezhë, ku është konstatuar se ishte rilidhur energjia elektrike, ndërkohë që ky shtetas nuk kishte shlyer detyrimet ndaj OSSHE-së. Policia gjyqësore ka referuar çështjen në prokurori për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Vjedhja e energjisë elektrike”, të parashikuara nga nenet 248 e 137/2 të Kodit Penal. Nga deklaratimet e punonjësve të OSHEE-së Lezhë ka rezultuar se lidhjen e kanë bërë me urdhër të drejtorit të këtij institucioni, shtetasit Gj.M, pasi bazuar në aktmarrëveshjen datë 7.7.2015 ishte kryer pagesa e energjisë elektrike dhe shlyer i gjithë detyrimi.

52.2 Në përfundim të veprimeve hetimore, subjekti ka arritur në përfundimin se nuk ekzistojnë elemente të veprave penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Vjedhja e energjisë elektrike”, për rrjedhojë, në mbështetje të nenit 328, pika 1, shkronja “dh” e Kodit të Procedurës Penale, vendosi pushimin e hetimeve, pasi i pandehuri nuk e ka kryer veprën, ose nuk provohet që e ka kryer ai.

Konstatimet e Komisionit

52.3 Nga analizimi i dosjes penale, evidentohet se:

- Subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë një vlerësim të drejtë të provave të administruara, pasi procesverbali për konstatimin e rilidhjes dhe ndërprerjen e saj nga Njësia Operacionale Speciale Tirane është mbajtur në orën 16:00, datë 10.8.2015, ndërsa detyrimet në emër të shtetasit K.P janë derdhur në orën 17:43, datë 10.8.2015, pra rreth dy orë pas konstatimit të rilidhjes. Ky fakt vërtetohet me mandatarkëtimin e administruar në fashikullin e procedimit penal, ku shlyerja e detyrimit është bërë pas konstatimit nga Njësia Operacionale Speciale e rilidhjes së energjisë elektrike, në kundërshtim me ligjin.
- ✓ Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kërkuan shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Prapësimet e subjektit të rivlerësimit

52.4 Subjekti ka prapësuar se gjatë hetimit të këtij procedimi penal janë marrë deklaratimet e punonjësve të OSHEE-së Lezhë, e konkretisht shtetasve L.Sh, P.B dhe drejtorit Gj.M. Sipas subjektit, këta shtetas kanë shpjeguar se energjinë elektrike në banesën e shtetasit K.P e kanë rilidhur ata në bazë të urdhrit të drejtorit për rilidhjen e energjisë elektrike, pasi më parë ishte lidhur një aktmarrëveshje për pagesën e energjisë, ku në datën 7.7.2015 janë bërë disa pagesa, ndërsa në datën 10.8.2015 janë mbyllur të gjitha detyrimet që kishin ndaj OSHEE-së. Ndër të tjera, shtetasi Gj.M ka shpjeguar se Njësia Operacionale Speciale ka shkuar për kontroll tek ky objekt, pa marrë më parë takim me punonjësit e OSHEE-së Lezhë dhe, për këtë arsye, nuk kanë qenë në dijeni të faktit se mes pronarit të objektit dhe OSHEE-së Lezhë ishte lidhur marrëveshja për shlyerjen e detyrimeve. Duke u mbështetur në këto rrethana, subjekti, në datën 4.11.2015 ka vendosur pushimin e procedimit penal. Sipas subjektit, ushtrimi i funksioneve të tij si prokuror është kryer në përputhje të plotë me ligjin material dhe procedural penal. Subjekti ka depozituar kopje të deklaratimeve të shtetasve L.Sh e Gj.M: aktmarrëveshjen datë 7.7.2015; urdhër pune nr. *, datë 7.7.2015; mandatarkëtimin datë 7.7.2015; raportin e nxjerrë nga sistemi, ku rezulton se shtetasi K.P nuk ka detyrime ndaj OSHEE-së.

Vlerësimi i Komisionit

52.5 Trupi gjykues vëren se subjekti gjatë hetimit të çështjes i është referuar vetëm deklaratimeve të punonjësve të OSHEE-së dhe nuk ka verifikuar aktet në dosjen penale, ku evidentohet se shlyerja e detyrimit ndaj OSHEE-së ishte kryer (në orën 17:43) pas ushtrimit të kontrollit nga njësia operacionale (në orën 16:00), fakte të cilat bien në kontradiktë me deklaratimet e punonjësve dhe shpjegimet e subjektit. Komisioni konkludon se nga ana e subjektit nuk janë kryer veprime hetimore shteruese, me qëllim verifikimin e kushteve për ekzistencën e veprave penale të referuara nga policia gjyqësore.

53. Dosja 4 – Kërkesë datë 16.5.2014, për gjykimin e procedimit penal nr. ***, regjistruar në datën 18.11.2013 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

53.1 Rrethanat e çështjes konsistojnë në ndalimin e shtetasit M.P në datën 16.11.2013, në bulevardin kryesor të qytetit të Lezhës, pasi ishte duke drejtuar mjetin pa leje drejtimi. Ky shtetas ka deklaruar se ka jetuar në shtetin italian dhe atje ishte i pajisur me leje drejtimi të lëshuar nga autoritetet italiane, por nuk e kishte me vete atë, pasi e kishte humbur.

53.2 Në përfundim të veprimeve hetimore, prokurori Sabri Kastrati ka konkluduar se i pandehuri M.P ka konsumuar elementet e veprës penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, dhe mbështetur në nenin 331 të Kodit të Procedurës Penale i kërkoi gjykatës gjykimin e çështjes penale në ngarkim të tij.

53.3 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendimin nr. ***, datë 15.7.2014 (marrë formë të prerë në datën 25.7.2014), ka vendosur deklarinim fajtor të të pandehurit M.P dhe dënimin e tij me 3 muaj burgim, në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale uljen me 1/3 të dënimit dhe përfundimisht dënimin e tij me 2 muaj burgim. Në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal, Gjykata ka pezulluar ekzekutimin e vendimit me burgim për të pandehurin M.P, duke e zëvendësuar me detyrimin për të kryer një punë në interes publik.

Konstatimet e Komisionit

53.4 Nga analizimi i dosjes penale, evidentohet se:

- Nuk janë verifikuar pretendimet e të pandehurit. Për ta konsideruar të plotë hetimin dhe provat e grumbulluara, subjekti duhet të kërkonte nga autoritetet gjyqësore italiane të konfirmonte faktin nëse i pandehuri ishte i pajisur ose jo me leje për drejtim automjeti në shtetin italian. Procedimi penal ka konsumuar një afat hetimi prej 6 muajsh, por ky veprim hetimor nuk është kryer.
- ✓ Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kërkuan shpjegime bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Prapësime të subjektit të rivlerësimit

53.5 Në prapësime subjekti ka shpjeguar se në përfundim të hetimeve është vendosur dërgimi për gjykim i kësaj çështjeje penale në ngarkim të shtetasit M.P, për veprën penale të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendimin nr. ***, datë 15.7.2014, ka vendosur deklarinim e tij fajtor për veprën penale “Drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. Ky vendim nuk është ankimuar nga shtetasi M.P dhe ka marrë formë të prerë më 25.7.2014.

53.6 Subjekti ka argumentuar se edhe gjatë kontrollit gjyqësor të kësaj çështjeje nuk është evidentuar qoftë edhe një mangësi në hetimin e këtij procedimi penal në fjalë, pasi gjykata e ka gjetur dhe deklaruar fajtor shtetasin M.P për të njëjtën akuzë, sikundër ajo e ngritur prej subjektit, dhe ky vendim nuk është ankimuar. Subjekti ka depozituar kopje të vendimit nr. ***, datë 15.7.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Vlerësimi i Komisionit

53.7 Komisioni vlerësoi shpjegimet e dhëna nga subjekti në prapësime, duke i konsideruar ato bindëse, nisur edhe nga fakti se nga kontrolli gjyqësor çështja e hetuar prej tij nuk ka pasur mangësi dhe, për rrjedhojë, në këtë rast nuk janë konstatuar shkelje të subjektit.

54. Dosja 5 – Kërkesë datë 27.1.2014, për gjykimin e procedimit penal nr. ***, viti 2013¹³⁴, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

54.1 Çështja penale konsiston në një kallëzim penal të kryer në datën 18.10.2013 nga shtetasi Gj.Ll, banues në fshatin K, Rrëshen, ndaj vëllait të tij F.Ll, pasi ky i fundit së bashku me bashkëshorten e tij i kanë dëmtuar burimin e ujit (tubin prej 223 metrash), i cili shërbente për furnizim me ujë të pijshëm. Lidhur me këtë dëmtim, ka bërë kallëzim penal edhe shtetasja M. Ll, pasi familja e saj ndodhej prej dy vitesh në konflikt me familjen e kunatit, F.Ll, i cili së

¹³⁴ Nga dosja penale rezulton se me vendimin e datës 20.11.2013 drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur që të bashkojë procedimin nr. *** të datës 21.10.2013 me procedimin penal nr. *** datë 31.10.2013, çështje e cila fillimisht ka qenë në ndjekje nga një prokuror tjetër dhe pas bashkimit të procedimeve i është ngarkuar subjektit Sabri Kastrati.

bashku me bashkëshorten po shkatërronte me kazmë linjën e ujit të pijshëm, si dhe linja e betonizuar e ndërtuar para 15 vitesh ishte shkatërruar.

54.2 Në përfundim të veprimeve hetimore, subjekti ka konkluduar se i pandehuri F.LI ka konsumuar veprën penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, dhe në zbatim të nenit 331 të Kodit të Procedurës Penale ka kërkuar gjykimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendimin nr. ***, datë 21.4.2014 (marrë formë të prerë më 1.5.2014), ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes penale.

Konstatimet e Komisionit

54.3 Nga analizimi i dosjes penale duket se çështja penale duhet të ishte hetuar për veprën penale “Shkatërrimi i rrjetit të ujësjellësit”, parashikuar nga neni 159 i Kodit Penal.

✓ Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kërkuar shpjegime.

Prapësime të subjektit të rivlerësimit

54.4 Subjekti ka prapësuar se kërkimi i shpjegimeve lidhur me cilësimin juridik të veprës penale del jashtë kompetencave të organeve të rivlerësimit, kjo sipas parashikimeve të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, vendimit nr. 2, datë 18.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese, opinionit CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias, ligjit nr. 84/2016, si dhe jurisprudencës tashmë të konsoliduar si të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit¹³⁵, ashtu edhe të Komisionit.

54.5 Subjekti ka prapësuar se cilësimi i faktit penal në rastin konkret ka qenë korrekt dhe i bazuar në ligj, pasi nuk është shkatërruar rrjeti i ujësjellësit që menaxhohet nga Ujësjellës-Kanalizime, por është prerë një tub plastik i zi, i cili shërbente për sjelljen e ujit nga një burim që ndodhej në afërsi të banesave/shtetasve në konflikt dhe, në këtë këndvështrim, prerja e këtij tubi përbën elementet e veprës penale të vetëgjyqësisë dhe jo të shkatërrimit të rrjetit të ujësjellësit.

54.6 Pas përfundimit të hetimeve, është vendosur dërgimi për gjykim i këtij procedimi për veprën penale “Vetëgjyqësia” dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendimin nr. **, datë 21.4.2014, ka vlerësuar se fakti penal në rastin konkret përmban elementet e kësaj vepre penale, por ka vendosur pushimin e çështjes, pasi ndërkohë kishte hyrë në fuqi ligji për amnistinë. Përfundimisht, subjekti ka argumentuar se cilësimi juridik i faktit penal ka qenë korrekt dhe i bazuar në ligj dhe, si i tillë, është vlerësuar edhe nga gjykata. Subjekti ka depozituar kopje të vendimit nr. ***, datë 21.4.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Vlerësimi i Komisionit

54.7 Subjekti në prapësimet e tij ka shpjeguar bindshëm arsyet për të cilat ka vendosur cilësimin juridik të veprës penale të vetëgjyqësisë, duke e bazuar mbi faktet dhe rrethanat e çështjes penale. Referuar përcaktimeve të nenit 375/1 të Kodit të Procedurës Penale, cilësimi juridik i bërë nga prokurori mund të ndryshohet nga gjykata, e cila, përmes vendimit përfundimtar,

Vendimi nr.20, datë 8.9.2020, i Kolegjit, ku arsyetohet se: “Në procesin e vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale në kuadër të procesit të rivlerësimit, është e nevojshme të mbahet në konsideratë fakti që subjektet vlerësohen sa u takon kualifikimeve të tyre dhe aftësive për t'i vënë në jetë këto kualifikime në ushtrimin e funksionit të tyre dhe përmbushjes së detyrave të përcaktuara nga Kushtetuta dhe ligji dhe, për rrjedhojë, në rastin e një prokurori, në përputhje me nenin 73 të ligjit nr. 96/2016, aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e tij për të hetuar, cilësitë e pranueshme në punë, respektimin e të drejtave të palëve ose viktimave, eficiencën dhe efektivitetin në masën e pranueshme. Për rrjedhojë, organet e rivlerësimit çmojnë aftësitë profesionale të prokurorit, pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet”.

mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori, më të lehtë ose më të rëndë. Rezulton që për çështjen konkrete gjykata e rrethit gjyqësor ka vlerësuar se fakti penal përmban elementet e veprës penale të vetëgjyqësisë, ashtu siç e ka paraqitur subjekti. Në vlerësimin final lidhur me këtë çështje, trupit gjykues nuk i rezultuan indicie apo rrethana për fakte konkrete, të cilat të krijonin bindjen se subjekti ka kryer shkelje ligjore.

ANALIZA E GJETJEVE¹³⁶

55. Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; (iii) burimeve arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.

Aftësitë profesionale

55.1 Nga analiza e dokumenteve ligjore dhe dosjet e vëzhguara ka rezultuar se prokurori Sabri Kastrati shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit, identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme dhe ka të qartë drejtimin e hetimit që do të kryejë në rastet konkrete. Subjekti shfaq aftësi në arsyetim ligjor, aktet e përgatitura prej tij paraqiten të strukturuar, duke bërë analizë mbi rrethanat e faktit dhe provat e mbledhura, si dhe duke shprehur qëndrimin e tij logjik mbi zgjidhjen ligjore.

Aftësitë organizative

55.2 Nga dosjet e vëzhguara ka rezultuar se nga ana e prokurorit Sabri Kastrati tregohet vëmendje në kryerjen e veprimeve hetimore në dinamikë dhe në respektim të afateve ligjore të kërkuara, duke i dhënë një zgjidhje të shpejtë çështjeve të trajtuara. Në analizë të dosjeve të vëzhguara, konstatohet se subjekti Sabri Kastrati ka treguar aftësi të mira në organizimin efektiv të kohës së punës, kryen veprime procedurale hetimore produktive, duke iu referuar dispozitave ligjore përkatëse dhe provave e akteve të nevojshme për të konkluduar në një vendimarrje. Prokurori ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve, rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar në dosjet përkatëse.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

55.3 Nga dosjet e vëzhguara evidentohet se gjuha e përdorur nga subjekti në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimi.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

55.4 Nga 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e përzgjedhura, vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë. Sa i përket gatishmërisë për t'u angazhuar, subjekti ka marrë pjesë në dy trajnime me temë në fushën penale, të organizuar pranë Shkollës së Magjistraturës, në mars 2014 dhe nëntor 2018.

TË DHËNAT NGA BURIME ARKIVORE

¹³⁶ Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73-76 të ligjit nr. 96/2016.

56. Nga verifikimi në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme rezulton që ndaj prokurorit Sabri Kastrati nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

57. Nga përgjigjet e ardhura nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, në emër të prokurorit Sabri Kastrati kanë rezultuar:

- Dy kallëzime penale¹³⁷ të regjistruara në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe çështja tjetër për veprën penale “Kryerja e veprimeve arbitrare”, të parashikuara nga nenet 248 dhe 250 të Kodit Penal.
 - Një kallëzim penal¹³⁸ i regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila është e njëjta çështje e hetuar edhe nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin për veprën penale “Kryerja e veprimeve arbitrare”.
 - Një kallëzim penal¹³⁹ i regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në ngarkim të prokurorit Sabri Kastrati, për veprën penale “Korrupsioni aktiv/pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të fushës së drejtësisë”, parashikuar nga nenet 319 dhe 319/ç të Kodit Penal.
- ✓ Lidhur me këto materiale kallëzuese, organet proceduese kanë vendosur mosfillimin e kallëzimeve penale.

58. Në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme, për periudhën 2006 – 2020 kanë rezultuar disa ankesa në të cilat përmendet prokurori Sabri Kastrati, ku nga verifikimi i kryer nuk rezultuan problematika.

59. Gjetje të tjera lidhur me kriterin profesional

59.1 Në lidhje me informacionet e dhëna nga autoritetet verifikuese, Komisioni ka administruar disa dosje penale dhe vendime gjyqësore nga Prokuroritë dhe Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe Dibër¹⁴⁰, ku nga verifikimi i 12 çështjeve penale ka rezultuar se: (i) për 7 çështje nuk u provuan informacionet e ardhura nga autoritetet verifikuese; (ii) një çështje ndodhet për gjykim pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, dosje e cila është objekt shqyrtimi nga kjo Gjykatë; (iii) për 4 çështje penale subjektit iu kërkuan shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, si vijon:

59.2 Çështjet penale nr. * dhe nr. *** të vitit 2012**, në ngarkim të shtetasve: (1) L.C me detyrë kryetar i Komunës X; (2) H.Gj, me detyrë kryetar i Komunës R; (3) G.R, me detyrë përgjegjës i financës së Komunës R; (4) H.B, me detyrë përgjegjës i financës së Komunës B; (5) M.C, me detyrë kryetar i Komunës G; (6) B.M, me detyrë zv/drejtor ekonomik në Drejtorinë e Shërbimit Spitalor M; (7) E.I, me detyrë shërbimtar në Drejtorinë e Shëndetit Publik dhe zv/drejtor ekonomik, të akuzuar për kryerjen e veprës penale “Vjedhje duke shpërdoruar detyrën”, parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal; (8) D.F, i cili së bashku me shtetasit G.R e

¹³⁷ 1. Kallëzimi penal nr. ***, datë 3.5.2018, i regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin; 2. Materiali kallëzues nr. ***, datë 6.11.2019, i regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

¹³⁸ Materiali kallëzues nr. ***, i regjistruar në datën 11.11.2019 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

¹³⁹ Kallëzimi penal nr. ***, i regjistruar në datën 18.11.2015 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

¹⁴⁰ (1) Shkresa nr. *** prot., datë 22.4.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër; (2) shkresa nr. *** prot., datë 12.4.2024, e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër; (3) shkresa nr. *** prot., datë 24.4.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë; (4) shkresa nr. *** prot., datë 22.4.2024, e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

B. M akuzohen për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal. Kjo çështje gjendet e publikuar edhe në median *online*¹⁴¹.

59.2.1 Rrethanat e çështjes konsistojnë në hetimin e procedurave prokuruese të zhvilluara nga disa komuna të rrethit Mat, konkretisht komunave R, X, G dhe B, si dhe Drejtoria e Shëndetit Publik Mat, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Mat etj., për blerje në vlera të vogla të mallrave dhe shërbimeve, të cilat janë kryer përmes subjektit fizik “Y.S”. Ky subjekt ka marrë pjesë në periudha të ndryshme në këto prokurime publike, të cilat kryheshin në mënyrë fiktive me qëllim përfitimin e shumave të prokuruar. Pasi plotësoheshin urdhrat e shpenzimeve nga shefat e financave dhe nënshkruheshin nga kryetarët e komunave, apo kryetarët e autoriteteve kontraktore, fondet kalonin në llogarinë e personit fizik “Y.S” e më pas transferoheshin në llogarinë e shtetasit D.F, i cili paraqitej si përfaqësues i këtij personi fizik dhe përgatiste dokumentacionin lidhur me prokurimet. Këto fonde tërhiqeshin *cash* nga bankat nga shtetasi D.F, i cili ua jepte shefave të financës ose kryetareve të autoriteteve kontraktuese, duke mbajtur në çdo rast 10% të çdo shume që tërhiqte. Ndërsa punimet dhe shërbimet kryheshin nga shtetas të tjerë, të cilët kontaktoheshin nga autoritete verifikuese dhe merrni një pagesë prej tyre.

59.2.2 Nga verifikimi i dosjeve penale ka rezultuar se të pandehurit janë hetuar fillimisht nën masën e sigurisë “Arrest në burg” sipas nenit 238 të Kodit të Procedurës Penale dhe më pas këta shtetas kanë kërkuar në gjykatë zëvendësimin e masës së sigurimit.

Konstatimet e Komisionit

59.2.3 Nga verifikimi i dosjes penale duket se:

- Për tre të pandehurit B.M, E.I dhe D.F subjekti është shprehur për zëvendësimin e masës së sigurimit në “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, duke favorizuar pozitën e tyre, ndryshe nga 5 të pandehurit e tjerë, për të cilët ka kërkuar moszëvendësimin e masës së sigurimit, ndërsa akuzohen për të njëjtën vepër penale.
- ✓ Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kërkuar shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Prapësimet e subjektit të rivlerësimit

59.2.4 Subjekti ka prapësuar se kërkimi i shpjegimeve mbi caktimin e masave të sigurimit, apo zëvendësimin e tyre, është jashtë kompetencave të organeve të rivlerësimit sipas parashikimeve të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, vendimit nr. 2, datë 18.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese, opinionit CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias, ligjit nr. 84/2016, si dhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit, dhe vetë Komisionit.

59.2.5 Sipas subjektit, shprehja e përdorur “subjekti ka favorizuar” është i pavërtetë, por edhe i papërshtatshëm, pasi të zbatosh ligjin nuk do të thotë të favorizosh. Subjekti ka argumentuar se detyra e prokurorit nuk konsiston as në favorizimin e personave të përfshirë në kryerjen e veprave penale, por as në ndëshkimin e tyre pa ligj, por në zbatimin me përpikëri të dispozitave ligjore. Sipas subjektit, për sa kohë zëvendësimi i masave të sigurimit është parashikuar në ligjin procedural penal, atëherë është në vlerësimin e prokurorit dhe të gjykatës për të analizuar nëse në një rast të dhënë ekzistojnë kushtet dhe kriteret për zëvendësimin e masave të sigurimit.

59.2.6 Për më tepër që ky procedim penal është filluar kryesisht nga ana e subjektit, duke vënë

¹⁴¹<http://www.panorama.com.al/mat-lirohen-dhe-3-vendoret-e-akuzuar-per-korrupsion/>
<https://www.oranews.tv/skema-piramidale-ne-mat-lirohen-kryekomunaret-dhe-shefat-e-financave>
<http://www.panorama.com.al/tenderat-prokuroria-7-vjet-burg-per-2-krere-komunash/>

në këtë mënyrë përpara drejtësisë një numër të konsiderueshëm kryetarë komunash, si dhe punonjës komunash, të cilët duke zhvilluar tenderime fiktive kishin arritur të përvetësonin shuma të konsiderueshme nga buxheti i shtetit. Sipas subjektit, nëse qëllimi i tij do të ishte favorizimi i dikujt, nuk do ta regjistronte këtë procedim penal në mënyrë proaktive.

59.2.7 Sa i përket zëvendësimit të masave të sigurimit ndaj shtetasve B.M, E.I dhe D.F, subjekti ka sqaruar se kjo ka qenë në përputhje me nenin 260 të Kodit të Procedurës Penale, ku vlerësimi i caktimit të llojit dhe masës së sigurimit dhe zëvendësimi i tyre është personal për secilin nga personave ndaj të cilëve caktohen apo zëvendësohen këto masa. Sipas subjektit, në vlerësimin nëse ekzistojnë kushtet dhe kriteret për zëvendësimin e masave të sigurimit, përveç rrezikshmërisë së veprës penale, mbahen parasysh një sërë rrethanash të tjera, si rrezikshmëria e autorit, mosha, rrethanat familjare dhe shoqërore, shkalla e fajësisë etj. Subjekti ka shpjeguar se kërkesa për zëvendësimin e masave të sigurimit për shtetasit B.M, E.I dhe D.F është gjetur e bazuar edhe nga ana e gjykatës, çka tregon se qëndrimi i tij në seancë si prokuror i çështjes ka qenë në përputhje të plotë me ligjin.

59.2.8 Për sa i përket konstatimit të Komisionit se për shtetasit B.M, E.I dhe D.F është pranuar kërkesa për zëvendësimin e masës së sigurimit nga “Arrest në shtëpi” në “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, ndërkohë që nuk është pranuar kërkesa për zëvendësimin e masës së sigurimit nga “Arrest në shtëpi” në “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” për shtetasit L.C, H.Gj, M.C, G.R dhe H.B, subjekti ka shpjeguar se kjo ka ardhur për arsye se për shkak të pozicionit të punës që kishin këta shtetas në detyrën e kryetarit të komunës, si dhe të përgjegjësit të financave në komunë, ekzistonte rreziku që për shkak të këtyre detyrave ata mund të vinin në rrezik marrjen apo vërtetësinë e provave, sidomos të provave me dëshmitarë, pasi këta të fundit ishin vartës të këtyre shtetasve. Sipas subjektit, këta shtetas, duke qenë nën masën e sigurimit “Detyrim paraqitjeje”, do t’u mundësohej ushtrimi i detyrave të tyre, dhe logjikisht që vartësit e tyre do të ndiheshin të intimiduar të dëshmonin kundër eprorëve në gjykatë.

59.2.9 Ndërsa për shtetasit B.M, E.I dhe D.F është pranuar kërkesa, pasi ata ose nuk kanë qenë më të punësuar në të njëjtin institucion (B.M), ose nuk kanë pasur më detyra drejtuese (E.I), ndërsa për shtetasin D.F është pranuar kërkesa, pasi akuza ndaj tij ka qenë për falsifikim dokumentesh dhe jo për vjedhje, duke shpërdoruar detyrën. Në këto rrethana, është pranuar kërkesa e tyre, pasi ata nuk vinin në rrezik marrjen apo vërtetësinë e ndonjë prove. Gjithashtu, kërkesa për zëvendësim të masës së sigurimit për këta shtetas është pranuar për shkak të rrethanave të tyre familjare dhe shëndetësore, të cilat ishin të tilla që përlligjinin zëvendësimin e masës së sigurimit nga “Arrest në shtëpi”, në “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

Vlerësimi i Komisionit

59.2.10 Pas shpjegimeve të subjektit, si dhe në referim të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, të cilat përcaktojnë kushtet e kriteret e caktimit të masave të sigurimit dhe të ndryshimit të këtyre masave, si dhe referuar vendimeve gjyqësor, të cilat kanë pranuar kërkesat e të pandehurve për ndryshimin e masave të sigurimit personal nga “Arrest në burg” në një masë më të butë, trupi gjykues e çmon të drejtë këtë qëndrim të subjektit, për sa kohë nuk bie ndesh me ndonjë nga dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Përfundimisht, trupit gjykues nuk i rezultuan indicie apo rrethana për fakte konkrete, të cilat të krijonin bindjen se subjekti ka kryer shkelje ligjore në veprimtarinë e tij, në cilësinë e prokurorit të çështjes.

59.3 Çështja penale nr. *, viti 2011**, në ngarkim të shtetasve D.B, V dhe D.B, akuzuar për veprën penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” kryer në bashkëpunim dhe “Mbajtja pa leje e armëve luftarake”, të parashikuara nga nenet 79/dh e 25 dhe 278/2 të Kodit Penal. Kjo ngjarje gjendet e publikuar edhe në median *online*¹⁴².

59.3.1 Çështja penale konsiston në një ngjarje të ndodhur në datën 14.8.2011, në vendin e quajtur “L i S”, fshati F, rrethi Mat, ku janë vrarë me armë zjarri shtetasit Sh.B, bashkëshortja H.B dhe djali i tyre Y.B, si dhe janë plagosur dy djemtë e tyre, G.B dhe H.B. Nga veprimet e para hetimore është dyshuar se autorë të kësaj ngjarjeje kanë qenë vëllezërit D, D dhe V.B, të cilët janë arrestuar në flagrancë nga policia gjyqësore.

59.3.2 Pas kryerjes së veprimeve hetimore, prokurori Sabri Kastrati në datën 21.12.2011 ka disponuar me vendim për pushimin e hetimeve në ngarkim të dy shtetasve V dhe D.B, duke konkluduar se asnjë e dhënë nuk implikon dy të dyshuarit në këtë ngjarje. Ndërsa për të pandehurin D.B ka konkluduar se është autor i vetëm i veprave penale të vrasjes dhe armëmbajtjes pa leje dhe në datën 29.12.2011 ka vendosur dërgimin e çështjes në gjykatë¹⁴³, duke kërkuar deklarinimin fajtor të shtetasit D.B dhe dënimin e tij me burgim të përjetshëm për veprën penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” dhe 2 vjet burgim për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve luftarake”.

59.3.3 Ndaj vendimit të subjektit datë 21.12.2011, për pushimin e hetimeve, është ushtruar ankim nga i plagosuri H.B dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat me vendimin nr. *, datë 21.2.2013, ka vendosur prishjen e vendimit dhe vazhdimin e hetimeve në ngarkim të shtetasve D dhe V.B, duke lënë detyra konkrete. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë nr. ***, datë 17.5.2013, si dhe Gjykata e Lartë me vendimin nr. ***, datë 28.4.2015, e cila ka vendosur mospranimin e rekursit të organit të prokurorisë.

Konstatimet e Komisionit

59.3.4 Nga verifikimi i dosjes penale duket se:

- Subjekti nuk ka kryer veprime të plota hetimore për zbardhjen e ngjarjes, mangësi këto të evidentuara edhe nga gjykatat më të larta, duke favorizuar pozitën e të dyshuarve V dhe D.B përmes vendimit për pushimin e hetimeve datë 21.12.2011.
- ✓ Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Prapësime të subjektit të rivlerësimit

59.3.5 Subjekti ka prapësuar se shprehja e përdorur “subjekti ka favorizuar” nuk është etik dhe ka konotacion negativ, pasi të zbatosh ligjin nuk do të thotë të favorizosh dhe detyra e prokurorit nuk konsiston as në favorizimin e personave të përfshirë në kryerjen e veprave penale, por as në ndëshkimin e tyre pa ligj, por konsiston në zbatimin me përpikëri të dispozitave ligjore.

59.3.6 Sipas subjektit, prokurori asnjëherë nuk duhet të vendosë pushimin e procedimit penal, pasi mund të aludohet se favorizon persona të caktuar. Subjekti ka referuar nenin 24, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale dhe nenin 327, pika 6 e këtij Kodi, duke argumentuar se duke qenë se ka barrën e provës për të provuar fajësinë e të pandehurit, procedon me dërgimin për gjyq të

¹⁴² <http://www.panorama.com.al/masakra-ne-mat-ne-pranga-3-vellezet-vrame-per-hakmarrije/>

¹⁴³ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat me vendimin nr. **, datë 2.11.2012, ka vendosur deklarinimin fajtor dhe dënimin e shtetasit D.B me burgim të përjetshëm, vendim i lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë nr. ***, datë 11.9.2013.

çështjes kur çmon se ka “prova” për të vërtetuar fajësinë e të pandehurit. Në të kundërt, procedon me pushimin e akuzës apo çështjes, apo i kërkon gjykatës pushimin e çështjes. Një interpretim i kundërt do ta bënte të panevojshëm parashikimin e bërë nga neni 328 i Kodit të Procedurës Penale, duke minuar në këtë mënyrë parimin e ligjshmërisë.

59.3.7 Subjekti ka shpjeguar se në kohën kur ka ndodhur ngjarja në fjalë organi i akuzës ka qenë i centralizuar dhe duke qenë se kjo ishte një ngjarje tepër e rëndë, ku humbën jetën tre persona dhe u plagosën dy të tjerë, ky procedim penal është analizuar me drejtorin e Hetimit dhe Ndjekjes Penale në Prokurorinë e Përgjithshme të asaj kohe, që ishte z. S.S, prokurorin e kësaj drejtorie, z. K.B, si dhe Drejtuesin e Prokurorisë, z. A.M. Subjekti ka shpjeguar se, pasi janë analizuar në mënyrë të hollësishme të gjitha “të dhënat” e grumbulluara nga hetimet paraprake, u arrit në përfundimin se autor i kësaj vepre penale tepër të rëndë ishte vetëm shtetasi D.B dhe nga ana e tij si prokuror i çështjes është vendosur dërgimi për gjykim i këtij procedimi penal për këtë shtetas për veprat penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” dhe “Mbajtja pa leje e armëve luftarake”, të parashikuara respektivisht nga nenet 79, shkronja “dh” dhe 278/2 të Kodit Penal (sipas ligjit të kohës kur ndodhi ngjarja), si dhe është vendosur pushimi i hetimeve për shtetasit V.B dhe D.B.

59.3.8 Subjekti ka cituar “provat” determinante, nga të cilat u konkludua se shtetasit V.B dhe D.B nuk ishin autorë të kësaj vepre penale, te cilat konsistojnë në aktin e ekspertimit teknik balistik, aktin e ekspertimit kimik për ekzaminimin e rrobave të marra nga viktima Sh.B, aktin e ekspertimit fizik i tamponëve për identifikimin e faktorëve plotësues të qitjes, ku ka dala se tek të dyshuarit D dhe V.B nuk është evidentuar prania e faktorëve plotësues të qitjes. Gjithashtu ka cituar deklaratimet e shtetasve K.B, E.R, Sh.R, E.B (vëllai i viktimës) dhe L.B, ku sipas subjektit ka dalë i qartë mekanizmi i zhvillimit të kësaj ngjarjeje të rëndë dhe fakti se shtetasit D.B dhe V.B nuk kanë pasur armë zjarri dhe se viktima Sh.B ka pasur armë të tillë.

59.3.9 Për sa i përket vendimit gjyqësor për prishjen e vendimit të pushimit, subjekti ka shpjeguar se ky është aspekt procedural dhe nuk prezumon mangësi profesionale, mungesë paanësie apo qëndrim favorizues, për sa kohë që kjo nuk është bërë me keqbesim, por është një mjet kontrolli i gjykatës mbi veprimtarinë e prokurorit, ashtu siç janë shkallët më të larta të gjyqësorit për ato më të ulëta. Sipas subjektit, pas kryerjes së veprimeve hetimore, të cilat gjykata i ka konsideruar të rëndësishme për hetimin e çështjes në fjalë, nuk janë gjetur “prova” nga të cilat të rezultonte se edhe shtetasit D dhe V.B ishin të përfshirë në këtë ngjarje të rëndë kriminale, madje këto veprime hetimore janë kryer nga një prokuror tjetër, i cili ka arritur në të njëjtin konkluzion si subjekti, duke vendosur përsëri pushimin e hetimeve për këta shtetas, me të njëjtin arsyetim që ata nuk janë autorë të kësaj ngjarjeje. Përfundimisht, në lidhje me këtë procedim penal, subjekti ka prapësuar se janë kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore. Pas kryerjes së të gjitha këtyre veprimeve, ato janë bërë objekt analize edhe me prokurorë të Prokurorisë së Përgjithshme (që sipas ligjit të kohës konsideroheshin prokurorë më të lartë në raport me prokurorët e shkallës së parë) dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha provave janë marrë edhe vendimet përkatëse për çdo person të përfshirë në këtë ngjarje, vendimmarrje e cila ka ardhur si rezultat i një hetimi të plotë, të gjithanshëm dhe rigoroz, dhe në mbështetje të plotë në ligjin penal dhe atë procedural penal.

Vlerësimi i Komisionit

59.3.10 Komisioni, në analizë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe rrethanave të çështjes penale, çmon se hetimet e kryera nga subjekti nuk kanë qenë shteruese, e konfirmuar

kjo edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat me vendimin e datës 21.2.2013. Komisioni vlerëson se kthimi i akteve nga gjykata duke urdhëruar organin e akuzës për vazhdimin e hetimeve me një sërë detyrash konkrete, evidentojnë mangësi në hapat hetimore nga ana e subjektit dhe shërbejnë si indikatorë për moskryerje të detyrës nga ana e prokurorit, siç është në rastin konkret, pasi nga ana e subjektit duket se nuk janë kryer veprime hetimore shteruese, për të konkluduar më pas me pushimin e çështjes. Komisioni vlerëson se fakti që për këtë çështje një tjetër prokuror ka vendosur sërish pushimin e hetimeve, me të njëjtin konkluzion si subjekti, nuk do të thotë se veprimet hetimore të subjektit kanë qenë shteruese, pasi vendimmarrja e prokurorit tjetër bazohet edhe mbi hetimet shtesë të kryera sipas urdhërimeve të gjykatës. Në përfundim, Komisioni evidenton mangësi në kryerjen e veprimeve hetimore nga ana e subjektit të rivlerësimit, të konfirmuara edhe nga kontrolli gjyqësor, që e ka urdhëruar prokurorin për vazhdimin e hetimeve.

59.4 Çështja penale nr. *, viti 2016**, në ngarkim të shtetases L.K, akuzuar për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

59.4.1 Nga informacioni i referuar në datën 27.7.2016 nga oficerët e policisë gjyqësore, kishte dyshime mbi veprimtarinë tregtare të shtetases L.K, e cila ushtron aktivitetin e shitjes së artikujve të ndryshëm, në qendër të qytetit të Lezhës. Nga të dhënat e referuara, ka rezultuar se kjo shtetase ka kryer transaksione të ndryshme financiare përmes bankës, të deklaruara me burim nga biznesi dhe emigracioni. Lidhur me këto transaksione, kishte dyshime se vinin nga veprimtari të ndryshme kriminale të kryera në Angli nga vëllai i saj, shtetasi A.K, për pastrim të produkteve të veprës penale.

59.4.2 Pas kryerjes së veprimeve hetimore, në datën 12.4.2017 subjekti ka vendosur pushimin e çështjes, mbështetur në nenin 328/b të Kodit Penal, duke konkluduar se nuk ka elemente të pastrimit të produkteve të veprës penale. Sipas subjektit, nga hetimi i kryer ka rezultuar se përmes llogarive bankare nuk janë kaluar shuma parash të konsiderueshme dhe nuk ka asnjë transfertë të kryer nga shtetasi A.K.

Konstatime të Komisionit

59.4.3 Nga verifikimi i dosjes penale duket se:

- Vendimi i pushimit të subjektit nuk është i argumentuar, ku në të mungon informacioni i referuar nga ana e Drejtorisë së Policisë Lezhë, sipas të cilit evidentohen transaksione në vlera të konsiderueshme në llogaritë bankare të shtetases L.K, dhe jo siç konkludohet nga subjekti se nuk janë bërë transaksione bankare në shuma¹⁴⁴ të konsiderueshme dhe se të ardhurat e saj vijnë nga veprimtaria private dhe paratë e marra hua nga të tretët.
- Subjekti nuk ka kryer një hetim të plotë të çështjes, duke favorizuar pozitën e të dyshuarve, si dhe duke mos administruar një akt ekspertimi financiar për të konkluduar nëse të ardhurat nga biznesi i shtetases L.K dhe djalit të saj, si dhe shitjet, justifikojnë pasuritë e krijuara prej tyre.
- ✓ Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjekti iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

¹⁴⁴ Sipas informacionit të referuar nga policia gjyqësore, ndërtimi i një objekti 4 kate ka rezultuar me vlera financimi (transferta tek shoqëria ndërtuese) në shumat 916.843 euro, 9.974 GBP dhe 14.714.000 lekë, vlera më të larta se shitjet e deklaruara dhe realizuara nga ky ndërtim, që janë 371.990 euro, 65.231 GBP dhe 5.400.000 lekë.

Prapësime të subjektit të rivlerësimit

59.4.4 Subjekti ka prapësuar se informacioni i përcjellë nga policia gjyqësore nuk përbën provë në kuptim të ligjit procedural penal dhe, si i tillë, vendimmarrja e prokurorit nuk bazohet në informacionin e policisë gjyqësore. Për të konkluduar në lidhje me një procedim penal, prokurori bazohet në provat e grumbulluara në fazën e hetimeve paraprake. Kuptimi i provave dhe llojet e tyre parashikohen specifikisht në ligjin procedural penal dhe, më konkretisht, në nenet 148 e vijues të Kodit të Procedurës Penale dhe informacioni i policisë gjyqësore nuk parashikohet si provë nga ky Kod.

59.4.5 Sipas subjektit, shprehja e përdorur se “subjekti ka favorizuar” nuk është i vërtetë dhe është i papërshtatshëm, pasi të zbatosh ligjin nuk do të thotë të favorizosh. Subjekti ka argumentuar se detyra e prokurorit nuk konsiston as në favorizimin e personave të përfshirë në kryerjen e veprave penale, por as në ndëshkimin e tyre pa ligj, por konsiston në zbatimin me përpikëri të dispozitave ligjore. Sipas konkludimeve të Komisionit, prokurori asnjëherë nuk duhet të vendosë pushimin e procedimit penal, pasi mund të aludohet se favorizon persona të caktuar. Subjekti i është referuar nenit 24, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, si dhe nenit 327, pika 6 e këtij Kodi, duke argumentuar se prokurori, duke qenë se ka barrën e provës për të provuar fajësinë e të pandehurit, procedon me dërgimin në gjyq të çështjes kur çmon se ka “prova” për të vërtetuar fajësinë e të pandehurit. Në të kundërt, procedon me pushimin e akuzës apo çështjes, apo i kërkon gjykatës pushimin e çështjes. Një interpretim i kundërt do ta bënte të panevojshëm parashikimin e bërë nga neni 328 i Kodit të Procedurës Penale, duke minuar në këtë mënyrë parimin e ligjshmërisë.

59.4.6 Subjekti ka sqaruar se nga veprimet hetimore të kryera nuk ka rezultuar që shtetasi A.K.(për të cilin ka pasur dyshime se ishte i përfshirë në veprimtari kriminale në Angli) të këtë pasuri të paluajtshme të regjistruara në emër të tij dhe nuk rezulton të ketë llogari bankare. Gjithashtu, nuk rezultoi që ky shtetas të ketë kryer transaksione bankare në llogaritë në emër të shtetases L.K apo shtetasit J.V.

59.4.7 Për sa i përket investimeve të kryera nga shtetasja L.K, subjekti ka sqaruar se pavarësisht shumës relativisht të lartë të investimit, nga analiza e transaksioneve bankare të kësaj shtetaseje i ka rezultuar se kjo pagesë nuk është bërë në mënyrë të menjëhershme, çka mund të krijonte dyshime të arsyeshme për ligjshmërinë e burimeve të përdorura për kryerjen e investimit. Subjekti ka shpjeguar në mënyrë të detajuar transaksionet bankare në llogarinë e shtetases L. K dhe nga analizimi i tyre nuk i ka rezultuar të jenë kryer transaksione në vlera të mëdha në mënyrë të pajustificuar. Subjekti ka sqaruar se llogaritë bankare janë kredituar nëpërmjet një kredie të marrë në shumën 100.000 euro, si dhe nëpërmjet pagesave të shitjes së apartamenteve sipas kontratave respektive, një kopje e të cilave është administruar edhe në fashikullin e procedimit penal, si dhe kontratat e huas, nga të cilat vërtetohet fakti se shtetasja L.K ka marrë hua nga shtetas të ndryshëm.

59.4.8 Sa sipër, subjekti, duke marrë në konsideratë deklaratimet e shtetases L.K, faktin se kjo shtetase nuk rezulton të jetë e përfshirë në ndonjë aktivitet kriminal i cili gjeneron të ardhura, si dhe faktin se nuk rezulton që të këtë transaksione midis saj dhe shtetasit A.K, ka arritur në konkluzionin se në faktin e kallëzuar nuk ka elemente të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal dhe, për këtë arsye, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***. Përfundimisht, subjekti thekson se hetimi i këtij procedimi penal prej tij ka qenë korrekt, rigoroz dhe në mbështetje të plotë në

ligjin penal dhe procedural penal dhe vendimmarrja në lidhje me këtë çështje ka qenë tërësisht e bazuar në ligj e në prova. Subjekti ka depozituar transaksionet bankare të llogarive të shtetases L.K, kontratat e huas, si dhe deklaratimet e kësaj shtetaseje.

Vlerësimi i Komisionit

59.4.9 Në prapësime, subjekti ka shpjeguar mbi veprimet hetimore të kryera për këtë procedim penal, por nuk ka dhënë shpjegime mbi arsyen e mosadministrimit të një akti ekspertimi financiar, akt i cili definitivisht do të përcaktonte nëse transaksionet bankare të kryera nga e dyshuara burojnë nga aktiviteti i biznesit apo shitblerjet e pasurive dhe nuk vijnë nga një veprimtari e kundërligjshme. Komisioni çmon se një verifikim i tillë kërkon njohuri të posaçme teknike nga një ekspert financiar dhe nuk mund të kryhet nga vetë subjekti i rivlerësimit. Dokumentacioni i paraqitur nga subjekti në prapësime ndodhet tashmë i administruar në dosjen penale dhe subjekti nuk ka paraqitur ndonjë provë të re për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit. Në përfundim, Komisioni çmon se hetimet e kryera nga subjekti nuk kanë qenë shteruese, duke evidentuar mangësi në kryerjen e veprimeve hetimore nga ana e subjektit të rivlerësimit.

59.5 Procedimi penal nr. ***, në ngarkim të shtetasve E.Gj dhe F.P, akuzuar për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, si dhe shtetasit O.K, E.Q e K.Sh, akuzuar për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”, parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal¹⁴⁵.

59.5.1 Rrethanat e çështjes konsistojnë në një ngjarje të ndodhur në datën 29.3.2021 tek mbikalimi i Rrëshenit, ku shërbimet e policisë kanë konstatuar dy automjete të ndaluara në kryqëzimin e rrugës dhe njëri prej tyre me drejtues shtetasin K.Sh (Sh) dhe pasagjer E.Gj, është larguar me shpejtësi. Më pas, ata janë ndaluar nga punonjësit e policisë dhe nga kontrolli i ushtruar nuk u janë gjetur asgjë të kundërligjshme. Ndërsa tek automjeti tjetër u gjenden shtetasit O.K dhe E.Q, ku nga kontrolli i ushtruar është gjetur një cigare e përzier me *cannabis sativas*, me peshë 0.519 gram, për të cilën shtetasi O.K ka deklaruar se i përkiste atij, pasi ishte përdorues i kësaj lënde. Jo larg vendit ku ishin ndaluar automjetet, është gjetur dhe sekuestruar një qese me lëndë narkotike të llojit *cannabis sativa*, me peshë 1.712 kilogram, për të cilën shtetasi E.Gj ka deklaruar se i përkiste atij, pasi ishte përdorues i lëndës narkotike, ndërsa shtetasit K, O dhe E kanë qenë me të në makinë. Lëndën narkotike shtetasi E.Gj e kishte blerë nga shtetasi F.P, i cili është identifikuar më pas përmes procesverbalit për njohjen e personit datë 14.5.2021.

Konstatimet e Komisionit

59.5.2 Nga verifikimi i dosjes penale duket se:

- Subjekti ka favorizuar pozitën e tre prej të pandehurve E.Q, O.K dhe K.Sh, duke kërkuar në gjykatë caktimin e masës së sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, ndryshe nga dy të pandehurit e tjerë, për të cilët ka kërkuar caktimin e masës “Arrest me burg”. Gjithashtu, ndaj këtyre tre shtetasve janë ngritur fillimisht akuza për veprën “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike” dhe më pas subjekti ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale në “Moskallëzimi i krimit”.

¹⁴⁵ Kjo çështje gjendet e publikuar edhe në median *online*:

<https://top-channel.tv/2021/03/30/emrat-kush-jane-kater-te-rinjte-ge-u-kapen-ne-flagrance-duke-shkember-lende-narkotike-ne-rreshen/>

- ✓ Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kërkuan shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Prapësimet e subjektit të rivlerësimit

59.5.3 Subjekti ka prapësuar se kërkimi i shpjegimeve mbi caktimin e masave të sigurimit, si dhe cilësimit juridik të faktit penal, është jashtë kompetencave të organeve të rivlerësimit sipas parashikimeve të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, vendimit nr. 2, datë 18.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese, opinionit CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias, ligjit nr. 84/2016, si dhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit¹⁴⁶ dhe vetë Komisionit. Sipas subjektit, shprehja e përdorur “subjekti ka favorizuar” është e pavërtetë, por edhe e papërshtatshme, pasi të zbatosh ligjin nuk do të thotë të favorizosh, pasi detyra e prokurorit nuk konsiston as në favorizimin e personave të përfshirë në kryerjen e veprave penale, por as në ndëshkimin e tyre pa ligj, por në zbatimin me përpikëri të dispozitave ligjore.

59.5.4 Subjekti ka shpjeguar se caktimi i masave të sigurimit ndaj shtetasve E.Q, E.K dhe K.Sh ka qenë në përputhje me kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit të parashikuara respektivisht nga nenet 228 dhe 229 të Kodit të Procedurës Penale dhe vlerësimi i caktimit të llojit dhe masës së sigurimit është personal për secilin nga personat ndaj të cilëve caktohen këto masa, ku përveç rrezikshmërisë së veprës penale mbahen parasysh një sërë rrethanash të tjera si rrezikshmëria e autorit, mosha, rrethanat familjare dhe shoqërore, shkalla e fajësisë etj. Subjekti ka referuar vendimin unifikues nr. 7 të vitit 2011, ku Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë konkluduar se: *“Nisur nga kriteret e përcaktuara në pikat 1 e 2 të nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale dhe atyre të neneve 48 e 50 të Kodit Penal, gjykata duhet të hetojë, në gjendjen që është procedimi, në drejtim të personalitetit të së pandehurit, nëse ka precedentë penale, mënyrën e jetesës së tij, vendin dhe rrethanat të cilat e kanë sjellje në kryerjen e veprës, rrethanat lidhur me natyrën, llojin, mjetet, kohën, vendin e mënyrën e kryerjes së veprës penale, llojin dhe shkallën e pasojave të ardhura nga kryerja e veprës, llojin e shkallën e fajësisë dhe motivet për kryerjen e veprës, sjellja e autorit si para ashtu edhe pas kryerjes së veprës, si dhe rrethanat e tjera të jetës individuale, familjare e sociale të tij”*. Subjekti ka shpjeguar se në rastin konkret që nga veprimet e para hetimore kishte dyshime se personat e përfshirë në aktivitetin e paligjshëm të lëndëve narkotikëve ishin shtetasit E.Gj dhe F.P, ndërkohë që nuk kishte prova të qarta për përfshirjen e shtetasve E.Q, E.K dhe K.Sh dhe, për këtë qëllim, ka kërkuar një masë më të butë sigurimi për këta tre shtetas. Sipas subjektit, në rastin konkret nuk ka ndryshim të akuzës, pasi në fazën e veprimeve të para hetimore shtetasit E.Q, E.K dhe K.

¹⁴⁶ Vendimi nr. 16/2020 i Kolegjit ka argumentuar se: *“Kolegji konstaton gjithashtu se në thelb të kësaj vendimmarrje ka qëndruar vlerësimi që ka bërë trupi gjyqësor, në të cilin ka qenë pjesë edhe subjekti, mbi ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova si një kusht i detyrueshëm për vendosjen e një mase të sigurimit personal, sipas parashikimit të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale. Ky institut i së drejtës procedurale penale qëndron në vlerësimin e Kolegjit i lidhur ngushtë me bindjen e brendshme të gjyqtarit, të krijuar nga provat e administruara, se ka dyshim të arsyeshëm se vepra penale ka ndodhur dhe se personi ndaj të cilit do të vendoset masa e sigurimit, e ka kryer atë”. Sipas vlerësimit të Kolegjit, përcaktimi nëse bindja e brendshme e trupit gjyqësor rreth dyshimit të arsyeshëm, në rastin konkret, ka qenë e duhura apo e drejta, del jashtë kompetencave të organeve të rivlerësimit, për sa kohë lidhet drejtpërdrejt me korrektësinë e vendimmarrjes bazuar në bindjen e brendshme, pra me atë aspekt të aftësive profesionale të magistratëve që nuk mund të gjykohej e të shërbejë si matës i aftësive të tyre profesionale në kuadër të këtij procesi. Arsyetimi i mësipërm gjen mbështetje në nenin 44, paragrafi 1 i ligjit nr. 84/2016, i cili referon te kriteret e ligjit nr. 96/2016, si kriteret që duhen analizuar në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale të subjekteve, i cili në referencë të fundit, sipas nenit 72, pika 4 e këtij ligji, ndalon vlerësuesin të çmojë aftësitë gjyqësore duke gjykuar korrektësinë e vendimmarrjes apo themelin e çështjes. Për pasojë, në përfundim të këtij arsyetimi, Kolegji çmon se shkeljet e trajtuara se janë kryer nga subjekti në gjykimin e kësaj çështje, të lidhura ngushtësisht në rastin konkret me bindjen e brendshme të magistratit, nuk mund të shërbejnë si gjetje të cilat duhet të analizohen në këndvështrim të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit”*.

Sh kanë qenë të dyshuar (kanë pasur cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet) për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike”. Pra, ndaj tyre nuk ka pasur akuzë për këtë vepër penale, por vetëm dyshime dhe më pas nga veprimet hetimore u konkludua se ata nuk ishin të përfshirë në aktivitetin e paligjshëm të narkotikëve dhe, për këtë arsye, iu njoftua akuza për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”. Subjekti ka referuar vendimin unifikues nr. 3/2002, ku Gjykata e Lartë, ndër të tjera, ka arsyetuar se: *“Termin ‘person të cilit i atribuohet vepra penale’ e gjejmë në nenin 287 të Kodit të Procedurës Penale, që bën pjesë në kreun e dytë të titullit të gjashtë të Kodit, që flet për mënyrën si njoftohet e merr dijëni për veprën penale prokurori dhe policia. Kur njoftuesi mendon se e di se kush është autori i veprës penale, prokurori shënon në regjistrin që mbahet për njoftimin e veprave penale emrin e personit që tregon kallëzuesi, se është ose mund të jetë autor i veprës penale. Nuk ka asnjë dyshim se ky emërtim i përket fazës fillestare të procedimit penal. Termi ‘person të cilit i atribuohet vepra penale’, i marrë në kontekstin e nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale plus momentin procedural në të cilin përdoret, kuptohet se nuk mund të barazohet as me termin ‘person ndaj të cilit zhvillohen hetime’ dhe as me termin ‘i pandehur’. Emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale shënohet në regjistër vetëm në ato raste kur kallëzuesi mendon se e di se kush është autori i krimit. Por kjo nuk do të thotë se ai është vërtet autor i veprës penale. Nëse vërtet personi të cilit i atribuohet vepra penale është apo jo autor i veprës penale, do të dalë nga një hetim i plotë i gjithanshëm e në përputhje me ligjin”.*

59.5.5 Subjekti ka sqaruar se nga veprimet hetimore të kryera në vazhdimësi u konfirmua fakti se ishin pikërisht shtetasit E.Gj dhe F.P të përfshirë në aktivitetin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe në përfundim të hetimeve ndaj tyre është ngritur akuza për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike”, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, ndërsa për shtetasit E.Q, O.K dhe K.Sh është ngritur akuza për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”, parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal.

59.5.6 Subjekti ka sqaruar se me vendimin nr. ***, datë 7.2.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, është vendosur deklarimi fajtor i shtetasve të sipërpërmendur, sipas akuzave të ngritura prej tij, dhe për të pestë këta shtetas gjykata ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim sipas nenit 59 të Kodit Penal. Subjekti ka prapësuar se ky vendim i gjykatës është ankimuar prej tij, pikërisht për këtë disponim të gjykatës, çka është tregues i faktit se në rastin konkret nga ana e subjektit është zbatuar me përpikëri ligji penal dhe procedural penal dhe nuk ka qoftë edhe një element që të tregojë se ka “favorizuar” persona të caktuar. Subjekti ka depozituar kopje të vendimit nr. ***, datë 7.2.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, si dhe një kopje e shkresës nr. ** prot., datë 4.5.2022.

Vlerësimi i Komisionit

59.5.7 Komisioni, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe verifikimit të akteve në dosje, vëren mungesën e një arsytimi të përshtatshëm, pasi subjekti i rivlerësimit në kërkesën e tij drejtuar gjykatës nuk ka shtjelluar kushtet konkrete, për të cilat ka kërkuar masat e sigurisë në fjalë, në veçanti për të dyshuarit E.Q dhe O.K. Përveç referimit në tekst të dispozitave ligjore të Kodit të Procedurës Penale (përcaktimi i kërkesave/kritereve për zbatimin e masave të sigurimit personal – nenet 228 dhe 229 të Kodit të Procedurës Penale të Shqipërisë), subjekti i rivlerësimit nuk ka vlerësuar dhe analizuar, në bazë të provave të disponueshme lidhur me rrezikshmërinë shoqërore të këtyre shtetasve, rëndësinë e fakteve penale që i atribuoheshin, dënimet ose procedimet e mëparshme ndaj tyre, si dhe çdo rrethanë rënduese ose lehtësuese.

Sa më sipër, të gjitha këto elemente të përmendura nga subjekti në prapësime, që kanë të bëjnë me kriteret për caktimin e masave të sigurimit për të dyshuarit, nuk janë shqyrtuar dhe analizuar aspak nga subjekti i rivlerësimit në kërkesën e tij drejtuar gjykatës. Po ashtu, gjykata në vendimin e saj ka theksuar faktin se referuar nenit 244/3 të Kodit të Procedurës Penale nuk mund të japë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori, çka në mënyrë indirekte nënkupton se nga ana e prokurorit është duke u kërkuar një masë dënimi më e butë për të pandehurit.

DENONCIME

60. Pranë Komisionit janë depozituar 23 denoncime nga publiku, ku disa prej tyre janë të përsëritura, pra në total janë 9 denoncime për subjektin e rivlerësimit Sabri Kastrati. Pas analizimit të denoncimeve, subjektit iu kërkuan shpjegime për 3 prej tyre, si vijon:

61. Denoncim i shtetasit A.S¹⁴⁷

61.1 Ky shtetas ankohet për disa prokurorë e gjyqtarë, midis të cilëve edhe subjektin e rivlerësimit Sabri Kastrati, për vonesa në hetim dhe veprime të kundërligjshme, pasi çështja e tij mbahet pezull prej 4 vitesh nga subjekti. Denoncuesi ankohet se subjekti pasi ka marrë dosjen e ka mbajtur çështjen për 13 muaj dhe nuk ka kryer asnjë hetim, nuk ka thirrur asnjëherë denoncuesin për të dëshmuar, sqaruar dhe vërtetuar veprat për të cilat ka kryer kallëzim, si dhe nuk i ka dhënë denoncuesit kopje të materialeve të fashikullit, me të cilat është njohur vetëm në seancën e parë gjyqësore dhe aty ka konstatuar se nuk ishte kryer asnjë hetim.

61.2 Sipas denoncuesit, gjykata i ka lënë afat organit të prokurorisë për të vazhduar hetimet për 4 muaj, ndërsa prokuroria ka kaluar 3 herë kohën e hetimit dhe nuk ka hetuar asnjë nga detyrat e caktuara nga gjykata.

61.3 Çështja penale konsiston në një kallëzim penal të kryer nga denoncuesi ndaj ZVRPP Lezhë, Bashkia Lezhë, shtetasve F.F, E.H, S.T, si dhe shtetasve Gj.P, Gj.P dhe P.P, pasi këta të fundit me ndihmën e drejtuesve të bashkisë, përmes falsifikimit kanë kryer regjistrim të kundërligjshëm të një prone publike dhe private prej 1.668 m², duke kryer dy ndërtime të paligjshme, një prej të cilave ndodhet në pronën private të denoncuesit, duke i dhunuar banesën e duke përvetësuar pjesë nga prona e tij.

61.4 Nga hetimi i Komisionit kanë rezultuar dy procedime penale, ku për njëjërën nga çështjet me nr. ***, viti 2016, duket se ka zvarritje të hetimeve nga subjekti gjatë periudhës prill 2018 – janar 2019 evidentohen vetëm dy veprime hetimore të kryera për këtë çështje.

✓ Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit iu kërkuan shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Prapësimet e subjektit të rivlerësimit

61.5 Subjekti ka sqaruar se për hetimin e këtij procedimi penal, fillimisht ka qenë i ngarkuar një prokuror tjetër dhe me vendimin e datës 3.4.2018 të drejtuesit të Prokurorisë është vendosur zëvendësimi i prokurorit, duke u caktuar subjekti si prokurori përgjegjës për hetimin e çështjes.

¹⁴⁷ (1) Denoncim nr. *** prot., datë 10.4.2019; (2) denoncim nr. *** prot., datë 4.9.2020; (3) denoncim nr. *** prot., datë 31.1.2022; (4) denoncim nr. *** prot., datë 2.2.2022, i adresuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit; (5) denoncim nr. *** prot., datë 16.6.2023, i adresuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit; (6) denoncim nr. *** prot., datë 26.6.2023, i adresuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit; (7) denoncim nr. *** prot., datë 8.2.2024; (8) denoncim nr. *** prot., datë 15.5.2024; (9) denoncim nr. *** prot., datë 22.5.2024, i adresuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit.

61.6 Subjekti ka sqaruar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendimin nr. ***, datë 22.9.2017, pasi kishte vendosur prishjen e vendimit të pushimit datë 4.4.2017, kishte lënë si detyrë kryerjen e një ekspertimi teknik për të verifikuar nëse në territorin ku pretendonte kallëzuesi kishte ose jo ndërtime me ose pa leje, si dhe sekuestrimin e disa kasetave filmike e regjistrimeve amatore të kryera nga kallëzuesi.

61.7 Subjekti ka shpjeguar se, pavarësisht se vendimi për zëvendësimin e prokurorit mban datën 3.4.2018, fashikulli i procedimi penal i është vënë në dispozicion më vonë (kohën e saktë nuk e mban mend), si dhe më pas, më konkretisht, në datën 9.5.2018, oficerja e policisë gjyqësore që ka ngarkuar me hetimin e këtij procedim penal ka bërë kërkesë për heqjen dorë nga hetimi i këtij procedim penal tek drejtuesi i Prokurorisë. Pasi i është vënë në dispozicion fashikulli i procedimit në fjalë, ka vënë re se veprimet hetimore të urdhëruara nga gjykata nuk ishin kryer ende nga prokurori që ishte ngarkuar fillimisht me hetimin e çështjes. Sa sipër, në zbatim të vendimit të gjykatës, janë sekuestruar disa kasete filmike dhe regjistrime të vëna në dispozicion nga kallëzuesi, si dhe është vendosur kryerja e ekspertimit teknik. Ekspertimi përkatës është kryer nga eksperti në datën 28.12.2018.

61.8 Subjekti ka shpjeguar se pas kryerjes së veprimeve hetimore në fjalë menjëherë ka konkluduar me pushimin e çështjes në datën 7.1.2019 dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendimin nr. ***, datë 27.3.2019, duke vlerësuar se veprimet hetimore kanë qenë të plota, ka vendosur pushimin e procedimit penal në fjalë. Subjekti ka depozituar vendimin nr. ***, datë 27.3.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, aktin e ekspertimit teknik të datës 28.2.2018, kërkesën për heqje dorë të oficerit të policisë gjyqësore datë 9.5.2018, si dhe vendimin për zëvendësimin e prokurorit datë 3.4.2018.

Vlerësimi i Komisionit

61.9 Prapësimet e subjektit se vonesa në kryerjen e veprimeve hetimore ka ardhur për shkak të marrjes së dosjes me vonesë, mbeten të paprovuara me dokumentacion mbështetës, ashtu siç nuk mund të justifikohet zvarritja e hetimeve për shkak të heqjes dorë nga çështja e oficerit të policisë gjyqësore, pasi referuar nenit 24 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori drejton dhe kontrollon hetimet paraprake, si dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore. Në përfundim, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegonte bindshëm të kundërtën e barrës së provës në lidhje me këtë procedim penal, duke shkaktuar zvarritje të pajustificuar në hetimin e kësaj çështjeje penale, të cilat përbëjnë mangësi profesionale referuar parashikimeve të pikës 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar.

62. Denoncim i shtetasit A.C e të tjerë¹⁴⁸

62.1 Këta shtetas janë banorë në lagjen “S”, Lezhë, të cilët ankohen për prokurorin Sabri Kastrati, pasi ka vendosur mosfillimin e hetimeve në datën 23.3.2020, pa kryer asnjë veprim hetimor.

62.2 Këta shtetas ankohen se jo shumë larg nga banesat e tyre ushtron veprimtarinë shoqëria “***” sh.p.k., e cila kryen asgjësimin e mbetjeve shtazore, duke mos respektuar asnjë kriter për ndotjen e ajrit e duke rrezikuar seriozisht jetën e banorëve.

62.3 Komisioni ka administruar kopje të dosjes penale nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë¹⁴⁹, ku nga verifikimi i kryer evidentohet

¹⁴⁸ Denoncimi nr. ** prot., datë 22.1.2021, nga shtetasit A.C, B.P, E.P, F.Gj, F.N, Gj.C, Gj.M, L.LI, P.C.

¹⁴⁹ Dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 10.6.2024.

se në datën 9.3.2020 subjekti ka regjistruar materialet e kallëzimit penal nr. *** dhe në datën 23.3.2020 ka disponuar me vendim për mosfillimin e procedimit, duke konkluduar se nuk rezulton para elementeve të veprës penale “Ndotja e ajrit”, parashikuar nga neni 201 i Kodit Penal.

Nga verifikimi i dosjes penale rezulton se:

- Nuk evidentohen veprime hetimore të kryera nga subjekti për hetimin e kësaj çështjeje penale. Gjithashtu, vendimi i mosfillimit datë 23.3.2020 u është komunikuar palëve të interesuara pas 3 muajsh, me shkresën e datës 19.6.2020.
- ✓ Lidhur me këtë konstatim të Komisionit, subjektit iu kërkuan shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Prapësimet e subjektit të rivlerësimit

62.4 Subjekti ka prapësuar se nga ana e Komisionit nuk është bërë dallimi midis materialit kallëzues dhe procedimit penal, kjo pasi vetëm kur një material kallëzues (kallëzim) regjistrohet si procedim penal sipas nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale procedohet me kryerjen e veprimeve hetimore. Në rastet kur prokurori konstaton se një material kallëzues (kallëzim) nuk i përmbush kushtet ligjore për t’u regjistruar si procedim penal, atëherë prokurori vendos mosfillimin e procedimit penal brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kallëzimit apo materialit kallëzues, konform neneve 290 dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale. Në këtë fazë nuk kryhen veprime hetimore. Sa i përket faktit se vendimi i mosfillimit u është njoftuar pas 3 muajsh, subjekti ka sqaruar se kjo është kryer për arsye të gjendjes së fatkeqësisë natyrore, për shkak të Covid 19. Me vendimin nr. 243, datë 24.3.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore” të Këshillit të Ministrave, u vendos kufizimi i disa prej të drejtave kushtetuese dhe për disa muaj në kuadër të kësaj gjendjeje nuk janë lejuar as të dalin prej banesave, por gjithsesi duke qenë se afatet e ankimit fillojnë nga dita e komunikimit të vendimit në rastin konkret, nuk ka ardhur asnjë pasojë në të drejtat e palëve, pasi nuk u është mohuar e drejta e ankimit.

Vlerësimi i Komisionit

62.5 Komisioni, pas prapësimeve të subjektit, vlerëson se pavarësisht se çështja penale është vetëm një material kallëzues, nuk do të thotë që subjekti nuk duhet të kryejë veprime verifikuese hetimore në lidhje me rrethanat që lejojnë ose nuk lejojnë fillimin e procedimit penal, jo në kuptimin e veprimeve hetimore të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale. Sa i përket komunikimit të vendimit të mosfillimit pas 3 muajsh, Komisioni i konsideron bindëse shpjegimet e subjektit, për sa kohë kjo vonesë nuk ka sjellë pasoja për palët e interesuara sa i përket të drejtës së ankimit.

63. Denoncime të shtetasit Gj.N¹⁵⁰

63.1 Ky shtetas ankohet për prokurorin Sabri Kastrati, për shkelje të rënda të etikës profesionale, korrupsion, moskryerje të veprimeve hetimore, duke zvarritur dhe bllokuar hetimet e urdhëruara me vendim gjyqësor. Sipas denoncuesit, prokurori ka kryer padrejtësi, është i korruptuar dhe i padenjë për të ushtruar funksionin e tij.

63.2 Çështja penale konsiston në një konflikt të zhvilluar brenda ambienteve të zyrës së avokatëve Gj.N e Sh.M, me shtetasit L.P, me detyrë shef i Policisë Bashkiake Lezhë dhe

¹⁵⁰ (1) Denoncimi nr. *** prot., datë 8.4.2021; (2) denoncimi nr. *** prot., datë 28.7.2021; (3) denoncimi nr. *** prot., datë 23.5.2022; (4) denoncimi nr. *** prot., datë 12.10.2023.

shtetasin R.Ç me detyrë sekretar i Bashkisë Lezhë, për shkak të vendosjes së disa stolave jashtë ambienteve të zyrës së avokatisë, të vendosura në hyrje të një pallati dhe heqjen e tyre nga policia bashkiake. Për shkak të këtij konflikti, denoncuesit kanë kryer kallëzim penal në datën 14.12.2020, ndaj punonjësve të policisë bashkiake, për veprat penale “Kryerja e veprimeve arbitrate”, parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal, “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248/1 i Kodit Penal, “Kundërshtimi dhe goditja e gjyqtarit, kanosja dhe fyerja”, parashikuar nga nenet 316, 317 dhe 318 të Kodit Penal.

63.3 Denoncuesi ankohet se prokurori Sabri Kastrati nuk ka kryer asnjë veprim hetimor, por u bashkua me palën e kallëzuar dhe datën 13.1.2021 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Ky vendim është shfuqizuar nga gjykatat, të cilat kanë urdhëruar kryerjen e hetimeve. Denoncuesi ankohet se nuk është kryer asnjë veprim juridik në zbatim të vendimeve gjyqësore.

Nga verifikimi i dosjes penale duket se:

- Subjekti nuk ka kryer veprime të plota hetimore, duke mos verifikuar nëse hapësirat ku ishin vendosur stolat ishin private apo publike, brenda të cilave mund të ushtronte kompetencat policia gjyqësore, si dhe nuk ka verifikuar dokumentimin e veprimeve nga policia bashkiake. Gjithashtu, vendimi i mosfillimit datë 13.1.2021 është marrë në tejkalim të afatit 15-ditor të parashikuar nga neni 291 i Kodit të Procedurës Penale.
- Ka zvarritje të hetimeve rreth 1 vit e gjysmë (nga momenti i regjistrimit të procedimit 8.11.2021 deri në datën e pushimit të çështjes, 31.5.2023), ku gjatë kësaj periudhe nuk evidentohen veprime hetimore të kryera nga subjekti.
- ✓ Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjektit iu kërkuan shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Prapësimet e subjektit të rivlerësimit

63.4 Subjekti ka sqaruar se ky procedim penal vazhdon të jetë në fazën e hetimeve paraprake dhe në këtë këndvështrim është jashtë kompetencave të organeve të rivlerësimit sipas parashikimeve në nenin E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës¹⁵¹. Pavarësisht kësaj, si dhe vendimeve të gjykatës në lidhje me këtë çështje penale, subjekti ka shpjeguar se në faktin e kallëzuar nuk ka elemente të veprës penale të shpërdorimit të detyrës. Sipas subjektit, policia bashkiake nuk vepron vetëm në bazë të ankesave formale dhe shkresore të qytetarëve, por edhe në bazë të ankesave që parashtrihen në mënyrë verbale nëpërmjet telefonit apo në disa bashki, si dhe nëpërmjet disa platformave të ndryshme të ndërtuara pikërisht për këtë qëllim. Po ashtu, policia bashkiake ka tagra të veprave edhe në ambientet e përbashkëta të pallateve, kjo sipas parashikimeve të ligjit nr. 10112, datë 9.4.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit” dhe VKM-së nr. 447, datë 16.6.2010 “Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”.

63.5 Subjekti ka shpjeguar se gjatë verifikimit dhe veprimeve hetimore të kryera rezultoi se heqja e stolave nga policia bashkiake është bërë në bazë të ankesës së bërë prej banorëve të pallatit “J” dhe veprimet e policisë bashkiake në rastin konkret kanë qenë në përputhje me ligjin nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për organizmin dhe funksionimin e Policisë Bashkiake dhe Komunës”, ligjin nr. 10112, datë 9.4.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”, si dhe VKM-në nr. 447, datë 16.6.2010 “Për miratimin e rregullores tip të

¹⁵¹ Neni E, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës sanksionon se: “Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim”.

administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”. Subjekti ka depozituar vendimin nr. ***, datë 10.6.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Vlerësimi i Komisionit

63.6 Komisioni çmon se hetimet e kryera nga subjekti nuk kanë qenë të plota, për sa kohë edhe gjykatat më të larta i kanë kthyer aktet duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve. Argumenti i subjektit se kjo çështje është në fazën e hetimeve paraprake, nuk e bën atë një çështje në shqyrtim sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë është ezauruar roli dhe puna e subjektit dhe gjykatat janë shprehur lidhur me vendimmarrjen e tij dhe veprimet hetimore të ndërmarra prej tij.

Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

64. Për sa më sipër, sipas shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se pavarësisht problematikave të konstatuara, për një vlerësim tërësor të këtij kriteri, subjekti ka arritur nivelin minimal kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues, në përfundim të hetimit të kryer, në zbatim të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, duke u bazuar në vlerësimin tërësor të çështjes mbi të tria kriteret e rivlerësimit, mbështetur në provat e administruara nga Komisioni, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara prej tij, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti t’i provojë trupit gjykues të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me kriterin e pasurisë, kontrollin e figurës si dhe disa problematika të konstatuara tek kriteri i aftësive profesionale, duke cenuar besimin e publikut tek drejtësia, sipas përcaktimit të nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti nuk provoi bindshëm:

- i) Burimet e ligjshme financiare për krijimin e pasurive në pronësi të tij, duke u gjendur në parashikimet e pikave 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
- ii) Subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm lidhur me kontrollin e figurës, në kundërshtim me sa parashikohet në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përputhje me nenin 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në referim të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 58 dhe pikave 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Sabri Kastrati, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
 3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
 4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 19.9.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta TAFA (BUNGO)
Kryesuese

Suela ZHEGU
Relatore

Roland ILIA
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha